ISSN: 2308-6491

REVISTA

DEMOGRAFIA

Nr. 1 Viti 2019

Tiranë, 2019

Botues **Shoqata Shqiptare e Demografëve**

Kolegjiumi i redaksisë:

Msc. **Luan Shahollari - *kryeredaktor***
Prof.Dr. **Nevruz Koçi - *anëtar***
Prof.Assoc.Dr. **Merita Xhumari - *anëtar***
Dr. **Pasko Vako - *anëtar***
Prof.Assoc.Dr. **Hasan Hoxha - *anëtar***

***Redaktore letrare*: Elsa Goga**
***Arti grafik*: Edvin Ziso**
***Menaxher*: Asllan Duçellari**
***Shtypi*: Emal**

Kjo revistë është mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA).

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të UNFPA-së.

Duke filluar nga viti 2013, këtë revistë mund ta gjeni edhe në internet në sitin: www.revistademografia.al

Përmbajtja

LËVIZJA MEKANIKE E POPULLSISË NË SHQIPËRI DHE DISA DETYRA PËR TË ARDHMEN 5
Prof.Dr. Ilia TELO
Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Demografëve

LLOGARITË RAJONALE NË SHQIPËRI: MË SHUMË MUNDËSI PËR ANALIZA TË THELLUARA TË PBB DHE TREGUESVE TË TJERË SOCIO-EKONOMIKË SIPAS QARQEVE 17
Msc. Luan SHAHOLLARI
Kryeredaktor i kolegjiumit të revistës "Demografia"

KRIZA DEMOGRAFIKE NË SHQIPËRI DHE DISA MASA PËR ZBUTJEN E SAJ 40
Dr. Pasko VAKO

POLITIKAT PËR NXITJEN E QËNDRIMIT AKTIV NË PUNË NË SHQIPËRI 55
Prof.Assoc.Dr. Merita XHUMARI
Departamenti i Shkencave Politike, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

SISTEMI I PENSIONEVE DHE MISIONI I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE 75
Prof.Assoc.Dr. Hasan HOXHA

KRONIKË 90
Prof. Hasan Banja: Ekonomia e Shqipërisë në rrjedhat e historisë të shekullit XX.
Disa veçori të zhvillimeve demografike në Shqipëri në shek. XX 92

STATISTIKË 107
Rishikimi i Perspektivës së Popullsisë së Botës 2019 për vitet 2020-2100 110
Projeksionet probabilistike të popullsisë gjithsej (meshkuj dhe femra) bazuar në Parashikimin e Popullsisë së Botës 2019 sipas rajonit, nënrajonit, vendit ose zonës për vitet 2020-2100 115

NEKROLOGJI 124

KRITERET E BOTIMIT TË REVISTËS DEMOGRAFIA 126

LËVIZJA MEKANIKE E POPULLSISË NË SHQIPËRI DHE DISA DETYRA PËR TË ARDHMEN

Prof.Dr. ***Ilia TELO***
Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Demografëve

Abstract

The number and the composition of a population varyes from natyral increase as well as by mechanical movements. The mechanical movements (inside ore outside of the country) based in the departures and arrivals (emigration and immigration). Population that is moved of the country and is living in other countries called also diaspora. During the Otoman Empire,a part of the Albanian peoples was emigrated in Southern Italy and called arbëreshë. Another part went to Greece, and called arvanitas. After the Indepence Day (28 november 1912) the economic emigration was directed toward USA and some main Western Europian countries. During the socialist system (1945-1990) the outside emigratiton was banned by law, while inside peoples movements were been controled by the state. These movements allowed only for works reason in the industrial objects, for the employment in the central and local administration as well as in the education, health, cultural institutions etc. After 1990 the Albanian population has the right to move freely inside and outside the country. The outside emigration has been massive especially in the first years of the transition. Mostly of Albanian emigrants went in to neighbour EU countries: in Greece and Italy. Although by decreased rates, this phenomenon is continuing. In the present times trends for emigration are strong especially toward Germany and USA. During this period, currently about 35 per cent of the Albanian population is living abroad. In this paper are given some suggestions for the governmental organs to take measures for the development of mountain zones with intention to discourage the outside and inside emigration

Key words*: Population movement; Emigration and immigration; Albania; Mechanical movements; Inside and outside migration.*

1. Lëvizja mekanike e popullsisë shqiptare në kuadrin historik

Për lëvizjen mekanike, ashtu si dhe për lëvizjen natyrale të popullsisë, llogariten të dhëna absolute për të ardhurit në territor dhe për të larguarit nga territori gjatë një periudhe të caktuar kohe (zakonisht gjatë një viti).

Po kështu llogariten edhe treguesit relativë si: numri i të larguarve dhe të ardhurve për 1000 banorë të popullsisë. Diferenca midis të larguarve dhe të ardhurve për një periudhë të caktuar kohë jep saldon e lëvizjes mekanike të popullsisë. Shprehja e njohur që popullsia që nuk lëviz nuk mund të zhvillohet, është vërtetuar nga një praktikë e gjatë historike. ShBA nuk do ishin ai vend i madh e i fuqishëm ekonomik që është sot pa emigrimin atje të popullsisë nga Europa dhe nga kontinente të tjera.

Shqiptarët gjatë historisë së tyre kanë lëvizur në vende të tjera dhe në të njëjtën kohë në territoret shqiptare kanë ardhur popuj nga vende të tjera. Shqiptarët janë pritur mirë në vendet ku kanë emigruar, por, në të njëjtën kohë, edhe popuj të tjerë që janë vendosur në territorin e Shqipërisë janë mirëpritur nga shqiptarët dhe kanë bashkëjetuar me ta.

Gjatë periudhës të sundimit të Perandorisë Osmane një pjesë e madhe e popullsisë shqiptare u largua nga vendi për një jetë më të mirë, për t'iu shpëtuar përndjekjeve, për të ushtruar lirisht besimin e vet fetar etj. Mungojnë të dhëna të plota për popullsinë shqiptare që ka emigruar në kohën e Perandorisë Osmane, por, sipas disa vlerësimeve, popullsia që ka emigruar gjatë atyre viteve përbën rreth 1/3 e popullsisë shqiptare.

Ndër këto largime, dy ishin destinacionet kryesore ku u vendosën shqiptarët:

- *Destinacioni i parë* ishte Italia e Jugut. Kontigjenti i popullsisë shqiptare që u vendos aty u quajtën *arbëreshë*. Arbëreshët kanë ruajtur gjuhën, kulturën dhe traditat shqiptare, si dhe kanë nxjerrë njerëz të shquar në të gjitha fushat e jetës.

- *Destinacioni i dytë* ishte fqinji tjetër, Greqia. Kontigjenti i popullsisë shqiptare që u vendos aty u quajtën *arvanitas*. Ata kanë bashkëjetuar me popullsinë vendëse dhe kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ngjarjet e mëdha historike, sidomos në fitoren e Revolucionit të vitit 1821 që solli pavarësinë e Greqisë.

Pas krijimit të shtetit të ri shqiptar më 28 nëntor 1912, dallohen tri periudha të emigracionit, të cilat janë:

- Periudha nga 1913 deri më 1945.
- Periudha e sistemit socialist 1945 – 1990.
- Periudha pas vititit 1990, e tranzicionit politik demokratik dhe ekonomisë së tregut.

Në zhvillimin demografik dhe social-ekonomik të qyteteve tona ka ndikuar edhe emigrimi i brendshëm. Mjafton të përmendim faktin që në Tiranë shtesa më e madhe e popullsisë ka ardhur nga rrethet e tjera të vendit.

2. Lëvizja mekanike e popullsisë nga viti 1913-1945

Në periudhën nga viti 1913 e deri në fund të Luftës II Botërore emigrimi i jashtëm ishte i lirë dhe shumë shqiptarë u larguan nga vendi në shtete të tjera më të zhvilluara dhe më të pasura. Pjesa më e madhe e tyre patën emigruar në ShBA, një pjesë tjetër në vende të ndryshme të Evropës, dhe më pak emigruan në Australi, Argjentinë etj. Shkaku kryesor i emigrimit ka qenë ekonomik: shqiptarët janë larguar nga atdheu i tyre për të siguruar më shumë të ardhura për familjet e tyre.

Në vitet 1913 – 1945 ka pasur emigrim apo lëvizje mekanike të popullsisë edhe brenda vendit, i cili ka qenë i ndryshëm në qendra të ndryshme urbane, por me shpalljen *de facto* të Tiranës kryeqytet (shkurt 1920), ky qytet u bë destinacioni kryesor i migrimit në vend.

Në tabelën 1 paraqiten të dhëna për numrin e popullsisë në 14 qendrat urbane kryesore të vendit në vitet 1923 dhe 1938. Nga këto të dhëna del se popullsia mesatare gjithsej në këto qytete në vitin 1938 është shtuar 32.611 banorë ose 28 për qind kundrejt vitit 1923.

Një rritje e ndjeshme është regjistruar në qytetin e Fierit (3,2 herë), të Peshkopisë (2,6 herë), në qytetin e Tiranës (2,3 herë), të Lushnjës (2,2 herë), të Pogradecit (1,6 herë), në qytetin e Durrësit (1,5 herë) etj. Rritja e ndjeshme e popullsisë në disa qytete vjen për shkak të nivelit të ulët të vitit 1923; efekti më i madh vjen nga lëvizja mekanike, veçanërisht në drejtim të Tiranës si kryeqytet dhe Durrësit si porti më i madh i vendit.

***Tabela 1**: Numri i popullsisë në vitet 1923 dhe 1938 në qytetet kryesore*

Qyteti	1923	1938	Indeksi %
Gjithsej	***114,704***	***147,315***	***128***
Berat	8.000	9.584	120
Durrës	4.785	10.506	145
Elbasan	10.408	12.718	122
Fier	1.510	4.795	318
Gjirokastër	8.906	8.820	80
Kavajë	6.307	7.272	115
Korçë	25.598	21.221	82
Lushnjë	1.900	4.258	224
Peshkopi	893	1.414	258
Përmet	2.718	2.805	121
Pogradec	2.312	3.632	157
Shkodër	21.580	25.293	117
Tiranë	10.845	25.079	231
Vlorë	8.942	9.918	111

***Burimi**: Revista "Demografia" nr. 1, viti 2014. Faqe 27.*

Nga tabela bie në sy fakti i rënies së numrit të popullsisë në vitin 1938 kundrejt vitit 1923 në qytetin e Gjirokastrës me 20 për qind dhe në qytetin e Korçës me 18 për qind. Popullsia në këto dy qytete është zvogëluar gjatë kësaj periudhe si rezultat i emigrimit jashtë vendit dhe brenda vendit. Emigrimi jashtë vendit ka ndodhur në drejtim të SHBA-së dhe Australisë, kurse emigrimi i brendshëm, kryesisht drejt Tiranës për punësim në sektorë ekonomikë privatë si dhe për shërbime në sektorët publikë.

3. Lëvizjet e popullsisë brenda vendit në vitet 1945-1990

Gjatë sistemit socialist emigrimi i jashtëm ishte i ndaluar me ligj, prandaj numri i emigrantëve të kësaj periudhe është i vogël dhe shumica e tyre janë quajtur emigrantë politikë. Kalimi i paligjshëm i kufirit cilësohej vepër e rëndë penale dhe dënohej me burg.

Gjatë kësaj periudhe, edhe emigrimi i brendshëm, nga fshati në qytet ose midis krahinave të ndryshme të vendit, ishte i kufizuar. Kjo është një nga arsyet që fshati ishte i mbipopulluar dhe të ardhurat e fshatarësisë kooperativiste ishin shumë më të ulëta se të ardhurat e punëtorëve dhe nëpunësve në sektorin shtetëror. Në atë periudhë popullsia qytetare përbënte vetëm 1/3 e popullsisë së vendit, që shënon edhe nivelin më të ulët në Europë. Kjo ndodhte në një kohë që toka e punuar për frymë për popullsinë e fshatit në vendin tonë ishte shumë herë më e ulët se në vendet e tjera.

***Tabela 2**:Numri i popullsisë në disa qytete të vendit në vitet 1950 dhe 1990*

Qyteti	1950	1990	Indeksi, %
Gjithsej	***207.570***	***820.867***	***395***
Berati	12.070	46.210	383
Durrësi	15.273	82.719	541
Elbasani	16.492	80.650	489
Fieri	8.909	52.257	587
Gjirokastra	9.968	24.207	243
Kavaja	9.191	25.156	274
Korça	25.831	63.623	246
Lushnja	4.401	29.821	745
Përmeti	1.918	7.313	381
Pogradeci	4.275	19.272	451
Shkodra	33.638	79.920	822
Tirana	51.383	23.8057	463
Vlora	14.221	71.662	504

***Burimi**: Revista "Demografia" Nr 1, viti 2014, Faqe 31.*

Lëvizja mekanike e popullsisë nga fshati në qytet rregullohej nga aktet ligjore dhe nënligjore për pasaportizimin, të cilat kushtëzonin zgjedhjen e vendbanimit të shtetasve. Kështu, lëvizjet nga fshati në qendra urbane mund të bëheshin vetëm për plotësimin e kërkesave për fuqi punëtore për vepra të tilla industriale si: hidrocentralet, minierat, uzinat, fabrikat etj., si dhe për të plotësuar nevojat për nëpunës civilë dhe profesionistë në administratën qendrore dhe vendore, si dhe në institucionet shëndetësore, arsimore, kulturore etj. Mjaft prej këtyre profesionistëve u përgatitën në shkollat dhe universitetet jashtë vendit.

Kishte edhe raste kur vajza nga fshati martoheshin me burra që banonin në qytet vetëm që të largoheshin nga puna e rëndë dhe jetesa e vështirë në fshat.

Me gjithë kufizimet, gjatë sistemit socialist, për shkak të kohës relativisht të gjatë (mbi katër dekada), ka pasur migrim të popullsisë brenda vendit, në qendra të ndryshme urbane.

Në tabelën 2 paraqiten të dhëna për popullsinë e 13 qyteteve kryesore të vendit në vitet 1950 dhe 1990. Shtesa mesatare e popullsisë për të 13 qytetet e analizuara në vitin 1990, kundrejt vitit 1950, ka rezultuar rreth 4 herë.

Rritje më e ndjeshme është regjistruar në qytetin e Shkodrës (8,2 herë), në qytetin e Lushnjës (7,5 herë), në qytetin e Fierit (5,9 herë), në qytetin e Durrësit (5,4 herë), në qytetin e Elbasanit (4,9 herë), në qytetin e Tiranës (4,6 herë) etj.

Kurse qytetet e Gjirokastrës dhe Korçës paraqiten me rritje më të ulëta se mesatarja e popullsisë, përkatësisht 243 dhe 246 për qind.

Shtesa natyrore në tërësi dhe rritja e ritmeve të lëvizjes mekanike të popullsisë në disa qytete të vendit si Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Elbasan etj., kanë qenë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e popullsisë në shkallë vendi dhe për qytete të veçanta.

4. Lëvizja mekanike e popullsisë pas vitit 1990

Në zbatim të parimeve universale që çdo qytetar është i lirë ta zgjedhë vetë vendbanimin, pas vitit 1990 edhe në Shqipëri, në kushtet e reja të ndryshimeve politike, demokratike dhe të ekonomisë së tregut, u miratuan akte ligjore dhe nënligjore që mundësuan si emigrimin jashtë vendit, ashtu edhe migrimin brenda vendit.

Emigrimi jashtë vendit pas vitit 1990 në vendin tonë filloi dhe po vijon me ritme shumë të larta. Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e emig-

rantëve pas vitit 1990, por në bazë të studimeve që kemi bërë, del që aktualisht numri i emigrantëve është rreth 1,4 milionë banorë, ose rreth 35% e popullsisë shqiptare *(Grafiku 1*). Shumica e tyre u vendosën në Greqi dhe Itali dhe u zgjerua në Gjermani, Francë, Britani etj., si dhe në ShBA e vende të tjera.

Emigrimi në këto përmasa ka ndodhur kryesisht për arsye ekonomike (për një jetë më të mirë). Zbatimi në praktikë i "Shock Therapy" në vitet e para të tranzicionit bëri që të shkurtohet numri i të punësuarve rreth 60 për qind. Kjo nga njëra anë dhe pagat shumë të ulëta nga ana tjetër, krahasuar me vendet e tjera, janë shkaqet kryesore të mbajtjes së ritmeve të larta të emigracionit të jashtëm.

Emigrimi i jashtëm ka ndikuar pozitivisht si për vetë personat që kanë emigruar, ashtu edhe për familjet e tyre, pasi një pjesë e emigrantëve u kanë dërguar para (remitanca) familjeve në Shqipëri, duke ua lehtësuar shumë vështirësitë ekonomike të tranzicionit.

Por fakti që ritmet e larta të emigracionit vazhdojnë edhe tani, tregon që vështirësitë ekonomike janë të pranishme dhe në masë të gjerë në vendin tonë.

Grafiku 1: Struktura e popullsisë shqiptare sipas vendit të banimit



Pjesa më e madhe e popullsisë së larguar pas vitit 1990 i përket popullsisë në moshë pune, duke ndikuar në rritjen e treguesit të moshimit (të plakjes së popullsisë). Për më tepër, pjesa më e madhe e tyre janë meshkuj dhe të grupmoshave të punës.

Ndonëse ka përllogaritje të përafërta për numrin e emigrantëve, mungojnë të dhëna analitike për përbërjen e tyre sipas gjinisë, grupmoshave, profesioneve etj. Do të ishte mirë që këto të dhëna të kërkohen në vendin e origjinës në censusin e popullsisë në vitin 2020.

Vitet e fundit, një pjesë e emigrantëve janë rikthyer në familjet e tyre, disa prej të cilëve kanë ngritur biznese të suksesshme. Megjithatë, saldoja e migrimit të jashtëm ka mbetur gjithnjë në favor të emigrimit. Vitet e fundit ka pasur kërkesa të shtuara për të emigruar sidomos në Gjermani përmes rrugëve të ndryshme, përfshirë edhe kërkesa për azil politik si dhe në ShBA përmes lotarisë amerikane. Rreth 300 mijë shqiptarë bëjnë kërkesa çdo vit për të fituar këtë lotari. Këto fakte tregojnë se duhet të bëhet një punë më e organizuar për hapjen e vendeve të punës dhe rritjen e pagave me qëllim që punësimi në vend të ketë përparësi në krahasim me emigrimin e jashtëm.

Efekti i drejtpërdrejtë i emigrimit të jashtëm janë remitancat. Një pjesë e emigrantëve dërgojnë para në familjet e tyre ose prindërve apo të afërmve që ndodhen në Shqipëri. Një pjesë e remitancave dërgohen nëpërmjet bankave, kurse një pjesë tjetër, në formë monedhash të huaja (por edhe mallrave), vjen përmes rrugëve të tjera, formale dhe jo të tilla.

Në tabelën 3 paraqiten të dhëna për remitancat në raport me PBB-në dhe bilancin tregtar për vitet 1993 – 2014. Kurse në grafikun 2 paraqitet raporti i remitancave me PBB-në për këto vite.

***Tabela 3**: Remitancat dhe raporti i tyre krahasuar me PBB dhe bilancin tregtar*

Viti	Remitanca në mln lekë	Remitancat ndaj PBB në %	Remitancat ndaj bilancit tregtar në %
1993	274,7	22,4	64,0
1994	377,9	19,4	82,2
1995	384,6	15,5	81,0
1996	499,6	16,6	73,7
1997	366,9	13,6	49,9
1998	452,3	16,5	74,9
1999	368,1	10,7	55,5
2000	524,6	14,2	63,9
2001	555,1	13,5	54,1
2002	647,0	14,4	56,0
2003	806,2	14,2	60,3
2004	956,3	13,1	60,4
2005	989,6	12,1	54,3
2006	1178,3	13,0	56,2
2007	1304,5	12,2	45,0
2008	1225,6	9,5	34,5
2009	1091,2	9,1	33,9
2010	924,3	7,8	33,5
2011	932,5	7,2	29,9
2012	**874,8**	**7,1**	**34,1**
2013	**726,5**	**5,7**	**29,7**
2014	**785,6**	**5,6**	**27,9**

***Burimi**: Revista "Demografia", Nr. 1, 2016, faqe 57 dhe 59.*

Nga të dhënat e tabelës dhe grafikut del qartë se në vitet e para të tranzicionit remitancat janë rritur nga viti në vit, ndërsa pas vitit 2008 ka ulje të vëllimit të tyre. Kjo është pasojë e krizës botërore në vendet ku punojnë emigrantët, por në të njëjtën kohë, të ardhurat që sigurojnë emigrantët, me kalimin e viteve, po përdoren më shumë nga familjet e tyre të krijuara në vendin ku punojnë.

Remitancat kanë ndikuar në zbutjen e vështirësive të tranzicionit, në shtimin e të ardhurave në familjet në Shqipëri, e sidomos në familjet e varfra, (pra kanë ndikuar në uljen e shkallës së varfërisë).

Grafiku 2: Remitancat në % ndaj PBB, 1993-2014



5. Lëvizja mekanike brenda vendit

Pas vitit 1990 pati shumë lëvizje të popullsisë dhe brenda vendit, qajtur ndryshe migrim i brendshëm. Por ky migrim i brendshëm ka qenë spontan, pasi një pjesë e popullsisë që ka ardhur nga fshati në qytet është vendosur në pronat e të tjerëve, ose janë vendosur padrejtësisht në ndërtesat shtetërore, duke zbrazur zona të tëra fshatare.

Demokracia lejon që të largohesh nga vendi yt, por nuk ke të drejtë të zaptosh pronën e të tjerëve dhe pronën e përbashkët. Në disa raste emigrimi nuk ka shtuar "popullsinë qytetare", por ka "ruralizuar qytetin", duke shtuar vështirësitë për sigurimin e ujit të pijshmëm, për furnizim me energji elektrike, për vende pune etj.

Nga të dhënat statistikore rezulton se migrimi ndryshon për zona të ndryshme të vendit. Në vijim po paraqesim të dhëna në lidhje me numrin e popullsisë sipas qarqeve të ndryshme të vendit në vitin 1990 dhe 2014 *(Tabela 4 dhe Grafiku 3)*.

***Tabela 4**: Numri i popullsisë sipas qarqeve në vitin 1990, 2014, në mijë banorë*

Qarku	1990	2014	Indeksi në %
Gjithsej	**3.256**	**2.894**	**89**
Gjirokastër	159	73	46
Kukës	151	86	56
Berat	228	144	63
Korçë	317	275	71
Shkodër	292	220	75
Dibër	233	137	76
Fier	389	316	81
Elbasan	367	302	82
Lezhë	170	138	83
Vlorë	270	183	92
Durrës	224	276	123
Tiranë	456	795	174

Të dhënat e tabelës dhe grafiku tregojnë qartë se në vitin 2014 kundrejt vitit 1990, në 10 nga 12 qarqet gjithsej popullsia ka shënuar ulje, kurse në qarkun e Tiranës dhe të Durrësit është regjistruar rritje e numrit të popullsisë. Ulje më e madhe e popullsisë është shënuar në qarkun e Gjirokastrës, të Kukësit, të Beratit, të Korçës etj. Shkaku kryesor i uljes së popullsisë është migrimi i saj brenda dhe jashtë vendit. Për qarkun e Tiranës dhe të Durrësit ka shtesë të numrit të popullsisë, dhe në këtë shtesë faktori kryesor ka qenë imigrimi i popullsisë nga qarqe të tjera.

Grafiku 3: Ndryshimi i popullsisë sipas qarqeve për vitet 2914 dhe 1990, në mijë banorë



Sigurisht, në kushtet e demokracisë, ku njerëzit e zgjedhin vetë vendbanimin e tyre, do të këtë lëvizje mekanike të popullsisë, por shteti duhet që nëpërmjet levave ekonomike të ndihmojë që të mos zbrazen krahina të tëra, sidomos në zonat malore.

Në tabelën 5 dhe grafikët 4 dhe 5, po japim të dhëna përmbledhëse për popullsinë e qarqeve Tiranë dhe Durrës si dhe për gjithë qarqet e tjera të vendit në vitet 1990 dhe 2014. Të dhënat tregojnë qartë se popullsia në qarqet Tiranë e Durrës është rritur nga 21 për qind e popullsisë gjithsej në vitin 1990, në 37 për qind në vitin 2014. Ndërkohë ka rënë numri i popullsisë në qarqet e tjera, nga 79 për qind më 1990 në 63 për qind më 2014.

***Tabela 5**: Popullsia në qarqet Tiranë dhe Durrës në raport me qarqet e tjera*

Emërtimi	1990		2014	
	Mijë banorë	Pesha specifike në %	Mijë banorë	Pesha specifike në %
Tiranë dhe Durrës	680	21	1.071	37
Qarqe të tjera	2.576	79	1.823	63
Gjithsej	3.256	100	2.894	100

Grafiku 4: Popullsia në qarkun e Tiranës dhe Durresit, dhe në qarqet e tjera për vitin 1990, në %



Grafiku 5. Popullsia në qarkun e Tiranës dhe Durrësit si dhe në qarqet e tjera për vitin 2014, në %



Për sa më sipër mund të arrijmë në përfundimin që lëvizjes mekanike të popullsisë (si emigracionit të jashtëm dhe migrimit të brendshëm) organet shtetërore, qendrore dhe vendore duhet t'i përgjigjen me politika më të drejta dhe konkrete për zhvillimin e territoreve të ndryshme dhe sidomos zonave malore, që kanë burime natyrore dhe njerëzore për zhvillimin e turizmit. Krahas kësaj, është e nevojshme që regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë dhe i banesave (Censusi) i parashikuar për vitin 2020, të shmangë të metat që u evidentuan në censusin 2011. Kjo do të thotë që me anë të këtij censusi të sigurohen të dhëna lidhur me popullsinë që ka emigruar pas vitit 1990 sipas karakteristikave të ndryshme: gjinisë, moshës, nivelit arsimor, vendit ku ndodhen etj.

Literatura:

1. *Prof. Fiqri Sheri: Populllsia e Botës. Tiranë, 2006.*
2. *Prof.Dr. Novrus Koçi: Demografia. Tiranë, 2008.*
3. *Prof.Dr. Ilia Telo: Demografia – Tiranë, 2008.*
4. *Prof.Dr. Ilia Telo: Përse të fundit. Tiranë, 2015.*
5. *Prof.Dr. Ilia Telo: Probleme Demografike dhe Sociale, Tiranë, 2015.*
6. *Prof.Dr. Ilia Telo: Moshimi, shteti dhe shoqëria. Tiranë, 2017.*
7. *Revistat DEMOGRAFIA, Botim i Shoqatës Shqiptare të Demografëve.*
8. *Vjetarë statistikorë të INSTAT-it.*

LLOGARITË RAJONALE NË SHQIPËRI: MË SHUMË MUNDËSI PËR ANALIZA TË THELLUARA TË PBB DHE TREGUESVE TË TJERË SOCIO-EKONOMIKË SIPAS QARQEVE

Msc. ***Luan SHAHOLLARI***
Kryeredaktor i kolegjiumit të revistës "Demografia"

Abstract

Since 2011, based in the metodogical criteria of the EU institutions, in parallel of the national indicators, INSTAT is publishing the statistical regional accounts. One of the general indicator that measure the economic activity of the country is GDP per capita(in lekë, euro, usd and PPS). The evaluation of this indicator in statistical regions 1, 2, 3 create conditions for more deep, effective and concrete socio-economic analyses. In this paper are presented data for the performance of the GDP during years in the country level as well as for the statistical regions, in total and per capita. The published data show that the highest level of the GDP per capita in the year 2017 was registered in the Center statistical region and especially in the region of Tirana with 747 thousand lek, 38 per cent more than the average in country level. While the lowest level of GDP per capita was registered in Kukës region by 327 thousand lek or about 39.5 per cent under the country average level. In this paper are presented also some factors that have impacted in these inequelities and are given some suggestions for central and local government instituions for the necessity to carry out development strategies, using indicators of the regional accounts.

Key words*: Albania; Regional Account; Statistical regions; EU; INSTAT; GDP per capita.*

1. Llogaritë Rajonale në Shqipëri

Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Marrëveshjen e Asociim-Stabilizimit Shqipëri – BE, nënshkruar në qershor 2006, INSTAT-i publikoi për herë të parë në vitin 2011 "Llogaritë Rajonale në Shqipëri", përfshirë edhe llogaritjen e PBB-së për frymë, sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS II) të BE-së.[1]

Struktura rajonale e Republikës së Shqipërisë sipas ndarjes NUTS

Rajoni Statistikor Niveli 1	Rajoni Statistikor Niveli 2	Rajoni Statistikor Niveli 3	Kodi
Republika e Shqipërisë (RSh) (Kodi AL)	Veri (Kodi 01)	Dibër	AL011
		Durrës	AL012
		Kukës	AL013
		Lezhë	AL014
		Shkodër	AL015
	Qendër (Kodi 02)	Elbasan	AL021
		Tiranë	AL022
	Jug (Kodi 03)	Berat	AL031
		Fier	AL032
		Gjirokastër	AL033
		Korçë	AL034
		Vlorë	AL035

Më 28 prill 2011, EUROSTAT-i konfirmoi propozimin e INSTAT-it të miratuar nga KM për ndarjen e vendit në 3 rajone statistikore:

niveli 1 – Shqipëria (Kodi AL), niveli 2 – Veri, Qendër, Jug (Kodi 01, 02, 03) dhe niveli 3, që përfaqëson 12 qarqet e vendit *(Tabela e mësipërme)*.[2]

Numri i popullsisë për çdo njësi joadministrative në nivel NUTS II është i harmonizuar me kriterin e vendosur nga Komisioni Europian: nga 800 mijë deri në 3 milionë banorë. Rajonet statistikore niveli 3 janë njësitë administrative (qarqet). Numri mesatar i popullsisë për nivelin 3 ishte 266.201 banorë për vitin 2009 (brenda intervalit 150 në 800 mijë banorë), 240.058 banorë në vitin 2015 dhe 239.454 banorë në vitin 2017.

---

1) Marrëveshja e Asociim-Stabilizimit BE–Shqipëri dhe Marrëveshja e Përkohshme për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar është nënshkruar më 12.6.2006, në Luksemburg.

2) Vendimi i KM nr.1037, datë 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës "Shqipëria në 3 (tre) rajone NUTS II" sipas nomenklaturës mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Europian".

Klasifikimi sipas NUTS është miratuar nga BE-ja për një ndarje të standardizuar për të mbledhur, zhvilluar dhe harmonizuar statistikat në nivel rajonal; për të përgatitur analizat socio-ekonomike të rajoneve; për shpërndarjen e fondeve strukturore për zhvillim.

Publikimi i parë i vitit 2011 përmbante rezultate të llogaritjeve të PBB-së dhe përbërësve të tij për vitet 2001– 2010 sipas 3 rajoneve statistikore niveli 2 dhe 12 rajoneve statistikore niveli 3. Të dhënat janë shprehur në lekë, në euro, dollarë (usd) si dhe në Standardin e Fuqisë Blerëse për efekte të krahasimeve të njësuara ndërkombëtare.[3]

Vlerësimi i Llogarive Rajonale bazohet në të dhënat e Llogarive Kombëtare, të cilat janë burime statistikore dhe administrative. Burimet statistikore përmbajnë të dhëna nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN), Anketat e Bujqësisë e të peshkimit, Anketa mbi Forcat e Punës (AFP), Statistikat e Çmimeve, Regjistri i Ndërmarrjeve etj. Kurse burimet administrative përmbajnë të dhëna nga shitjet (TVSh), pasqyrat financiare vjetore, raportet vjetore të sistemit bankar, të sigurimeve, të ardhurat dhe shpenzimet e Buxhetit të Shtetit etj.

Llogaritë Rajonale janë një detajim rajonal i llogarive përkatëse të ekonomisë kombëtare. Ato sigurojnë një ndarje rajonale për agregatët më të rëndësishëm si Vlera e Shtuar Bruto (VShB) sipas degëve kryesore të ekonomisë, PBB etj. Me vlerësimin e Llogarive Rajonale bëhen më të qarta diferencat e zhvillimit ekonomik rajonal.

Parimi kryesor për llogaritjen e VShB-së është ai i rezidencës (vendodhjes), pra, në rajonin ku ajo krijohet. Parimi i rezidencës është i rëndësishëm për t'u aplikuar sidomos në disa degë si energjia, transporti etj. VShB dhe PBB rajonal u publikuan për herë të parë në Shqipëri në vitin 2011 për vitin 2009. Vlerësimet e VShB dhe PBB sipas rajoneve statis-

---

3) Standardi i Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard -PPS) është një njësi monedhe artificiale që merr parasysh ndryshimet në nivelet kombëtare të çmimeve. Kjo njësi lejon krahasime të mirëfillta të vëllimit të treguesve ekonomikë për vendet. Agregatet e shprehura në PPS dalin duke pjesëtuar agregatet (treguesit) e vlerësuara me çmimet aktuale dhe me monedhën kombëtare përkatësisht me Paritetin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parity-PPP). Indeksi i volumit të PBB-së për frymë i shprehur në Standardin e Fuqisë Blerëse (PPS - Purchasing Power Standards) është dhënë në raport me mesataren e BE-së (BE28=100). INSTAT, maj 2019.

https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-datasets/-/tec00114.

tikore janë në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare (ESA).[4] Llogaritë Rajonale publikohen çdo vit, 19 muaj mbas muajit të referencës. Publikimi i Llogarive Rajonale pason publikimin e Llogarive Kombëtare Vjetore. Të dhënat mbi Llogaritë Rajonale për vitin 2012 janë publikuar në korrik 2014. Të dhënat janë publikuar sipas rajoneve statistikore niveli 2/3.

Botimi i përvitshëm "Llogaritë Rajonale në Shqipëri" i INSTAT-it përmban një përshkrim plotësues të Llogarive Rajonale sipas degëve kryesore të ekonomisë, duke përfshirë këto tabela: VShB sipas Rajoneve Statistikore Nivel 1, 2, 3; PBB në çmime korrente; PBB në çmime të vitit të mëparshëm; PBB në Euro; PBB në PPS; Rritja Reale e PBB; Popullsia mesatare në Shqipëri sipas Rajoneve Statistikore; PBB për frymë në Lekë, në Euro, në PPS sipas Rajoneve Statistikore Nivel 2; PBB për frymë, AL=100; PBB për frymë, EU28=100 sipas Rajoneve Statistikore Niv.2; Struktura e VShB sipas rajoneve dhe degëve të ekonomisë; VShB për 3 rajonet statistikore Niveli 2 dhe për 12 rajonet statistikore Niveli 3 (qarqe). Më 19 maj 2019, INSTAT-i publikoi Llogaritë Rajonale në Shqipëri (Indikatorët Rajonalë), rezultatet sipas klasifikimit NUTS 1, 2, 3 për vitet 2012 – 2017.

2. PBB sipas rajoneve statistikore

Bazuar në Fjalorin terminologjik të indikatorëve statistikorë të botuar nga INSTAT-i, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) është një matës bazë i ekonomisë së përgjithshme të një vendi. PBB përfaqëson vlerën monetare të të gjitha të mirave dhe shërbimeve të prodhuara brenda një vendi në një periudhë të caktuar kohore, zakonisht në një vit, por mund të vlerësohet gjithashtu edhe në bazë tremujore.

Si një matës i agreguar i prodhimit, PBB është i barabartë me shumën e Vlerës së Shtuar Bruto (VShB) të të gjitha njësive në prodhim, plus taksat dhe minus subvencionet mbi produktet. Kurse VShB është diferenca ndërmjet prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

Në vitin 2017, PBB me çmime korrente në rajonin statistikor nivel 1 (RSh) është vlerësuar 1.551.281 milionë lekë *(Tabela 1)*.[5] Rajoni statistikor i Veriut vlerësohet në 361.089 milionë lekë ose 23,3 për qind të shumës

4) ESA95terminology.cso.ie/en/media/csoie/methods/nationalaccountsoutputandvalueaddedbyactivity/methodology.

***Tabela 1**: PBB me çmime korrente gjithsej dhe për frymë për vitin 2017 sipas Rajoneve Statistikore nivel 1/2/3*

Kodi	Rajonet Statistikore nivel 2 / 3	PBB çmime korrente. mln lekë	PBB çmime korrente. mln Euro	PBB çmime korrente. mln USD	Struktura ndaj PBB. (%)	Kontributi ndaj rritjes reale (%)	PBB për frymë. mijë lekë	PBB për frymë. Euro	PBB për frymë. USD	Struktura e indeksit për frymë. AL=100
AL	**R Sh**	**1.551.281**	**11.564**	**13.025**	**100,00**	**3,82**	**540**	**4.024**	**4.533**	**100,00**
AL01	**Veri**	**361.089**	**2.692**	**3.032**	**23,28**	**0,41**	**439**	**3.269**	**3.682**	**81,24**
AL011	Dibër	49.885	372	419	3,22	0,06	405	3.016	3.398	74,95
AL012	Durrës	153.886	1.147	1.292	9,92	0,40	536	3.994	4.498	99,24
AL013	Kukës	25.643	191	215	1,65	-0,01	327	2.436	2.744	60,53
AL014	Lezhë	51.312	382	431	3,31	-0,03	401	2.990	3.368	74,31
AL015	Shkodër	80.364	599	675	5,18	-0,02	389	2.902	3.268	72,10
AL02	**Qendër**	**758.134**	**5.651**	**6.366**	**48,87**	**3,47**	**657**	**4.896**	**5.514**	**121,65**
AL021	Elbasan	106.061	791	891	6,84	0,05	377	2.812	3.167	69,87
AL022	Tiranë	652.072	4.861	5.475	42,03	3,42	747	5.567	6.270	138,33
AL03	**Jug**	**432.058**	**3.221**	**3.628**	**27,85**	**-0,06**	**482**	**3.596**	**4.050**	**89,35**
AL031	Berat	58.523	436	491	3,77	0,06	451	3.364	3.789	83,59
AL032	Fier	166.933	1.244	1.402	10,76	0,18	556	4.143	4.667	102,96
AL033	Gjirokast.	35.304	263	296	2,28	0,03	548	4.084	4.600	101,47
AL034	Korçë	85.451	637	717	5,51	-0,13	403	3.001	3.380	74,57
AL035	Vlorë	85.847	640	721	5,53	-0,19	454	3.385	3.813	84,12

gjithsej, rajoni statistikor i Qendrës me 758.134 milionë lekë ose 48,9 për qind, dhe rajoni statistikor i Jugut me 420.147 milionë lekë ose 27,8 për qind *(Grafiku 1)*.

VShB në vitin 2017 është vlerësuar në 1.355.126 milionë lekë kundrejt 1.154.747 milionë lekë në vitin 2012; 200.379 milionë lekë më shumë, ose 17,4 për qind *(Tabela 2)*.

Niveli më i lartë i VShB për këtë vit është arritur në rajonin statistikor të Qendrës me 662.270 milionë lekë, 48,8 për qind e shumës gjithsej në shkallë vendi; 2,1 herë më shumë se rajoni i Veriut dhe 1,74 herë më shumë se rajoni statistikor i Jugut. Peshën më të madhe e zë qarku i Tiranës me 569.620 milionë lekë, ose 42 për qind të nivelit mesatar në shkallë vendi.

PBB i llogaritur sipas rajoneve statistikore nivel 3 tregon që qarku i Tiranës zë vendin e parë në vend me 42 për qind të PBB-së gjithsej. Në vijim renditet qarku i Fierit me rreth 11 për qind, qarku i Durrësit 10 për qind, qarku i Elbasanit 7 për qind, qarku i Korçës dhe i Vlorës me 5,5 për qind, duke përfunduar me qarkun e Kukësit me 1,7 për qind *(Grafiku 2)*.

Struktura e PBB-së sipas rajoneve statistikore për vitet 2012 – 2017 paraqet ndryshime për të tre nivelet 2 dhe 12 nivelet 3 (qarqet). Kjo duket qartë nga tabela 3. Pesha e rajonit statistikor të Veriut është luhatur nga 24 për qind e PBB-së në vitin 2012 në 23,3 për qind në vitin 2017. Me rënie paraqitet edhe struktura e rajonit statistikor të Jugut: nga 31,2 për qind e PBB-së në vitin 2012 në 27,9 për qind në vitin 2017.

Ndryshe nga dy rajonet statistikore të mësipërme, rajoni i Qendrës paraqet prirje rritëse: nga 44,8 për qind të PBB-së në vitin 2012 në 47,1 për qind në vitet 2015 e 2016 dhe 48,8 për qind të PBB-së në vitin 2017. Në këtë rajon e gjithë rritja ka ardhur nga qarku i Tiranës, nga 37,6 për qind e PBB-së më 2012 në 42 për qind të PBB-së më 2017. E kundërta ka ndodhur në qarkun e Elbasanit, ku pesha e PBB-së ka rënë nga 7,2 për qind e vlerës gjithsej në 6,8 për qind.

Analiza tregon që peshën më të madhe specifike ndaj PBB-së në shkallë vendi pas Tiranës e zë qarku i Fierit, me rreth 11 për qind, qarku i Durrësit me 10 për qind, qarku i Elbasanit me 7 për qind, qarku i Korçës dhe Vlorës me rreth 5,5 për qind etj.

---

5) Vlerësimet për vitin 2017 në këtë tabelë dhe në vijim bazohen në të dhëna gjysmëfinale të publikuara nga INSTAT-i në vitin 2019; këto janë edhe më të fundit.

***Tabela 2**: Vlera e Shtuar Bruto sipas Rajoneve Statistikore nivel 1, 2, 3, vitet 2012-2017*

Në milion lekë

Kodi	Rajoneve statistikore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
AL	***R Sh***	***1.154.747***	***1.177.698***	***1.217.843***	***1.259.726***	***1.291.203***	***1.355.126***
AL01	***Veri***	***276.762***	***278.559***	***279.820***	***296.856***	***307.048***	***315.430***
AL011	Dibër	36.759	37.161	38.431	41.148	42.915	43.577
AL012	Durrës	110.082	112.812	112.723	123.188	126.802	134.427
AL013	Kukës	25.301	26.873	23.719	22.843	22.339	22.400
AL014	Lezhë	37.764	36.325	40.731	41.730	44.882	44.824
AL015	Shkodër	66.855	65.387	64.215	67.947	70.110	70.202
AL02	***Qendër***	***517.345***	***528.455***	***554.042***	***593.662***	***608.360***	***662.270***
AL021	Elbasan	83.040	88.627	90.211	88.004	91.284	92.650
AL022	Tiranë	434.305	439.828	463.830	505.658	517.076	569.620
AL03	***Jug***	***360.639***	***370.684***	***383.982***	***369.209***	***375.795***	***377.426***
AL031	Berat	42.472	43.760	45.976	48.034	49.952	51.123
AL032	Fier	148.034	156.621	164.753	148.814	143.357	145.825
AL033	Gjirokastër	31.316	30.723	31.656	30.133	30.226	30.840
AL034	Korçë	67.405	69.028	70.053	70.988	75.789	74.646
AL035	Vlorë	71.413	70.552	71.544	71.240	76.471	74.992

Grafiku 1: Struktura e PBB sipas Rajoneve Statistikore nivel 2, për vitin 2017



Grafiku 2: Struktura e PBB sipas qarqeve, viti 2017, %



3. Rritja reale e PBB-së për vitet 2012-2017

Rritja reale e PBB-së për vitet 2012 – 2017 paraqet ndryshime të ndjeshme sipas niveleve statistikore. Në shkallë vendi kjo rritje ka kaluar nga minimale në vitet 2012 – 2015, në rritje të moderuar në vitet 2016 dhe 2017, përkatësisht 3,3 dhe 3,8 për qind *(Tabela 4)*.

Rritja në shkallë vendi ka ardhur nga niveli statistikor Qendër nga 2,6 për qind më 2014 në 4,9 për qind më 2015; 3,3 për qind më 2016 dhe

***Tabela 3**: Struktura e PBB sipas rajoneve statistikore me çmime korrente, 2012-2017*

RSh=100 %

Kodi	Rajonet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
AL	**RSh**	**100.0**	**100.0**	**100.0**	**100.0**	**100.0**	**100.0**
AL01	**Veri**	**24,0**	**23,6**	**23,0**	**23,6**	**23,8**	**23,3**
AL011	Dibër	3,2	3,1	3,1	3,3	3,3	3,2
AL012	Durrës	9,5	9,6	9,3	9,8	9,8	9,9
AL013	Kukës	2,2	2,3	2,0	1,8	1,7	1,7
AL014	Lezhë	3,3	3,1	3,3	3,3	3,5	3,3
AL015	Shkodër	5,8	5,5	5,3	5,4	5,4	5,2
AL02	**Qendër**	**44,8**	**44,9**	**45,5**	**47,1**	**47,1**	**48,8**
AL021	Elbasan	7,2	7,5	7,4	7,0	7,1	6,8
AL022	Tiranë	37,6	37,4	38,1	40,1	40,0	42,0
AL03	**Jug**	**31,2**	**31,5**	**31,5**	**29,3**	**29,1**	**27,9**
AL031	Berat	3,7	3,7	3,8	3,8	3,9	3,8
AL032	Fier	12,8	13,3	13,5	11,8	11,1	10,8
AL033	Gjirokastër	2,7	2,6	2,6	2,4	2,3	2,3
AL034	Korçë	5,8	5,9	5,7	5,6	5,9	5,5
AL035	Vlorë	6,2	6,0	5,9	5,7	5,9	5,5

***Tabela 4**: Rritja reale e PBB-së sipas rajoneve statistikore për vitet 2012-2017, në %*

Kodi	Rajonet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
AL	***RSh***	***1,4***	***1,0***	***1,8***	***2,2***	***3,3***	***3,8***
AL01	***Veri***	***1,8***	***-0,5***	***-1,1***	***4,3***	***3,8***	***1,7***
AL011	Dibër	12,9	-0,01	1,2	10,0	5,7	1,9
AL012	Durrës	0,9	1,4	0,1	7,4	3,3	4,1
AL013	Kukës	-3,1	4,9	-14,5	-6,7	-2,1	-0,3
AL014	Lezhë	6,6	-5,1	9,4	0,8	7,8	-0,8
AL015	Shkodër	-2,4	-3,4	-4,7	1,6	3,1	-0,5
AL02	***Qendër***	***1,2***	***1,6***	***2,6***	***4,9***	***3,3***	***7,4***
AL021	Elbasan	-2,5	5,1	-0,5	-4,6	4,4	0,7
AL022	Tiranë	1,9	0,9	3,3	6,7	3,1	8,5
AL03	***Jug***	***1,4***	***1,4***	***2,7***	***-3,1***	***3,0***	***-0,2***
AL031	Berat	-7,6	0,8	3,1	2,0	5,4	1,4
AL032	Fier	7,6	4,6	5,2	-5,7	-2,1	1,6
AL033	Gjirokastër	7,5	-3,0	1,0	-6,8	1,2	1,4
AL034	Korçë	1,5	0,4	-0,4	-0,2	6,3	-2,2
AL035	Vlorë	-6,3	-2,2	0,6	-1,8	9,6	-3,3

sidomos me 7,4 për qind më 2017. Brenda këtij niveli, kontributin kryesor e ka dhënë qarku i Tiranës, me një rritje të ndjeshme sidomos në vitet 2015 dhe 2017, përkatësisht 6,7 dhe 8,5 për qind. Ndryshe nga Tirana, qarku i Elbasanit ka pasur luhatje, madje në disa vite ka pasur edhe rritje negative të PBB-së (– 4,6 % më 2015) dhe rritje minimale më 2017 (0,7%).

Niveli statistikor i Veriut paraqitet me rritje të moderuar të PBB-së në vitet 2015 – 2016 (4,3% dhe 3,8%), me rritje minimale në vitet 2012 dhe 2017 (1,8% dhe 1,7%) dhe rritje negative në vitet 2013 dhe 2014 (– 0,5% dhe –1,1%).

Në vitin 2017, sipas rajoneve statistikore në nivel 1 (RSh), PBB me çmime korrente u vlerësua 1.551.281 milionë lekë, me një rritje në terma realë prej rreth 3,82%, krahasuar me vitin 2016. Kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2017 e ka dhënë qarku Tiranë me +3,42 pikë përqindje, pasuar nga qarku Durrës me + 0,40 pikë përqindje dhe qarku Fier me +0,18 pikë përqindje. Kontributin më të ulët në rritjen ekonomike e ka dhënë qarku Vlorë me – 0,19 pikë përqindje, i pasuar nga qarku Korçë me një kontribut prej – 0,13 pikë përqindje dhe qarku Lezhë me një kontribut prej – 0,03 pikë përqindje. Sipas rajoneve statistikore në nivel 3, rritjen më të lartë e shënoi qarku Tiranë me një rritje në terma realë prej 8,54%, i ndjekur nga qarku Durrës me një rritje në terma realë prej 4,09% dhe qarku Berat me një rritje në terma realë prej 1,92%. Rritja ekonomike u ngadalësua në qarkun Vlorë, duke shënuar një rënie në terma realë prej 3,26% dhe në qarkun Korçë me një rënie në terma realë prej 2,22%.[6]

4. PBB në euro dhe në PPS

Të dhënat e tabelave 5 dhe 6, përkatësisht PBB në euro dhe në PPS na krijojnë mundësi që të bëjmë krahasime me nivele të ndryshme të rajoneve statistikore në BE dhe me vendet e Ballkanit Perëndimor që janë në rrugën drejt integrimit europian. Në këto tabela ka ndikimin e vet edhe luhatja e kursit të këmbimit që për Euron – monedhën e BE-së, gjatë këtyre viteve, ka qenë mjaft e madhe, kryesisht me rënie të vlerës së saj në raport me lekun.

Në vitin 2017, në krahasim me vitin 2016, PBB në shkallë vendi i shprehur në euro është rritur 7,8 për qind, kurse kur krahasimet i bëjmë me vlerën e llogaritur me PPS, kjo përqindje ndryshon. PBB i shprehur në PPS në vitin

6) NSTAT. Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistikore në Shqipëri, 2017. 29 maj 2019.

2017 ishte 26.234 milionë PPS, në vitin 2016 ishte 24.883 milionë PPS, me një rritje prej 5,6%. Sigurisht, krahasimi më i drejtë është kur llogaritjet i bëjmë me PPS, pasi në këtë rast është shmangur efekti i kursit të këmbimit.

5. Popullsia mesatare në Shqipëri

Popullsia mesatare në Shqipëri në vitet 2012-2017 ka shënuar një rënie të lehtë: nga 2.900.389 banorë në 2.873,458 banorë; 26.931 banorë më pak ose 0,9 për qind *(Tabela 7)*. Rënie e ndjeshme e numrit të popullsisë është regjistruar sidomos në Rajonin statistikor të Jugut: nga 952.805 banorë më 2012 në 895.746 banorë më 2017; 57.059 banorë ose 6 për qind më pak.

Një rënie e tillë është vërejtur edhe në Rajonin statistikor të Veriut, nga 857.071 banorë më 2012 në 823.349 banorë më 2017; 33.722 banorë më pak ose 3,9 për qind. Pra, në këto dy rajone statistikore popullsia ka rënë me 90.781 banorë, ose 5 për qind.

Ndryshe sa më lart, në rajonin e Qendrës është shënuar rritje: nga 1.090.513 banorë më 2012 në 1.154.363 banorë më 2017; 63.850 banorë më shumë ose 5,9 për qind.

***Tabela 5**: PBB sipas rajoneve statistikore për vitet 2012-2017, në milionë euro*

Kodi	Rajonet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
AL	***RSh***	***9.586***	***9.625***	***9.969***	***10.264***	***10.720***	***11.564***
AL01	***Veri***	***2.297***	***2.277***	***2.290***	***2.419***	***2.549***	***2.692***
AL011	Dibër	305	304	315	335	356	372
AL012	Durrës	914	922	923	1.004	1.053	1.147
AL013	Kukës	210	220	194	186	185	191
AL014	Lezhë	313	297	333	340	373	382
AL015	Shkodër	555	534	526	554	582	599
AL02	***Qendër***	***4.295***	***4.319***	***4.535***	***4.837***	***5.051***	***5.651***
AL021	Elbasan	689	724	738	717	758	791
AL022	Tiranë	3.605	3.595	3.797	4.120	4.293	4.861
AL03	***Jug***	***2.994***	***3.030***	***3.143***	***3.008***	***3.120***	***3.221***
AL031	Berat	353	358	376	391	415	436
AL032	Fier	1.229	1.280	1.349	1.213	1.190	1.244
AL033	Gjirokastër	260	251	259	246	251	263
AL034	Korçë	560	564	573	578	629	637
AL035	Vlorë	593	577	586	580	635	640

***Tabela 6**: PBB sipas rajoneve statistikore për vitet 2012-2017, në milionë PPS*

Kodi	Rajonet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
AL	***RSh***	***23.074***	***22.482***	***23.978***	***25.242***	***24.833***	***26.234***
AL01	***Veri***	***5.530***	***5.318***	***5.509***	***5.948***	***5.905***	***6.106***
AL011	Dibër	735	709	757	825	825	844
AL012	Durrës	2.200	2.154	2.219	2.468	2.439	2.602
AL013	Kukës	506	513	467	458	430	434
AL014	Lezhë	755	693	802	836	863	868
AL015	Shkodër	1.336	1.248	1.264	1.362	1.348	1.359
AL02	***Qendër***	***10.337***	***10.088***	***10.909***	***11.896***	***11.700***	***12.821***
AL021	Elbasan	1.659	1.692	1.776	1.763	1.756	1.794
AL022	Tiranë	8.678	8.396	9.132	10.132	9.945	11.027
AL03	***Jug***	***7.206***	***7.076***	***7.560***	***7.398***	***7.228***	***7.306***
AL031	Berat	849	835	905	963	961	990
AL032	Fier	2.958	2.990	3.244	2.982	2.757	2.823
AL033	Gjirokastër	626	587	623	604	581	597
AL034	Korçë	1.347	1.318	1.379	1.422	1.458	1.445
AL035	Vlorë	1.427	1.347	1.409	1.427	1.471	1.452

Në nivel qarku, nga 12 qarqe, me rritje të numrit të popullsisë paraqiten vetëm qarku i Durrësit dhe qarku i Tiranës. Në qarkun e Durrësit popullsia mesatare është rritur nga 272.988 më 2012 në 287.226 banorë më 2017; 12.328 banorë më shumë ose 5,2 për qind.

Rritja më e ndjeshme e popullsisë është regjistruar në qarkun e Tiranës, nga 789.584 banorë më 2012, në 873.179 banorë më 2017; 83.595 banorë më shumë ose 10,6 për qind. Një rritje e popullsisë prej 1 për qind është regjistruar edhe në qarkun e Vlorës.

Për të njëjtën periudhë, në qarqet e tjera kemi pakësim të numrit të popullsisë si vijon: në qarkun e Dibrës 11,5 për qind, të Kukësit 9,7 për qind, të Lezhës 6,5 për qind, të Shkodrës 6,6 për qind, të Elbasanit 6,6 për qind, të Beratit 10,7 për qind, të Fierit 5,8 për qind, të Gjirokastrës 11,3 për qind dhe të Korçës 6,4 për qind. *(Tabela 8 dhe Grafiku 3)*.

Qarku i Tiranës me 873.179 banorë është qarku më i madh me 30,4 për qind të banorëve në shkallë vendi gjithsej, kurse qarku më i vogël është ai i Gjirokastrës me 64.446 banorë ose 2,2 për qind.

***Tabela** 7: Populllsia mesatare në Shqipëri në vitet 2012-2017, banorë*

Kodi	Rajonet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
AL	**RSh**	**2.900.389**	**2.895.082**	**2.889.095**	**2.880.694**	**2.876.092**	**2.873.458**
AL01	**Veri**	**857.071**	**849.003**	**840.685**	**833.715**	**828.943**	**823.349**
AL011	Dibër	139.339	136.027	132.693	130.055	127.318	123.279
AL012	Durrës	272.988	275.044	277.024	279.097	282.514	287.226
AL013	Kukës	86.922	85.194	83.367	81.861	80.427	78.477
AL014	Lezhë	136.743	134.726	132.789	131.044	129.639	127.910
AL015	Shkodër	221.080	218.013	214.813	211.658	209.046	206.459
AL02	***Qendër***	***1.090.513***	***1.104.209***	***1.117.989***	***1.127.702***	***1.138.385***	***1.154.363***
AL021	Elbasan	300.929	296.967	292.802	289.136	285.714	281.185
AL022	Tiranë	789.584	807.243	825.187	838.566	852.671	873.179
AL03	***Jug***	***952.805***	***941.871***	***930.422***	***919.278***	***908.764***	***895.746***
AL031	Berat	145.296	142.485	139.740	136.903	133.692	129.687
AL032	Fier	318.694	314.424	310.131	306.561	303.808	300.326
AL033	Gjirokastër	74.904	72.660	70.562	68.789	66.980	64.446
AL034	Korçë	226.876	224.332	221.613	218.809	215.872	212.250
AL035	Vlorë	187.036	187.971	188.377	188.216	188.414	189.039

***Tabela 8**: Popullsia mesatare sipas niveleve statistikore, në % ndaj popullsisë gjithsej*

Kodi	Nivelet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
AL	***RSh***	***100,0***	***100,0***	***100,0***	***100,0***	***100,0***	***100,0***
AL01	***Veri***	***29,6***	***29,3***	***29,1***	***28,9***	***28,8***	***28,6***
AL011	Dibër	4,8	4,7	4,6	4,5	4,4	4,3
AL012	Durrës	9,4	9,5	9,6	9,7	9,8	10,0
AL013	Kukës	3,0	2,9	2,9	2,8	2,8	2,7
AL014	Lezhë	4,7	4,7	4,6	4,5	4,5	4,4
AL015	Shkodër	7,6	7,5	7,4	7,4	7,3	7,2
AL02	***Qendër***	***37,6***	***38,2***	***38,7***	***39,2***	***39,6***	***40,2***
AL021	Elbasan	10,4	10,3	10,1	10,1	10,0	9,8
AL022	Tiranë	27,2	27,9	28,6	29,1	29,6	30,4
AL03	***Jug***	***32,8***	***32,5***	***32,2***	***31,9***	***31,6***	***31,2***
AL031	Berat	5,0	4,9	4,8	4,8	4,7	4,5
AL032	Fier	11,0	10,9	10,7	10,6	10,6	10,5
AL033	Gjirokastër	2,6	2,5	2,5	2,4	2,3	2,2
AL034	Korçë	7,8	7,7	7,7	7,6	7,5	7,4
AL035	Vlorë	6,4	6,5	6,5	6,5	6,5	6,6

Grafiku 3 : Popullsia sipas qarqeve ndaj popullsisë gjithsej për 2017, %



6. PBB për frymë në lekë

PBB për frymë në lekë është një tregues që del si raport i PBB-së gjithsej me popullsinë mesatare dhe shpreh shpërndarjen e të mirave materiale të krijuara brenda një viti sipas rajoneve statistikore në shkallë vendi dhe qarku. PBB për frymë në lekë na shërben më shumë për të bërë krahasime brenda vendit, pasi përdoret monedha kombëtare.

Në shkallë vendi, PBB për frymë në lekë ka shënuar rritje nga 459.528 lekë më 2012, në 539.866 lekë më 2017 ose 17,5 për qind. Krahasuar me vitin 2016, kjo rritje është 5,4 për qind *(Tabela 9)*. Rajoni statistikor i Veriut është me tregues më të ulët të PBB-së për frymë krahasuar me mesataren në shkallë vendi si dhe me ata të Qendrës dhe të Jugut. Ky nivel në vitin 2017 është 438.561 lekë për frymë; 18,8 për qind më pak se mesatarja në shkallë vendi; 33 për qind më pak se rajoni Qendër dhe 9,1 për qind më pak se rajoni Jug. Një veçori pozitive për këtë rajon statistikor mund të konsiderohet prirja e rritjes së këtij treguesi në vitet 2012 – 2017. Në vitin 2017, kundrejt vitit 2012, PBB për frymë është rritur nga 371.710 lekë në 438.561 lekë ose 17,7 për qind. Me tregues më të ulët në këtë rajon paraqitet qarku i Kukësit me 326.756 lekë për frymë, qarku i Shkodrës me 389.247 lekë për frymë etj.

Rajoni i Qendrës paraqitet me tregues më të lartë të PBB-së për frymë në vitin 2017 me 656.755 lekë kundrejt 547.560 lekë më 2012; me një rritje prej 19,9 për qind. Por këtu duhet veçuar fakti që ky nivel i PBB-së për frymë vjen nga treguesi i qarkut të Tiranës prej 746.780 lekë, kundrejt 377.195 lekë që regjistrohet në qarkun e Elbasanit. Pra qarku i Tiranës ka një nivel të PBB-së për frymë rreth 2 herë më të lartë se qarku i Elbasanit.

Rajoni i Jugut më 2017 ka regjistruar një nivel të PBB-së për frymë prej 482.345 lekë ose 10 për qind më të lartë se më 2012. Nivelet më të larta të këtij treguesi janë regjistruar në qarkun e Fierit dhe Gjirokastrës, përkatësisht 555.840 lekë dhe 547.816 lekë dhe më i ulët në qarkun e Korçës me 402.597 lekë.

PBB në lekë për frymë krahasuar me nivelin në shkallë vendi paraqet ndryshime midis rajoneve dhe niveleve statistikore për vitet 2012 – 2017, të cilat paraqiten në *Tabelën 10* dhe në *Grafikun 4*.

Më 2017, rajonet statistikore të Veriut dhe të Jugut janë nën nivelin mesatar në shkallë vendi prej 100 për qind, përkatësisht 81 dhe 89 për qind. Kurse në të njëjtin vit, rajoni statistikor i Qendrës rezulton rreth 122 për qind. Ky rezultat pasqyron ecurinë e PBB-së gjithsej me ndonjë rregullim që lidhet me ndryshimin e numrit të popullsisë.

***Tabela 9**: PBB për frymë në lekë sipas rajoneve statistikore për vitet 2012-2017*

Kodi	Rajonet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
AL	**RSh**	**459.528**	**466.326**	**482.956**	**497.903**	**511.972**	**539.866**
AL01	**Veri**	**372.710**	**376.119**	**381.349**	**405.409**	**422.412**	**438.561**
AL011	Dibër	304.493	313.173	331.824	360.234	384.393	404.654
AL012	Durrës	465.431	470.188	466.203	502.551	511.849	535.767
AL013	Kukës	335.961	361.596	325.978	317.715	316.750	326.756
AL014	Lezhë	318.756	309.085	351.432	362.572	394.816	401.157
AL015	Shkodër	349.035	343.817	342.497	365.513	382.464	389.247
AL02	***Qendër***	***547.560***	***548.623***	***567.784***	***599.392***	***609.433***	***656.755***
AL021	Elbasan	318.496	342.119	352.992	346.549	364.351	377.195
AL022	Tiranë	634.861	624.590	643.998	686.571	691.556	746.780
AL03	***Jug***	***436.869***	***451.158***	***472.834***	***457.289***	***471.579***	***482.345***
AL031	Berat	337.385	352.063	376.955	399.488	426.089	451.265
AL032	Fier	536.128	571.020	608.646	552.703	538.116	555.840
AL033	Gjirokastër	482.556	484.715	513.997	498.763	514.626	547.816
AL034	Korçë	342.913	352.739	362.168	369.389	400.373	402.597
AL035	Vlorë	440.694	430.265	435.137	430.954	462.850	454.123

Të dhënat sipas qarqeve nxjerrin në pah që treguesi më i lartë i PBB-së për frymë në raport me mesataren në shkallë vendi është regjistruar në qarkun e Tiranës me 138 për qind, pasuar nga qarku i Fierit me 103 për qind, i Gjirokastrës 101,5 për qind, i Durrësit 99 për qind etj. Kurse treguesi më i ulët është regjistruar në qarkun e Kukësit (60,5%), të Elbasanit (70%), të Shkodrës (72%), të Lezhës (74%) etj.

7. PBB për frymë në PPS

PBB për frymë i llogaritur në PPS ka shënuar rritje pozitive gjatë viteve 2012 – 2017, me përjashtim të vitit 2013, kur ky tregues ka shënuar rritje negative prej –2,4 për qind. Në vitin 2017 PBB për frymë i llogaritur në PPS është vlerësuar në 9.130 me një rritje prej 5,7 për qind kundrejt vitit 2016 *(Tabela 11)*. Niveli më i lartë (11.106 PPS) është shënuar në rajonin Qendër, kurse më i ulët në rajonin Veri me 7.416 PPS.

PBB për frymë në PPS për vitet në studim 2012 – 2017 ka zënë mesatarisht 30 për qind të nivelit të BE28=100. PBB për frymë në PPS për vitin 2017 rezultoi 30,4 % e mesatares së BE28 = 100 kundrejt 29,4 për qind në vitin 2016. Sipas rajoneve statistikore në nivel 2, në rajonin qendër, PBB për frymë në PPS për vitin 2017 ishte 37,0%, në rajonin Veri 24,7% dhe në rajonin Jug 27,2% *(Tabela 12)*. Në qarkun e Tiranës ky tregues vlerësohet në 42 për qind të nivelit mesatar të PBB për frymë në BE28=100 *(Grafiku 5)*.

***Tabela 10**: PBB për frymë sipas niveleve statistikore në % ndaj AL=100*

Kodi	Rajonet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
AL	***RSh***	***100,00***	***100,00***	***100,00***	***100,00***	***100,00***	***100,00***
AL01	***Veri***	***81,11***	***80,66***	***78,96***	***81,42***	***82,51***	***81,24***
AL011	Dibër	66,26	67,16	68,71	72,35	75,08	74,95
AL012	Durrës	101,28	100,83	96,53	100,93	99,98	99,24
AL013	Kukës	73,11	77,54	67,50	63,81	61,87	60,53
AL014	Lezhë	69,37	66,28	72,77	72,82	77,12	74,31
AL015	Shkodër	75,96	73,73	70,92	73,41	74,70	72,10
AL02	***Qendër***	***119,16***	***117,65***	***117,56***	***120,38***	***119,04***	***121,65***
AL021	Elbasan	69,31	73,36	73,09	69,60	71,17	69,87
AL022	Tiranë	138,15	133,94	133,35	137,89	135,08	138,33
AL03	***Jug***	***95,07***	***96,75***	***97,90***	***91,84***	***92,11***	***89,35***
AL031	Berat	73,42	75,50	78,05	80,23	83,22	83,59
AL032	Fier	116,67	122,45	126,03	111,01	105,11	102,96
AL033	Gjirokastër	105,01	103,94	106,43	100,17	100,52	101,47
AL034	Korçë	74,62	75,64	74,99	74,19	78,20	74,57
AL035	Vlorë	95,90	92,27	90,10	86,55	90,41	84,12

Grafiku 4: PBB për frymë sipas rajoneve statistikore në % AL =100



***Tabela 11**: PBB për frymë sipas rajoneve statistikore, në PPS*

Kodi	Rajonet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
AL	RSh	7.955	7.766	8.300	8.763	8.634	9.130
AL01	Veri	6.452	6.263	6.553	7.135	7.124	7.416
AL02	Qendër	9.479	9.136	9.757	10.549	10.278	11.106
AL03	Jug	7.563	7.513	8.126	8.048	7.953	8.157

***Tabela 12**: PBB për frymë në PPS për vitet 2012-2017, Indeksi (EU28=100)*

Kodi	Rajonet statistikore	2012	2013	2014	2015	2016	2017
AL	**RSh**	**29,9**	**29,0**	**30,0**	**30,1**	**29,4**	**30,4**
AL01	**Veri**	**24,3**	**23,4**	**23,7**	**24,5**	**24,3**	**24,7**
AL011	Dibër	19,8	19,5	20,6	21,8	22,1	22,8
AL012	Durrës	30,3	29,2	28,9	30,4	29,5	30,2
AL013	Kukës	21,9	22,5	20,2	19,2	18,2	18,4
AL014	Lezhë	20,7	19,2	21,8	21,9	22,7	22,6
AL015	Shkodër	22,7	21,4	21,2	22,1	22,0	21,9
AL02	***Qendër***	***35,6***	***34,1***	***35,2***	***36,2***	***35,1***	***37,0***
AL021	Elbasan	20,7	21,3	21,9	21,0	21,0	21,3
AL022	Tiranë	41,3	38,8	40,0	41,5	39,8	42,1
AL03	***Jug***	***28,4***	***28,0***	***29,3***	***27,7***	***27,1***	***27,2***
AL031	Berat	22,0	21,9	23,4	24,2	24,5	25,4
AL032	Fier	34,9	35,5	37,8	33,4	31,0	31,3
AL033	Gjirokastër	31,4	30,1	31,9	30,2	29,6	30,9
AL034	Korçë	22,3	21,9	22,5	22,3	23,0	22,7
AL035	Vlorë	28,7	26,7	27,0	26,1	26,6	25,6



8. Lidhja midis PBB për frymë dhe familjeve me ndihmë ekonomike

Nga krahasimi i të dhënave në nivel makro (PBB për frymë të popullsisë) me ato administrative, siç është numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, në shumicën e rasteve del një lidhje e drejtpërdrejtë e tyre. Kështu, niveli më i ulët i PBB-së për frymë për vitin 2017 është shënuar në qarkun e Kukësit me 60,5 % të mesatares së vendit. Nga ana tjetër, ky qark ka edhe numrin më të madh të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike kundrejt familjeve gjithsej, prej rreth 67 për qind *(Tabela 13 dhe Grafiku 6*).

***Tabela 13**: Numri i familjeve gjithsej dhe me ndihmë ekonomike për vitin 2017*

Rajonet statistikore	Familje gjithsej	Familje me ndihmë ekonomike	Në % ndaj familjeve gjithsej
Gjithsej	**677.032**	**80.946**	**12,0**
Kukës	15.911	10.605	66,6
Dibër	25.116	13.305	53,0
Elbasan	63.072	18.114	28,7
Lezhë	28.670	5.163	18,0
Korçë	51.028	7.947	15,6
Shkodër	46.205	8.788	12,0
Gjirokastër	16.484	1.722	10,4
Berat	29.320	1.822	6,2
Tiranë	215.590	8.718	4,0
Fier	67.223	2.358	3,5
Vlorë	47.198	1.302	2,8
Durrës	71.205	1.102	1,5

***Burimi**: INSTAT dhe Shërbimi Social Shtetëror. Raporti 2018. Janar, 2019*

PBB për frymë të popullsisë në qarkun e Dibrës ka rezultuar 75 për qind e nivelit mesatar të vendit, ndërkohë që edhe familjet me ndihmë ekonomike përbëjnë 53 për qind të familjeve gjithsej, duke u renditur pas Kukësit. Qarqet e Elbasanit, Shkodrës, Lezhës dhe Korçës kanë gjithashtu nivele të ulëta të PBB-së për frymë, përkatësisht (70, 72, 74, 75 ndaj 100), por ndërkohë kanë edhe më shumë familje me ndihmë ekonomike në raport me familjet gjithsej, përkatësisht: 28,7; 18; 15,6 dhe 12 për qind.

Nga ana tjetër, qarqet që kanë shënuar nivele më të larta të PBB-së për frymë kanë regjistruar më pak familje me ndihmë ekonomike, si: qarku i Durrësit vetëm 1,5 për qind; i Vlorës 2,8 për qind; i Fierit 3,5 për qind; i Tiranës 4 për qind kundrejt familjeve gjithsej.

Grafiku 6: Familjet me ndihmë ekonomike ndaj familjeve gjithsej për vitin 2017, %



Këto të dhëna duhet t'u shërbejnë organeve të qeverisjes vendore dhe qendrore për të bashkëpunuar dhe përmirësuar treguesit e llogarive në nivel kombëtar dhe rajonal.

Theksojmë se që prej janarit 2018 është shtrirë në të gjithë vendin skema e re e ndihmës ekonomike.[7] Zbatimi i kësaj skeme ka bërë të mundur që numri mesatar i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike të ulet nga 80.946 më 2017, në 53.693 më 2018; 27.253 familje ose 33,8 për qind më pak. Kjo ka sjellë edhe uljen e fondeve të shpenzuara për skemën e ndihmës ekonomike nga 4.561.423.322 lekë në vitin 2017, në 3.182.023.380 lekë në vitin 2018; 1.379.399.942 lekë më pak, ose 30,2 për qind.

Shërbimi Social Shtetëror shpjegon se aplikimet për të përfituar ndihmën ekonomike kryhen vetëm nëpërmjet sistemit të pikëzimit, dhe vetë sistemi ka nxjerrë nga skema shumë familje të cilat nuk plotësonin kushtet si familje në nevojë.[8] Duke mbajtur parasysh që varfëria është mjaft e përhapur, sidomos në zonën verilindore të vendit dhe zonat malore në përgjithësi, raste të së cilës evidentohen edhe nga media elektronike

7) VKM nr.955, datë 7.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr.5, datë 17.2.2017, "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind".

8) Shërbimi Social Shtetëror. Raport 2018. Janar 2019. F. 53.

dhe e shkruar, kam mendimin se duhet bërë një punë më e kujdesshme për ta vlerësuar gjendjen konkrete në vend dhe jo thjesht përmes pikëzimit, pasi vetëm në këtë mënyrë do të kemi një vlerësim më realist për nevojat financiare për familjet e varfra.

Një lidhje e drejtpërdrejtë del edhe nga PBB për frymë e popullsisë dhe raporti i ndërmarrjeve aktive me familjet gjithsej në qarqe. Kështu p.sh., qarku i Kukësit dhe Dibrës, që kanë regjistruar PBB për frymë më të ulët se qarqet e tjera, kanë gjithashtu edhe më pak ndërmarrje aktive në raport me numrin e familjeve gjithsej, përkatësisht 12,2 dhe 11,6 për qind. Një prirje e tillë është edhe për Elbasanin dhe Lezhën e ndonjë qark tjetër *(Tabela 14)*.

Qarqet me PBB më të ulët për frymë kanë gjithashtu edhe më pak të punësuar në sektorin bujqësor privat në raport me familjet gjithsej. Kështu, ndërsa ky raport në shkallë vendi është 70 për qind, në qarkun e Kukësit është 20,9 për qind, në qarkun e Dibrës 26,7 për qind, në qarkun e Elbasanit 30 për qind etj. Në të kundërt, në qarkun e Tiranës, me nivelin më të lartë të PBB-së për frymë, të punësuarit në sektorin jobujqësor kundrejt familjeve gjithsej kanë edhe treguesin më lartë (127,3%), në qarkun e Durrësit 72,4 për qind etj *(Tabela 15)*.

***Tabela 14**: Numri i ndërmarrjeve aktive në përqindje ndaj familjeve gjithsej, për vitin 2017*

Qarqet	Ndërmarrje aktive	Në % ndaj familjeve gjithsej
Gjithsej	**162.452**	**24**
Kukës	1.946	12,2
Dibër	2.906	11,6
Elbasan	13.201	20,9
Lezhë	5.354	18,7
Korçë	13.814	27,1
Shkodër	11.603	25,1
Gjirokastër	4.847	29,4
Berat	8.763	29,9
Tiranë	54.291	25,2
Fier	20.818	31,0
Vlorë	11.946	25,3
Durrës	12.963	18,2

***Burimi**: INSTAT. NUTS, 2013-2018 dhe llogaritje të autorit.*

***Tabela 15**: Të punësuar në sektorin privat jobujqësor për vitin 2017 në përqindje ndaj familjeve gjithsej*

Qarqet	Të punësuar në sektorin jobujqësor	Në %
Shqipëria	475.019	70,2
Berat	11.533	39,3
Dibër	6.700	26,7
Durrës	51.572	72,4
Elbasan	19.013	30,1
Fier	27.480	40,9
Gjirokastër	7.666	46,5
Korçë	17.132	33,6
Kukës	3.323	20,9
Lezhë	11.701	40,8
Shkodër	21.577	46,7
Tiranë	274.482	127,3
Vlorë	22.840	48,4

***Burimi**: INSTAT. Vjetari statistikor rajonal 2018. F. 93.*

Në përfundim mund të shprehemi se INSTAT-i, me përgatitjen dhe botimin e Llogarive Rajonale Statistikore sipas kritereve metodologjike dhe standardeve të EUROSTAT-it, prej vitit 2011 ka sjellë një risi dhe ka krijuar mundësi për analiza më të thelluara për rritjen dhe zhvillimin në nivel makro dhe mikroekonomik jo vetëm në shkallë kombëtare, por edhe rajonale. Publikimi i këtyre të dhënave rrit transparencën për studiuesit dhe specialistët, por edhe qytetarët e interesuar për ecurinë e treguesve ekonomikë dhe socialë në njësi të ndryshme territoriale dhe kohore.

Përdorimi i kritereve të njëjta metodologjike me strukturat e BE-së ka krijuar kushtet për krahasime të PBB-së dhe treguesve të tjerë në shkallë kombëtare dhe rajonale me mesataren e BE-së si dhe me vende që përbëjnë këtë organizëm unik europian. PBB përbën një tregues që karakterizon rritjen ekonomike, por i llogaritur për frymë të popullsisë na orienton të kryejmë analiza më të thelluara për nivelin e pasurisë apo varfërisë së një vendi, rajoni dhe qarku.

Nga analiza e ecurisë së PBB-së në vite, del se qarku i Tiranës ka regjistruar nivelin më të lartë në të gjitha këndvështrimet. Referuar vitit 2017, që përmban edhe të dhënat më të fundit, del se qarku i Tiranës ka regjistruar nivelin më të lartë të PBB-së për frymë të popullsisë prej 746.780 mijë lekë,

duke tejkaluar me 38 indeksin prej 100 në shkallë vendi. Pozitiv është edhe fakti që të dhënat e PBB-së për frymë të popullsisë janë llogaritur jo vetëm në lekë, por edhe në euro dhe usd dhe sidomos PPS, gjë që na jep mundësi të bëjmë krahasime me vende të tjera të rajonit apo edhe të BE-së, ku dhe synojmë të integrohemi. Në pesë vjetët e fundit (2012 – 2017), PBB për frymë i llogaritur në PPS ka mbetur në indeksin prej 30,4 ndaj BE28=100.

Të dhënat e PBB-së për frymë të popullsisë në përgjithësi reflektojnë edhe ecurinë e treguesve të tjerë administrativë, si të familjeve me ndihmë ekonomike, të njësive të biznesit të vogël e të mesëm etj. Kështu, qarku i Kukësit dhe qarku i Dibrës, që kanë treguesin më të ulët të PBB-së për frymë të popullsisë, kanë gjithashtu edhe numrin më të madh të familjeve me ndihmë ekonomike, si dhe numrin më të vogël të ndërmarrjeve aktive në qarqet dhe treguesit e punës.

Shpërpjesëtimet e ndjeshme të PBB-së për frymë midis rajoneve statistikore nivel 2 dhe nivel 3 (qarqeve) duhet të tërheqin vëmëndjen e organeve të qeverisjes qendrore e vendore, për një zhvillim ekonomik më të balancuar nga pikëpamja territoriale, për një shpërndarje më të drejtë të investimeve publike, për një ndihmë më konkrete për zhvillimin e biznesit privat e sidomos të biznesit të vogël, për zhvillimin e turizmit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Sipas Kushtetutës së RSh (nenit 110), qarku është njësia ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore. Për fat të keq, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore nuk kanë mundur ta konkretizojnë këtë detyrë kushtetuese. Reforma administrative-territoriale, e cila është bërë efektive prej vitit 2015 me krijimin e 61 bashkive të reja dhe vijimin e 12 qarqeve, ka krijuar kushtet që të rritet bashkëpunimi midis organeve vendore dhe atyre qendrore për hartimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në shkallë rajonale, qarku dhe bashkie.

Literatura:

1. INSTAT. Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistikore në Shqipëri, 2017. 29 maj 2019.

2. ESA95terminology.cso.ie/en/media/csoie/methods/ /nationalaccountsoutputandvalueaddedbyactivity/ methodology.

3. EUROSTAT.

4. Shërbimi Social Shtetëror. Raporti 2018. Janar 2019.

5. Vendimi i KM nr.1037, datë 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës "Shqipëria në 3 (tre) rajone NUTS II" sipas nomenklaturës mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Europian.

KRIZA DEMOGRAFIKE NË SHQIPËRI DHE DISA MASA PËR ZBUTJEN E SAJ

Dr. ***Pasko VAKO***

Abstract

This paper aim to present some main reasons of the demographic crisis in Albania population. In this paper is underlining the fact that this crisis was caused by the interaction in the same time of the raise of massive emigration and the decreasing of the birth rates. Albania during the last 28 years has registered a population number that has been every year more lower: from 3,180.4 thousand people in 1989, to 2,884.6 thousand in 2017, ore 9.3 per cent more less. Unfortunately, the process of emigration is continuing yet. Author accounted that since 1990 till now, the number of emigrants is about 1,745 thousand persons. The paper is analyzing the factor of the population decreasing that is the reduction of brith rate. The Synthetic fertility index (SFI) has achieved to 1.54 children per mother in 2016 toward 3.0 children per mother in 1990. In the paper are analizying the reasons of the continuing of the emigration and the decreasing of the birth rate, their negative consequencies in Albania as well as suggest some measures for the gradual facilitation.

Key words*: Demography crisis; Albania population; Massive emigration; Birth rate; Death-rate; Transition period.*

1. Numri i popullsisë pas vitit 1990 ka vijuar në rënie

Vendi ynë është futur në një krizë demografike që vazhdon dhe sa vjen e thellohet gjithnjë e më shumë. Por cilat janë faktet/treguesit që e vërtetojnë këtë konkluzion? Për këtë na vijnë në ndihmë të dhënat e paraqitura në tabelën që vijon.

Të dhënat tregojnë se pas Luftës II Botërore (1945), popullsia e Shqipërisë është rritur në mënyrë të pandërprerë, ritmi mesatar vjetor i rritjes së saj ka qenë 1,8 për qind, duke bërë që popullsia të trefishohet në

harkun e 50 viteve të fundit të shekullit XX dhe të arrijë nivelin e saj më të lartë në vitin 1989. Kjo prirje u përmbys në periudhën e tranzicionit dhe në vend të saj filloi rënia e numrit të popullsisë, e cila ka vijuar gjatë 28 vjetëve dhe, po nuk u morën masat e nevojshme, do të thellohet edhe më tej. Ndërsa numri i familjeve është rritur deri në vitin 2001, pas të cilit fillon rënia e tyre.

Numi i popullsisë dhe familjeve shqiptare në vitet 1923-2017

Vitet	Numri i popullsisë			Numri i familjeve	Pjesëtar/ familje
	MF	M	F		
1923	814.380	421.618	392.762	143.065	5,7
1930	833.618	428.959	404.659	146.249	5,7
1945	1.122.044	570.361	551.683	196.850	5,7
1950	1.218.945	625.936	593.009	211.613	5,8
1955	1.391.499	713.316	678.183	251.756	5.5
1960	1.626.315	831.294	795.021	279.805	5,8
1969	2.068.155	1.062.931	1.005.224	346.588	6,0
1979	2.590.600	1.337.400	1.253.200	463.333	5,6
1989	3.182.417	1.638.074	1.544.343	675.456	4,7
2001	3.069.275	1.530.443	1.538.832	726.895	4,2
2011	2.800.138	1.403.059	1.397.079	722.262	3,9
…	…	…	…	…	…
2017	2.870.324	1.465.402	1.404.922		

Rënia kaq e madhe e numrit të popullsisë sonë i dedikohet në një shkallë më të madhe emigracionit të jashtëm. Ky emigracion ndryshoi ndjeshëm strukturën moshore të popullsisë, çka është shkaku kryesor i migracionit neto negativ, ku dhe shtesa e përgjithshme është negative. Kjo rënie kaq e madhe ndikoi të gjithë komponentët e riprodhimit, si: lindshmërinë dhe vdekshmërinë. Ndërsa ndryshimet në lindshmëri dhe vdekshmëri janë faktorë objektivë të zhvillimit, ndryshimet nga ndërrimi i shtetit i përkasin faktorit subjektiv-emigracionit, i cili duhet të rregullohet nga shteti duke krijuar kushte për ta frenuar.

Shkaqet kryesore të rënies së numrit të popullsisë sonë janë emigrimi me ritme të larta dhe i pandalshëm dhe ulja e theksuar e lindshmërisë, ndërkohë vdekshmëria e përgjithshme ka një rritje të lehtë, e cila do të shtohet me plakjen e popullsisë.

2. Emigrimi masiv gjatë periudhës së tranzicionit, shkaqet dhe pasojat

Pas viteve 1990 në vend ndodhën lëvizje të mëdha të popullsisë, si të brendshme ashtu edhe të jashtme. Sipas të dhënave të censuseve gjatë periudhës 1989 – 2001, afërsisht 700.000[1] shqiptarë u larguan nga vendi. Për herë të parë pas këtij eksodi masiv u vu re një rënie demografike e popullsisë. Gjatë periudhës 2001 – 2011, edhe 573.000[2] persona më shumë janë larguar nga vendi nga sa kanë hyrë në të, afërsisht në numër të barabartë ndërmjet meshkujve dhe femrave. Theksojmë se shumica e të gjithë emigrantëve (mbi 1 milion) pas vitit 1990 u vendosën në Greqi dhe Itali.

Por, për fat të keq, emigrimi i njerëzve, kryesisht i të rinjve, nuk u ndal, por vijon. Emigrantëve iu bashkuan edhe dhjetëra mijë azilkërkues, një pjesë e të cilëve po kthehen.

Gjatë periudhës 2012 –2017, sipas të dhënave të INSTAT-it, mbi lëvizjet e shtetasve shqiptarë jashtë shtetit, kemi pasur më shumë dalje sesa hyrje, të cilat paraqiten në tabelën 1.

Nga analiza e këtyre të dhënave, duket qartë prirja e rritjes së numrit të daljeve me ritme më të larta se ato të hyrjeve, për rrjedhojë edhe rritja e numrit të të pakthyerve në vend. Nëse të pakthyerit çdo vit nuk i konsiderojmë të gjithë emigrantë, pasi midis tyre ka shumë vizitorë tek të afërmit e emigruar më parë dhe që kthehen, studentë që kthehen pas përfundimit të studimeve, të sëmurë për kurim, azilkërkues, emigrantë që kthehen etj.

Por llogarisim se jo të gjithë këta të pakthyer, as gjysma e as 1/3 e tyre, por vetëm 1/4 e të pakthyerve në total, e them me bindje të plotë, janë emigrantë. Kështu që rezulton se në këto gjashtë vjet kanë emigruar afërsisht 472.000 persona.

Kështu, nëse mbledhim të gjithë emigrantët që nga viti 1990 e deri në 2017 (700.000 + 573.000 + 472.000), duke lënë pa përfshirë/llogaritur edhe shtesën natyrore të vetë emigrantëve gjithsej, rezulton një shifër prej 1.745.000 persona, e cila duket një shifër e pranueshme – për mendimin tim është e drejtë – që përbën 60,8% të popullsisë së sotme, ose, thënë ndryshe, rreth 3/5 e kësaj popullsie kanë emigruar jashtë vendit.

Emigrimi ka mbetur një forcë konstante në ndryshimin e popullsisë si përpara Censusit të vitit 2011, ashtu edhe deri në vitin 2017. Varfëria

1) INSTAT 2004.
2) INSTAT 2014.

dhe papunësia reale e lartë kanë qenë dhe mbeten motivet kryesore të vijueshmërisë së emigracionit.

***Tabela 1**: Lëvizja e popullsisë shqiptare jashtë shtetit, daljet dhe hyrjet*

Dalje/ hyrjet	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**
Dalje	3.959.265	3.928.245	4.145.608	4.503.907	4.852.483	5.186.100
Hyrje	3.620.665	3.653.972	3.872.010	4.098.526	4.592.503	4.851.622
Të pakthyer	338.600	274.273	273.598	405.381	259.980	334.478



Veçanërisht këto vitet e fundit po emigrojnë shumë persona që kanë pasur një punë dhe sidomos nga ata me arsim të lartë, me tituj shkencorë, mjekë e infermierë, të rinj të diplomuar në universitetet më të mira të botës, biznesmenë të suksesshëm. Pra, po largohen jo vetëm të varfrit e të papunët, por edhe të punësuarit, jo vetëm fshatarë, por edhe qytetarë.

Migrimi i popullsisë në kushtet e sotme shihet si një proces i ndërlikuar që ushtron ndikim të konsiderueshëm në ndryshimin e numrit dhe strukturave të popullsisë, në nivelin dhe strukturën e punësimit, në shpërndarjen e popullsisë, në ndryshimet e grupeve sociale të saj, në marrëdhëniet etnike dhe të atyre midis shteteve, në stabilitetin social etj.

Migrimi është i lidhur ngushtë me strategjinë ekonomiko-sociale të përshtatjes së popullsisë ndaj kushteve të jetesës. Ndikimin më të madh në zhvillimin ekonomik dhe social e ushtron migracioni i punës, veçanërisht lëvizja e fuqisë punëtore që ka kualifikim të lartë.

Në kushtet e krizës demografike dhe të pasojave negative të emigrimit është e nevojshme të përpunohen konceptet standarde të politikës së migrimit, përmirësimi i burimeve të të dhënave për migrimin, si për atë të brendshëm ashtu edhe për atë të jashtëm.

Emigrantët janë të moshave të reja dhe të arsimuar dhe kjo ka ndryshuar mjaft edhe strukturën moshore dhe atë gjinore të gjithë popullsisë, duke ulur peshën e të rinjve dhe rritur atë të të moshuarve. Nga ana tjetër, ata jo vetëm që kanë përmirësuar jetesën e tyre, por me dërgesat e tyre çdo vit të qindra milionë eurove e kanë shtuar PBB-në e vendit tonë dhe kanë rritur konsumin e popullsisë, duke kontribuar në përmirësimin e nivelit të jetesës së saj.

Popullsia zhvillohet kur ajo lëviz, rritet shkalla e urbanizimit si motor i zhvillimit ekonomiko-social të vendit (sidomos nga migrimi i brendshëm); rritet PBB e vendit dhe ajo për frymë si nga dërgesat e emigrantëve, ashtu edhe nga ulja e numrit të popullsisë; ulet papunësia pasi emigrojnë të papunët; zvogëlohet përbërja numerike e familjeve etj.

Pra, emigrimi, si karakteristikë kryesore e të rinjve, ka qenë edhe një ndër faktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik e social të vendit.

Shkaqe kryesore të nxitjes së emigracionit janë: pasiguria e jetesës, varfëria, papunësia, humbja e shpresës, pagat e ulëta, kërkesat për një arsimim dhe shëndetësi më të mirë, bashkimet familjare, ftesat e të huajve (lotaria amerikane, kërkesat e Gjermanisë për mjekë e infermierë) etj.

3. Ulja e lindshmërisë, shkaqet dhe pasojat

Treguesi më i përshtatshëm që karakterizon në mënyrë të plotë nivelin e lindshmërisë, është indeksi sintetik i fekonditetit (ISF).[3] Në periudhën 1960 deri në 2011, ISF u ul gjithsej me 5,21 fëmijë për një grua (nga 6,9 në 1,69). Prej tyre 3,3 fëmijë ose afro 75% e uljes së përgjithshme u takon 30 viteve të periudhës 1960 – 1990 dhe 25% e uljes së përgjithshme u takon 21 viteve të tjera pas vitit 1990 (periudhës 1990 – 2011).

Por me gjithë ndryshimet e lindshmërisë si dhe uljen e vdekshmërisë, popullsia shqiptare gjatë periudhës 1960 – 1990 u rrit me 1.556.102 banorë (nga 1.626.315 më 1960, në 3.182.417 banorë), pra gati u trefishua.

Ulja e theksuar e ISF ndodhi edhe në harkun e viteve 1975 – 2011, madje edhe deri në vitin 2017. ISF ra nën nivelin e zëvendësimit që është 2,1 fëmijë për grua duke filluar që nga viti 2002 e në vazhdim, domethënë ra nën nivelin e riprodhimit të thjeshtë të popullsisë. Sot, një çift nuk arrin të zëvendësojë veten. Lindshmëria ka rënë në të gjitha grupmoshat, me rënie më të madhe në grupmoshën 40-44 vjeç.

Deri në vitin 1990 popullsia e Shqipërisë është rritur gati tërësisht nga rritja natyrore neto, pasi emigrimi ka qenë i ndaluar.

Koeficienti bruto i riprodhimit (KBR), që mat normën me të cilën gratë zëvendësojnë veten e tyre (me vajza) gjatë viteve të tyre të jetës riprodhuese, është një tregues i mirë për matjen e rritjes së brezave të ardhshëm. Mesatarja e KBR gjatë periudhës 2006 – 2015 është 0,79; që do të thotë se gratë në Shqipëri janë 21% larg zëvendësimit të vetvetes. Ky tregues ndikohet direkt nga sjellja riprodhuese e grave e shprehur nga ISF dhe nga raporti gjinor në lindje. Rritja e ISF rrit edhe KBR.

***Tabela 2**: Indeksi specifik i fekonditetit (ISF) në vitet 1950-2016*

Fëmijë për një grua

Vitet	**1950**	**1955**	**1960**	**1965**	**1970**	**1975**	**1980**
ISF	6,1	6,8	6,9	5,6	5,2	4,6	3,6
Vitet	**1985**	**1990**	**2001**	**2002**	**2008**	**2015**	**2016**
ISF	3,3	3,0	2,3	1,9	1,6	1,67	1,54

Nga të dhënat, del se ISF deri në 1960 është rritur duke shënuar nivelin më të lartë prej 6,9 fëmijë për një grua. Më pas ky tregues vjen duke u ulur deri në 1,5 fëmijë për një grua më 2016, ose rreth 4,5 herë më pak.

Nga viti 2001, numri i fëmijëve të lindur është më i vogël se numri i prindërve të tyre. Nisur nga kjo ecuri e ISF, rezulton që pas 2-3 viteve lindjet do të barazohen me vdekjet dhe pas 4 viteve do të kemi më shumë vdekje se lindje dhe një shtesë natyrore negative.

Para disa vitesh në Shqipëri mbizotëronte tipi agrar i civilizimit, ku shumica e popullsisë jetonte në fshat dhe lindjet ishin të larta, por edhe

---

3) Indeksi sintetik i fekonditetit (ISF): Numri mesatar i fëmijëve që një grup hipotetik grash do të ketë në fund të periudhës riprodhuese të tyre nëse ato do të ishin subjekt gjatë gjithë jetës së tyre ndaj koeficientëve specifikë të lindshmërisë së një periudhe të dhënë. Shprehet me fëmijë për grua. INSTAT. Shqipëri. Projeksionet e popullsisë, 2011-2031. Shtojca 1: Fjalorthi dhe metodat. F. 55.

vdekshmëria foshnjore ishte e lartë. Tani kushtet kanë ndryshuar, jetojmë në një shoqëri urbane të civilizimit dhe të zhvillimit të ekonomisë dhe të mjekësisë, kemi hyrë në modelin e ri demografik, ku fëmijët që lindin ka mundësi të jetojnë, rriten, arsimohen dhe përgatiten më mirë për të ardhmen. Niveli i tanishëm i ISF-së së Shqipërisë po i afrohet ISF-së mesatare të BE-së. Përveç uljes së numrit mesatar të fëmijëve për grua, lindshmërinë e ka ulur shumë edhe ulja e numrit të grave të kontigjentit riprodhues. Vetëm gjatë periudhës 2011– 2017 ky kontigjent është ulur –6% ose me – 42.873 gra dhe, gjatë periudhës 2017 – 2031 pritet të ulet me –15% ose me 100.357 gra më pak se në 2017.

Grafiku 2: Indeksi specifik i fekonditetit (ISF) në vitet 1950-2016



Vetëm 4 vende në Europë e kanë ISF-në më shumë se 2 fëmijë për grua. Shqipëria tani e ka ISF-në më të ulët se 12 vende të tjera evropiane si Belgjika, Holanda, Danimarka, Anglia, Norvegjia, Finlanda, Suedia, Mali i Zi, Estonia, Sllovenia e Lituania dhe më të lartë se 23 vende të tjera. Shqipëria e ka ISF-në më të lartë sesa Greqia dhe Maqedonia e Veriut dhe afro të njëjtë me Lituaninë, por më të ulët se Kosova (1,98).

Përveç sa më sipër, në uljen e lindshmërisë kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë si:

- Rritja e raportit gjinor në lindjet në vitet e periudhës 1990 – 2016, nga i cili rezultojnë të munguara në popullsinë tonë 33.020 vajza, të cilat ulin kontigjentin riprodhues të popullsisë në vitet kur përkatësisht u takon të futen në moshë riprodhimi, gjithashtu ulin edhe popullsinë në moshë pune.

■ Abortimi me dashje i vajzave ose aborti selektiv i tyre, më tepër nga abortimi i djemve, nga një pjesë prindërish si rrjedhojë e traditave, besimit, mentalitetit se vetëm djali e mban familjen etj. Pa marrë parasysh pasojat për nënat, ulin lindjet e kohës kur bëhet abortimi i vajzave dhe këto pas 15 vjetëve do t'i mungojnë kontigjentit riprodhues dhe popullsisë në moshë pune, do të kemi më pak lindje, më pak krahë pune, më pak martesa.

■ Rritja e moshës mesatare të nënave në lindje, lindja e më pak fëmijëve nga çiftet e reja, infertiliteti (shterpësia) etj. janë shkaqe të tjera që ndikojnë në uljen e lindshmërisë.

■ Faktorë të tillë si: kostoja e rritjes së një fëmije, mundësitë e gruas për shkollim dhe pozitë profesionale më të mirë, statusi martesor, përfshirë këtu divorcet në rritje, si dhe kërkesa për përputhshmëri mes jetës familjare dhe jetës profesionale etj., janë gjithashtu shkaqe të uljes së lindshmërisë.

■ Ulja e ndjeshme e lindshmërisë u shkaktua nga rritja e nivelit të jetesës, nga rritja e moshës mesatare të grave të martuara, që erdhi nga emancipimi social dhe rritja e nivelit arsimor të grave, nga urbanizimi i vendit, nga ulja e vdekshmërisë foshnjore, nga rritja e numrit të divorceve dhe të aborteve, nga emigrimi i madh i popullsisë në moshë riprodhimi, nga planifikimi familjar, nga rritja e nivelit arsimor e kulturor të popullatës etj.

Lindshmërinë e kanë ulur edhe lëvizjet e mëdha të popullsisë pas viteve 1990 si brenda ashtu edhe jashtë vendit (sidomos ato nga zonat rurale në ato urbane). Rritja e kujdesit për shëndetin e njerëzve, bashkë me rritjen e nivelit të jetesës, ulin vdekjet e fëmijëve, çka çon edhe në uljen e lindjeve.

4. Analiza e vdekshmërisë dhe rritja e saj në të ardhmen

Pa dyshim që edhe vdekshmëria ka pjesën e saj në krizën demografike që po kalon vendi ynë. Në një periudhë gjysmëshekullore vendi ynë ka pasur një ulje të ndjeshme të vdekshmërisë në tërësi. Por rënia masive e saj ka qenë brenda dekadës 1950 – 1960, si rrjedhojë e luftës kundër sëmundjeve parazitare dhe ngjitëse, që përbënin shkaqet kryesore të vdekjeve para Luftës. Kjo prirje vijoi edhe gjatë dekadave të mëvonshme.

Vdekjet janë ulur në të gjitha moshat dhe në të dyja gjinitë, por më e ndjeshme ka qenë te femrat sesa te meshkujt. Përmirësimet më të dukshme janë shënuar në uljen e vdekshmërisë foshnjore dhe në atë të fëmijëve 1– 4 vjeç.

Vdekshmëria foshnjore dhe e fëmijëve pas Luftës ishte shumë e lartë, 143,1 vdekje për 1000 të lindur gjallë, kurse në vitin 1950 kishte 105,3

vdekje për 1000 fëmijë të moshës 1– 4 vjeç. Pas vitit 2000 këta tregues u ulën ndjeshëm dhe në vijimësi. Vdekshmëria foshnjore sot është 8 – 9 për 1000 të lindur gjallë, por, e krahasuar me vendet evropiane është ende e lartë.

Në vijim vdekshmëria gjithsej do të vijë duke u rritur, pasi të moshuarit, sidomos ata mbi 80 vjeç, do të jenë më shumë se sot dhe në veçanti meshkujt kanë vdekje më të larta.

Në vitin 2017, qarku i Gjirokastrës dha sinjalin e më shumë vdekjeve sesa lindjeve. Këtë prirje ka pasuar edhe qarku i Korçës. Të dy këto qarqe kanë regjistruar rënie të popullsisë së tyre. Pas 2-3 vitesh vdekjet do të kalojnë lindjet edhe në qarqe të tjera.

Vdekshmëria karakterizohet me treguesin e numrit absolut, me koeficientin bruto të tyre, por duke qenë se koeficienti jep vetëm një paraqitje të pjesshme të procesit, sepse nuk llogarit ndikimin e strukturës moshore të popullsisë, si tregues bazë dhe më i përshtatshëm është ai i jetëgjatësisë mesatare në lindje.

Si rrjedhojë e uljes së theksuar të vdekshmërisë, u rrit ndjeshëm edhe jetëgjatësia mesatare në lindje, e cila nga 51,6 vjeç në 1950 u rrit në 74,6 vjeç në 2000 dhe në 78,5 vjeç për të dyja gjinitë; 77,0 për meshkujt dhe 80,1 vjeç për femrat në vitin 2016.

Gratë jetojnë mesatarisht 3,1 vjet më shumë se burrat. Vdekshmëria më e madhe e meshkujve gjatë jetës do të thotë që femrat janë më të shumta në numër sesa meshkujt në moshë më të vjetër dhe diferenca është mjaft e gjerë mes të vjetërve më të moshuar. Mes të gjithë të moshuarve 65 vjeç e lart, ka 91 meshkuj për çdo 100 femra në vitin 2011 dhe për të vjetrit më të moshuar 80 vjeç e lart ka vetëm 66 meshkuj për çdo 100 femra. Përmirësimi më i ndjeshëm i jetëgjatësisë u arrit në dekadën 1950 – 1960, kur rritja ishte 10,4 vjet ose mesatarisht më shumë se një vit zgjatje jete për çdo vit kalendarik.

5. Shkaqet e krizës demografike

Kriza demografike te ne ka filluar pas vitit 2002, kur ISF ra nën 2,1 fëmijë për grua dhe brezi i të lindurve ishte më i vogël se ai i prindërve. Pasojat e rënda e negative lidhen me uljen e numrit dhe të ritmeve të rritjes së popullsisë; me uljen sot e në të ardhmen të popullsisë në moshë pune (15 – 64 vjeç), ku përpjesa e të rinjve 15 – 29 vjeç që janë më të fortë, më

produktivë e më të arsimuar ka ulje të theksuar.

Kriza demografike shfaqet me ulje të kontigjentit riprodhues të grave, të lindjeve të cilat në periudhën 1990 – 2017 kanë rënë – 63%, me uljen e ISF-së, me ulje të grupmoshës së fëmijëve 0 – 14 vjeç, me moshimin dhe plakjen e përshpejtuar të popullsisë, me shtimin e vdekshmërisë, me rritjen e numrit të personave në ngarkim të një punonjësi aktiv, me rritjen e shpenzimeve nga buxheti i shtetit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Pas 2-3 vitesh pritet që të barazohen lindjet me vdekjet nga ulja e lindjeve e rritja e vdekjeve. Pasojat e këtij fenomeni do të shfaqen me uljen e numrit të nxënësve e studentëve, si rrjedhojë edhe me uljen e mësuesve e pedagogëve dhe me reduktimin shkollave e të universiteteve; me shpopullimin e shumë zonave të vendit nga migrimi dhe mbetjen pa fuqi punëtore për shfrytëzimin e burimeve natyrore në to; me rritjen e familjeve me një pjesëtar, kryesisht familjet e nënave; me shtimin e çifteve të të moshuarve në zonat rurale, pasi fëmijët janë larguar nga fshati; me lindje më të shumta jashtë martese etj.

Krizën demografike në vendin tonë e thelloi bashkëveprimi i njëkohshëm i emigrimit masiv e të pandërprerë gjatë tri dekadave, me uljen e vazhdueshme të lindshmërisë. Në të ardhmen e afërt këtij bashkëveprimi (po nuk u morën masat e duhura) do t'i shtohet edhe rritja e vdekshmërisë nga plakja në vazhdimësi e popullsisë. Me politika të koordinuara dhe me masa të plota do të ketë rezultate shpresëdhënëse dhe me gjithë vazhdimësinë e krizës demografike, përsëri mund të ngadalësohen tendencat demografike negative.

Shkaqet ose faktorët e krizës mund të përmblidhen në grupe të tilla si: demografike, ekonomiko-sociale, shëndetësore, etike etj.

Shqipëria po përjeton një vjetrim demografik të popullsisë (plakje të saj) ndërkohë që deri në fillimet e vitit 2000 është konsideruar me popullsi të re: numri i fëmijëve 0 – 14 vjeç e kalonte disa herë numrin e të moshuarve 65+ vjeç. Duke filluar nga viti 1990, pesha e fëmijëve ka pësuar ulje të vazhdueshme e shoqëruar me rritjen e ndjeshme të të moshuarve, si rezultat i uljes së lindshmërisë dhe i emigracionit të të rinjve.

Aktualisht, vendi ynë, popullsinë e moshuar (65+) e ka 13,4% të të gjithë popullsisë. Sipas prognozave të INSTAT-it, të moshuarit në 2021 do të përbëjnë 15,3% dhe në vitin 2031 do të arrijnë në 21,3%. Nga ana tjetër, fëmijët deri në 15 vjeç do të përbëjnë përkatësisht 17,1% dhe 15,7%. Me plakjen e popullsisë do të kemi edhe rritje të vdekshmërisë. Pra procesi i moshimit demografik do të vazhdojë edhe për disa dekada të tjera.

Vazhdimi i pandërprerë i emigrimit, rënia e lindshmërisë dhe rritja e vdekshmërisë janë procese demografike që karakterizojnë prishjen e procesit të riprodhimit të popullsisë, i cili sjell pasoja negative për të sotmen e për të ardhmen, duke ndikuar në uljen e numrit të popullsisë, në uljen e popullsisë në moshë pune, në uljen e kontigjentit riprodhues të grave, në uljen e grupmoshës së të rinjve, në largimin e trurit të kombit etj.

Pasojat më të rënda nga emigracioni dhe nga ulja e lindshmërisë kanë sjellë ulje të numrit të popullsisë dhe shpopullim të shumë zonave të vendit. Në vitin 1989 popullsia ishte 3.180,4 mijë banorë, kurse në vitin 2017 llogaritet në 2.884,6 mijë banorë, – 295,8 mijë banorë më pak. Pasojë e drejtpërdrejtë e kësaj rënieje të popullsisë gjithsej është rënia e popullsisë në moshë pune 15 – 64 vjeç pas vitit 2017 *(Tabela 3*).

Këto të dhëna tregojnë se numri i popullsisë në moshë pune deri në vitin 2017 ka qenë në rritje si rezultat i futjes në moshë pune të kontigjenteve nga lindjet më të larta, pas kësaj vijon ulja e vazhdueshme, derisa në vitin 2031 arrin në – 8% ose 150.272 persona në moshë pune më pak se në vitin 2011 (pa llogaritur të emigruarit në 6 vitet e fundit).

Të rinjtë e grupmoshës 15– 29 vjeç, që janë pjesë e rëndësishme e popullsisë në moshë pune, janë më të fortë, më të arsimuar, do të ulen dhe do ta moshojë popullsinë në moshë pune. Të rinjtë do të ulen si nga ulja e lindjeve, ashtu edhe nga emigrimi i tyre jashtë shtetit. Shumë më shqetësuese bëhet ulja e peshës së të rinjve, po të përfshijmë edhe të rinjtë e pakthyer (që gjykohet se kanë emigruar) gjatë 6 viteve të fundit (2012 – 2017), për të cilët nuk kemi të dhëna sipas moshës, por që me siguri janë sa 1/2 e 472 mijëve të pakthyer.

***Tabela 3**: Popullsia në moshë pune 15 – 64 vjeç*

Vitet	**2011**	**2017**	**2021**	**2025**	**2031**
Numri i popullsisë	1.904.000	1.980.406	1.934.770	1.858.135	1.753.128

Kontigjenti i femrave në moshë riprodhimi (15 – 49 vjeç) do të ulet vazhdimisht *(Tabela 4)*. Të dhënat tregojnë për një ulje të pandërprerë të kontigjentit riprodhues të popullsisë sonë dhe në vitin 2031 kjo ulje do të jetë – 19,6%, ose do të kemi 143.230 femra riprodhuese më pak (pa përfshirë uljen nga emigrimi në 6 vitet e fundit). Kjo ulje, bashkë me një ISF të ulët, do të reflektohet edhe në uljen e numrit të lindjeve dhe në atë të popullsisë.

Numri i nënave potenciale (që lindin pjesën më të madhe të fëmijëve) në moshë 20-34 vjeç do të ketë ulje ngaqë janë pakësuar lindjet e viteve 1990 – 2000 që futen në kontigjentin riprodhues të grave. Do të kemi më pak nëna që lindin fëmijë dhe më shumë të moshuara. Prandaj lindshmëria mund të rritet duke rritur gradualisht ISF-në, duke ulur vdekshmërinë foshnjore dhe me masa të tjera që do të ndikojnë në rritjen e lindjeve.

***Tabela 4**: Numri i femrave në moshë 15 – 49 vjeç*

Vitet	**2011**	**2017**	**2021**	**2025**	**2031**
Numri i femrave	731.062	688.189	648.388	616.410	587.832

Ulje të ndjeshme të numrit të fëmijëve në moshë 0 – 14 vjeç *(Tabela 5)*. Nga 33% që zinin fëmijët nën 15 vjeç në vitin 1989, në vitin 2011 u ul në 21%. Ndërsa në vitin 2031 ulja do të jetë – 30,2%, ose do të kemi më pak se në vitin 2011 edhe 189.169 të rinj (pa llogaritur të emigruarit gjatë 6 viteve të fundit). Ndërsa në vitin 2001 fëmijët ishin 4 herë më shumë sesa të moshuarit, në vitin 2024 të moshuarit do të jenë më shumë se fëmijët.

***Tabela 5**: Numri i fëmijëve të grupmoshës 0-14 vjeç*

Vitet	**2011**	**2017**	**2021**	**2025**	**2031**
Numri i fëmijëve	626.870	518.609	489.135	474.786	437.701

Të gjitha sa më lart do të sjellin rritje të ndjeshme të popullsisë së grupmoshës së tretë dhe plakjen e popullsisë. Brenda një procesi të përgjithshëm të rënies së popullsisë, të moshuarit janë segmenti i vetëm që po rritet shpejt dhe që mund të përfaqësojë 1/3 e gjithë popullsisë në vitin 2031, siç dëshmohet nga të dhënat e tabelës 6.

Në dallim nga rastet e uljeve të mëparshme, këto të dhëna tregojnë rritje shumë të shpejtë dhe dëshmojnë për një thellim të mëtejshëm të plakjes së popullsisë sonë. Në afro tre dekada ndodhi një transformim demografik i veçantë (sidomos nga emigrimi), ku të moshuarit rriten, ndërsa fëmijët e të rinjtë ulen. Të moshuarit që jetojnë si çift pa fëmijë janë rritur nga 24 për qind në 2001, në 32 për qind në 2011. Rreth 30 për qind jetojnë në familje me dy persona dhe 8 për qind jetojnë vetëm. 77% e të moshuarëve janë gra.

***Tabela 6**: Numri i të moshuarve mbi 65 vjeç*

Vitet	**2011**	**2017**	**2021**	**2025**	**2031**
Numri i fëmijëve	317.600	385.609	439.406	502.421	591.481

Proçesi i plakjes kërkon transformimin e sistemit të pensioneve që kemi dhe plotësimin e kërkesave në rritje për shërbime shëndetësore dhe shpenzime mjekësore. Moshimi ndikon në konsum, në kursime, në investime, në tregun e punës, në përbërjen e familjeve, jetesën, banimin. Në vitet 2023 – 2024 do të kemi më shumë të moshuar se fëmijë.

Për të kuptuar shpejtësinë e plakjes së popullsisë, po japim treguesin e ritmit të vjetërimit të saj midis viteve të censuseve 1989, 2001 dhe 2011, që del duke vënë në raport koeficientin e varësisë së të moshuarve në 2001 (11,9%) me atë të 1989 (8,6%), e na del ritmi 138,4%; ndërsa nga raporti i koeficientit të varësisë së të moshuarve në 2011 (16,7%) me atë të 2001 (11,9%) na del ritmi i vjetërimit 140,3%.[4] Pra, në dekadën e dytë është rritur më tepër ritmi i vjetrimit të popullsisë, i cili në të ardhmen do të rritet edhe më tej.

Kriza demografike jep *efekt ekonomik pozitiv*, kur pesha e brezit mesatar të popullsisë në moshë pune është maksimale, ndërsa peshat e të rinjve dhe e të moshuarve janë relativisht jo të larta; por jep *efekt ekonomik negativ* kur pesha e të moshuarve është maksimale, ndërsa peshat e të rinjve dhe ajo e brezit mesatar janë relativisht jo shumë të larta.

Pas vitit 2021 do të kemi ulje të burimeve të punës. Me uljen e lindshmërisë ngarkesa e popullsisë në moshë pune rritet përderisa çdo punonjësi i takojnë më shumë pensionistë.

Sa më gjatë të kalojë vendi në krizë demografike, aq më tepër do të ulet popullsia në moshë pune dhe aq më e rëndë do të jetë ngarkesa e punonjësve me pensionistë.

Numri i *nxënësve* që mbarojnë shkollat ulet vazhdimisht, universitetet do të priren për të pranuar çdo student. Si rezultat i uljes së ndjeshme të të rinjve, në të ardhmen pritet të mbyllen edhe mjaft universitete. Numri i nxënësve në vitin 2014 – 2015 në krahasim me vitin 2009 – 2010 është ulur –16%.

---

4) Koeficienti i Varësisë së të Moshuarve (KVM). Raporti i numrit të të moshuarve (me moshë 65 vjeç e lart) kundrejt popullsisë në moshë pune (15-64 vjeç). INSTAT. Shqipëri. Projeksionet e popullsisë, 2011-2031. F. 55.

6. Masat për përballimin e krizës demografike

Masat për përballimin e kësaj krize demografike mendoj se duhen marrë në tre drejtimet që vijojnë:

A. Në drejtim të shkurajimit të emigrimit të popullsisë:

- Të ndërtohet një strategji kombëtare për evidentimin, shkurajimin e emigrimit si dhe për kthimin e emigrantëve që kanë emigruar më përpara. Të nxitet përpunimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale duke synuar eksportin.
- Të drejtohen investimet publike kryesisht në sektorët ekonomikë për të mbështetur rritjen e prodhimit bujqësor dhe industrial si dhe për zhvillimin e turizmit.
- Të krijohen kushte për rritjen e kreditimit të bizneseve nga sistemi bankar; të gjitha bizneseve, që hapin mbi tre vende pune të reja, t'u lehtësohet barra fiskale. Bizneset e reja të krijuara nga emigrantët e kthyer të mos paguajnë tatime e taksa për 5 vjet.
- Të shpejtohet puna për të zgjidhur sa më shpejt çështjet e pronësisë mbi tokën.
- Të bashkërendohen përpjekjet midis institucioneve qeveritare dhe biznesit për të gjetur rrugët dhe format për rritjen e punësimit, sidomos për të rinjtë, me synim uljen e papunësisë dhe të varfërisë si mënyra më efikase për të zbutur emigracionin.
- Media të heqë nga fjalori i saj shprehjen "kemi popullsi të re", pasi faktet tashmë flasin për moshim të saj.

B. Në drejtim të rritjes graduale të lindshmërisë:

- Të investohet më shumë në shëndetësi për të ulur vdekshmërinë foshnjore, për ta sjellë atë në nivelet e vendeve evropiane. Të ngrihen në qytete e fshatra më shumë çerdhe e kopshte, duke plotësuar gradualisht infrastrukturën e fëmijëve.
- Shteti t'u japë mbështetje materiale familjeve të varfra për rritjen e fëmijëve; krahas pagesës për çdo fëmijë të lindur gjallë prej 40 mijë lekësh, t'u jepet ndihmë shtesë grave që lindin fëmijën e tretë; nënave me mbi 4 fëmijë t'u garantohet pensioni nga shteti.
- Të investohet më shumë në kapitalin human, në veçanti për gratë e vajzat. Të shtohen mjekët për fëmijë dhe ambulancat sidomos në fshatra.
- Të gjitha familjet e reja të ndihmohen për strehim me kredi të buta.

- T'u ndalohet institucioneve shëndetësore publike e private të bëjnë aborte selektive të vajzave. Abortet të evidentohen edhe sipas gjinisë.

- Të krijohet një qendër e veçantë për studime demografike pranë Akademisë së Shkencave apo INSTAT-it për të evidentuar shkaqet e krizës demografike dhe për të sugjeruar masa konkrete për të zbutur në mënyrë graduale pasojat negative të saj.

C. Në drejtim të uljes së vdekshmërisë:

- Të rriten shpenzimet e buxhetit të shtetit për shëndetësinë në raport me PBB-në, në nivele të përafërta me vendet fqinje të Ballkanit Perëndimor.

- Të shtohen masat për uljen e mëtejshme të vdekshmërisë foshnjore dhe të fëmijëve nën 5 vjeç, pasi i kemi ende të larta. Të shtohet më shumë kujdesi i punonjësve të shëndetësisë për uljen e vdekshmërisë amtare në lindjet dhe abortet.

- Duke qenë se vdekjet e të rinjve nga aksidentet i kemi shumë të larta, të forcohen më tepër masat dhe kontrollet për t'i parandaluar ato.

- Mjekëve që mbarojnë universitetin publik dhe specializohen me paratë e buxhetit të shtetit, t'u ndalohet të emigrojnë pa zbatuar më parë kontratat përkatëse të nënshkruara me institucionet shëndetësore përkatëse.

Literatura

1. *Dumani, B; Stringa, A. Demografia Socio-Ekonomike, 2009.*
2. *INSTAT, Instituti i Statistikave.Censusi i popullsisë dhe i banesave 2001 dhe 2011. Femra dhe meshkuj 2013, 2015, 2016, 2017 INSTAT. Migracioni në Shqipëri 2004, 2013. Plakja e popullsisë, nëntor 2015, INSTAT, UNFPA, SADC. Popullsia dhe dinamikat e saj, INSTAT, maj 2014. Projeksionet e popullsisë, INSTAT, maj 2014. Tabelat me të dhënat e lëvizjeve të shqiptarëve jashtë shtetit për vitet 2012-2017. Të rinjtë në Shqipëri, nëntor 2015, INSTAT, UNFPA, SADC. Vjetarët statistikorë të viteve 1964, 1991-1999, 1993-2001, 1998-2007, 2010-2014.*
3. *Kurs Socialno-Ekonomiçeskoj Statistiki, Moskva 2011.*
4. *Revistat Demografia të viteve 2008 – 2017.*
5. *Revista The Economist.*
6. *Statistika ekonomike, Tiranë, 1986.*
7. *Statistiçeski sllovar, Moskva, 1989.*
8. *Site: http//epp eurostat.cec. eu.int.*
9. *Site: www.nsi.bg.*
10. *Site: www. kgs.ru.*
11. *Site: www.demografia.ru.*
12. *Wikipedia.*

POLITIKAT PËR NXITJEN E QËNDRIMIT AKTIV NË PUNË NË SHQIPËRI

Prof.Assoc.Dr. ***Merita XHUMARI***
Departamenti i Shkencave Politike
Fakulteti i Shkencave Sociale
Universiteti i Tiranës
xhumarimerita@gmail.com

Abstract

The article provides insights on the issue of increasing the effectiveness of the society investments on extending working life, in order to provide a proactive society. This analysis is of special importance in the context of drastic demographic changes to ageing and decrease of employment of the labour force, especially women and new entries in the labour market. There is a recent trend of decrease of the graduates' employment from 62.5% in 2013 to 59.2% in 2015 and of increase of their unemployment at 19.1% in 2015 compared to 14.9% in 2013. The European integration process after 2000, has added to the pressure of Albania to ensure a more competitive labour force to face the openness to the EU labour market, and to improve the legal framework toward the harmonization with EU standards. The role of government is to promote employment of young generation through better career orientation through skills need assessment of the labour market and orientation of the curricula of the vocational and higher education to the market needs. However, to extend the working life and the employability of the young generations, it should be considered broadly as a responsibility of the government to establish the proper rules in the market, a rule of law sanctioned in the Labour Code and other social security legislation, and to develop institutional capacities of the employment services to offer better labour market orientation, and of the employers to offer flexibility for the older employees and internships and professional practices for the new entries in the labour market. The most important conclusions are regarding integrated planning in labor market policies, based on a Skills Need Assessment. The higher education should take more into consideration the study programs in the field of Engineering, Manufacturing and Services which have the lowest share in the total HE programs and students' enrollments. The involvement of the business in HEIs activities, the development of the

students' career services, and the activation of the labor market policies for young graduates, will lead to a successful connection of higher education with labor market and graduates employment. Regarding the older workers, the retirement age may be flexible and the employers, public and private ones should take special attention to females who have been discriminated in the labour market.

***Key words**: Demographic changes;Labor market demand;Employment: Education provision: Iintegrated policy interventions.*

Hyrje

Artikulli sjell në vëmendje çështjen e rritjes së efektivitetit të investimeve të shoqërisë në zgjatjen e jetës aktive në punë në mënyrë që të sigurohet një shoqëri produktive. Këto analiza janë të një rëndësie të veçantë në kontekstin e ndryshimeve demografike drejt plakjes së popullsisë edhe në Shqipëri. Po ashtu, prirjeve të uljes së nivelit të punësimit, veçanërisht të grave dhe të rinjve, u janë shtuar së fundmi indikatorët e uljes së punësimit edhe të të diplomuarve nga universiteti; nga 62,5% në vitin 2013 në 59,2% në 2015 dhe rritja e papunësisë së tyre në 19,1% në 2015, krahasuar me 14,9% në vitin 2013. Procesi i integrimit evropian pas vitit 2000 ka shtuar presionin për Shqipërinë dhe vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor për të siguruar një forcë pune më konkurruese për të përballuar hapjen ndaj tregut të punës së BE-së. Ndryshimet e para lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor drejt harmonizimit të tij me Acquis Communitaire, ku në vëmendjen e kësaj analize përfshihen Kodi i Punës, legjislacioni i sigurimeve shoqërore, i sigurimit të kujdesit shëndetësor, i shërbimeve të punësimit, i barazisë gjinore etj.

Për t'i bërë efektive politikat e ndërhyrjes në tregun e punës për nxitjen e punësimit, ka nevojë për një sistem të integruar të planifikimit të politikave ekonomike, arsimore, politikave për rritjen e moshave të pensionit dhe zgjatjen e jetës së punës duke përmirësuar marrëdhëniet e punës. Roli i qeverisë është të promovojë punësimin e brezit të ri përmes orientimit më të mirë të karrierës dhe të kurrikulave të arsimit të lartë sipas nevojave të tregut, nëpërmjet vlerësimit të nevojave për aftësi të tregut të punës. Sidoqoftë, për zgjatjen e jetës së punës së grupmoshave të larta dhe punësueshmërinë e brezave të rinj, duhet të konsiderohet përgjegjësia e qeverisë për të vendosur dhe zbatuar rregullat e sanksionuara në Kodin e Punës dhe

legjislacionin e sigurimeve shoqërore. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale të shërbimeve të punësimit për të ofruar orientim më të mirë të tregut të punës dhe të punëdhënësve, për të ofruar fleksibilitet për punonjësit e moshuar dhe praktika profesionale për prurjet e reja në tregun e punës.

Metodologjikisht, janë përdorur disa instrumente të tilla si analiza e të dhënave mbi tregun e punës, arsimin e lartë dhe ndryshimet demografike, intervistat gjysmë të strukturuara me përfaqësuesit e qeverisë, partnerët socialë dhe organizatat e shoqërisë civile. Konkluzionet më të rëndësishme kanë të bëjnë me planifikimin e integruar në politikat e tregut të punës, arsimit e formimit profesional, duke marrë më shumë në konsideratë programet mbështetëse për gratë që kanë pjesëmarrje të ulët në tregun e punës dhe pozitë më të nënshtruar në familje.

1. Sfondi demografik në Shqipëri

Në vitet e fundit shoqëria shqiptare ka përjetuar ndryshime shoqërore me një simetri në rritje në rolet gjinore, në mënyrën e jetesës dhe në organizimin e jetës shoqërore. Ndër faktorët me ndikim në transformime të tilla kanë qenë treguesit demografikë të fertilitetit, jetëgjatësisë dhe migrimit. Censusi 2011 tregoi se fëmijët nën 15 vjeç përfaqësonin 20,7 për qind të popullsisë, të rinjtë e moshës 15-29 vjeç përfaqësonin 25,2 për qind të popullatës së përgjithshme; grupmosha e të rriturve 30-64 vjeç përfaqësonte 42,8 për qind të popullsisë, ndërsa të moshuarit mbi 65 vjeç përbënin segmentin më të vogël të popullsisë me 11,3 për qind.

Por raporti i varësisë së të moshuarve pothuajse u dyfishua nga 8,6 për qind në vitin 1989 në 16,7 për qind në vitin 2011, ndërsa në vitin 2030 parashikohet të dyfishohet në 32,9 për qind *(INSTAT, SDC, UNFPA 2015a:9)*. Parashikohet një ndryshim gjinor në raportin e varësisë së moshës së vjetër në 31 për qind për burrat dhe në 37 për qind për gratë në vitin 2031, referuar jetëgjatësisë më të lartë në lindje të vlerësuar në 80,1 vjeç për gratë, krahasuar me 77,0 vjeç për burrat *(INSTAT, 2017: 19)*.

Gjithsesi, në 2016 Shqipëria ka pasur një përqindje më të ulët të popullsisë mbi 65 vjeç; prej 16,3 për qind krahasuar me vendet e BE-së me 19,2 për qind *(Institute of Statistics, Institute of Public Health, and ICF. 2018:11)*.

Jetëgjatësia relativisht e kënaqshme në Shqipëri mund të shpjegohet me ekzistencën e një modeli tradicional dietik mesdhetar, i cili ka efekte

shëndetësore të dobishme, veçanërisht në lidhje me sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë kardiovaskulare. Megjithatë, indeksi shqiptar i zhvillimit njerëzor (HDI), tregues i një jete të gjatë dhe të shëndetshme, qasje në njohuri dhe në një standard jetese të denjë, në vitin 2012 ishte 0,75 më i lartë se Bosnja & Hercegovina dhe Maqedonia, por më i ulët se Serbia dhe Mali i Zi *(Institute of Public Health & UNICEF, 2014:2*).

Censusi 2011 tregoi se mosha mesatare e popullsisë shqiptare ishte 35,3 vjeç, me një rritje prej pothuajse gjashtë vjetësh krahasuar me vitin 2001. Ajo vazhdon të rritet në 37,0 vjeç në vitin 2016, ndërsa shkalla totale e lindshmërisë ishte 1,54 fëmijë, pra nën nivelin e zëvendësimit prej 2,1 fëmijë për grua. Në vitin 2016, mosha mesatare e lindjes për gratë ishte 27, krahasuar me 32,5 vjeç për burrat, ndërsa mosha mesatare e martesës për gratë u rrit në 25,1. Krahasuar me 10 vjet më parë, gratë martohen relativisht tre vjet më vonë, e njëjta prirje është edhe për burrat. Nëse niveli i martesave ka mbetur pothuajse konstant në dhjetë vitet e fundit në 7,8 (2016), niveli i divorceve pothuajse është dyfishuar nga 14,8 (2007) në 31,2 (2016) *(INSTAT, 2017b: 20-26)*.

Anketa Demografike dhe Shëndetësore Shqiptare (2010) tregoi se një në dy familje ka të paktën një anëtar që ka migruar brenda ose jashtë Shqipërisë. Sikurse në vendet e tjera, emigrimi përfshin veçanërisht të rinjtë, të cilët largohen nga vendi për arsye punësimi, arsimimi dhe për arsye familjare, ku përveç burrave, po rritet edhe numri i grave që emigrojnë *(INSTAT, SDC, UNFPA, 2015b:22)*. Emigrantët mbeten një burim i rëndësishëm mbështetjeje për prindërit dhe familjet e tyre përmes dërgimit të remitancave.

2. Zhvillimet e tregut të punës

Punësimi në Shqipëri është një sfidë komplekse dhe hapja e vendeve të reja të punës është fenomen multisektorial, i cili përfshin: politika makro-ekonomike për biznesin, politika arsimore dhe të formimit profesional, politika sociale etj. Punësimi është një urë lidhëse midis fuqisë punëtore, kapitalit dhe prodhimit, duke funksionuar si një tregues multidimensional i shoqërisë. Ekonomia shqiptare në vitet e fundit ka njohur ritme të larta zhvillimi, por kjo nuk është shoqëruar me rritjen e shkallës së punësimit në të njëjtat nivele.

Grafiku 1: Dinamikat e rritjes së PBB dhe të punësimit, 1996-2016



Burimi: *Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Raporti Vjetor 2016.*

Pjesëmarrja në forcat e punës në 5 vitet e fundit është ulur nga 68,5 për qind në 2011 në 66,2 për qind në 2016, me një hendek gjinor konstant prej 16 për qind. Papunësia është në nivelet më të larta për grupmoshën 15-29 vjeç në 27,4 për qind *(INSTAT, 2016)*. Pjesëmarrja në forcat e punës është në nivelet më të ulëta për gratë e grupmoshës 15-29 vjeç me prirje rënieje nga 47 për qind në 2011 në 38,8 për qind në 2016; krahasuar me burrat nga 62,2 për qind në 51,7 për qind. Anketa e Forcave të Punës 2016 tregoi se gratë kanë më pak gjasa të marrin pjesë në tregun e punës, 42 për qind e grave janë jashtë fuqisë punëtore, krahasuar me 26 për qind të burrave. Hendeku gjinor evidentohet edhe po t'u referohemi punëkërkuesve të papunë sipas nivelit të edukimit, veçanërisht atyre me diploma universitare, me 62 për qind gra dhe 38 për qind burra *(INSTAT, 2017b:86)*.

Të dhënat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit tregojnë se gjatë vitit 2016 numri i punëkërkuesve të papunë të regjistruar ka rënie, e lidhur kjo me programet e nxitjes së punësimit dhe formimit profesional. Punëkërkuesit e papunë gra vazhdojnë të përfitojnë më shumë se burrat nga këto programe *(INSTAT, 2017b: 67*). Megjithëse fondi për programet aktive të tregut të punës është pesëfishuar referuar periudhës 2013– 2016, ka një rritje nga 32 për qind në 40,4 për qind të grave jashtë forcave të punës. Përgjithësisht, shkaqet janë dalja në pension të parakohshëm (40 për qind) dhe angazhimit në punët e shtëpisë (21,5 për qind), kundrejt angazhimit të burrave në punët e shtëpisë vetëm me 1%.

Pra, një aspekt i rëndësishëm i nxitjes së qëndrimit sa më gjatë aktiv në jetën shoqërore të grave është kombinimi i jetës së punës me atë familjare, duke pasur një sistem efektiv shërbimesh publike. Në vitin 2016, duke iu

referuar statusit të punësimit, 43 për qind e grave janë "të punësuara me pagë", ndërsa 31,2 për qind janë "punëtorë pa pagesë të familjes" krahasuar me 18,2 për qind të së njëjtës kategori për burrat. Një numër i konsiderueshëm i burrave janë të vetëpunësuar (38,3%), krahasuar me 24,4% për gratë *(INSTAT, 2017b: 76)*.

Sipas të dhënave të vlerësuara për numrin e orëve të punës 36,5 për qind e grave punojnë më pak se 40 orë në javë, ndërsa burrat vetëm 27,6 për qind. Po ashtu, orari i punës së paguar për burrat është më i lartë në krahasim me atë të grave, 50 për qind e burrave punojnë 40-48 orë në javë, krahasuar me 46 për qind të grave *(INSTAT, 2017b: 68)*. Mospërputhja e profesioneve të ofertës dhe kërkesës për punë është një tjetër problem që evidentohet qartë nga të dhënat e Shërbimi Kombëtar të Punësimit, i cili synon t'u gjejë vendin e punësimit të përshtatshëm punëkërkuesve të papunë.

Grafik 2. Punëkërkuesit e punësuar dhe vendet e lira të punës sipas veprimtarive ekonomike



Burimi: *Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Raporti Vjetor 2016.*

Nga ofertat e punës rezulton se 30,64% e totalit janë për zejtarë, 23% për specialistë me arsim të lartë, nëpunës dhe teknikë, ndërsa 53,5% e totalit të punëkërkuesve të papunë janë në profesione elementare. **Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020 synon t'u përgjigjet prioriteteve të zhvillimit ekonomik me punësimin, duke integruar politikat ekonomike, arsimore dhe sipërmarrëse.**

Objektivat e Qeverisë për rritjen e punësimit përqendrohen te hapja e vendeve të reja të punës, kryesisht nëpërmjet zhvillimit të atyre degëve të ekonomisë që kanë treguar kërkesa të larta për punësim. Duke iu referuar sektorëve ekonomikë 40,2 për qind e të punësuarve janë punësuar në bujqësi. Sektori i shërbimeve – ku përfshihen aktivitete të tilla si administrata publike, shërbimet sociale, aktivitete dhe shërbime të tjera – luan rolin e dytë më të rëndësishëm në punësimin veçanërisht të grave (20 për qind), pas bujqësisë.

Ristrukturimi i ekonomisë shqiptare në vitet e fundit ka zhvendosur kërkesën për fuqi punëtore te profesionistët me arsim të lartë në fushat e inxhinierisë, prodhimeve dhe shërbimeve, të cilat janë më pak të mbështetura me programet përkatëse të studimit të arsimit të lartë, ku rreth 26 për qind e programeve të studimit Bachelor në institucionet e arsimit të lartë publik janë në fushën e Arteve dhe Shkencave Humane dhe 13 për qind në fushën e Administrimit të Biznesit dhe Juridikut.

Programi i Reformës Ekonomike 2017 – 2019 shtron drejtimet e politikave makroekonomike për një zhvillim të qëndrueshëm që sjell rritjen e punësimit. Konkretisht, bujqësia, tekstilet, industria përpunuese dhe turizmi paraqiten si prioritetet e ekonomisë shqiptare... Në plan afatmesëm dhe afatgjatë, reformat strukturore do të përmirësojnë klimën e biznesit për kompanitë dhe do t'u japin hov potencialeve ekonomike.[1]

3. Edukimi dhe prurjet në tregun e punës

Edukimi dhe formimi i vazhdueshëm profesional janë një faktor i rëndësishëm për lehtësimin e një jete pune të suksesshme dhe të zgjatur, si dhe për përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies. Sipas INSTAT-it, Studimit mbi Matjen e Standardeve të Jetesës (2012), shkalla e shkrim-leximit në popullsinë shqiptare mbi moshën 15-vjeçare ishte 98,4 për qind (burra) dhe 96,1 për qind (gra), që do të thotë mundësi më të mira pune për të gjithë.

Në vitin akademik 2015 – 2016, vërehet një rritje e lehtë në numrin e nxënësve të diplomuar në arsimin e mesëm, të përbërë nga 52 për qind vajza dhe 48 për qind djem. Ndërsa raporti i të diplomuarve në arsimin e lartë, që gati është trefishuar në dhjetëvjeçarin e fundit ishte 63,8 për qind për vajzat dhe 36,2 për qind për djemtë.

---

1) Albanian Government, Economic Reform Programme 2017-2019, f. 9.

***Tabela 1**: Punësimi sipas nivelit të arsimit dhe sektorëve të ekonomisë në Shqipëri*

(Në mijë veta)

Punësimi sipas nivelit të arsimit	**Sektorët e ekonomisë**											
	Bujqësia		**Manifaktura**		**Ndërtimi**		**Industria ***		**Shërbimet e tregut**		**Shërbimet jo të tregut**	
	2012	***2014***	***2012***	***2014***	***2012***	***2014***	***2012***	***2014***	***2012***	***2014***	***2012***	***2014***
I. Punësimi gjithsej:	526	443	81	90	93	66	22	25	246	235	171	174
-Arsimi i detyrueshëm	400	332	38	37	50	35	6	4	75	66	21	15
-Arsimi i mesëm	117	104	39	46	35	28	14	17	131	117	68	55
-Arsimi i lartë	10	7	4	7	8	4	2	5	40	52	83	104

***Burimi**: INSTAT, LFS 2012 – 2014.* Industria nxjerrëse, energjia, gazi, furnizimi me ujë.*

Indeksi i barazisë gjinore, i cili pothuajse është një për të gjitha nivelet parauniversitare, për arsimin e lartë u rrit në 1,46. Një prirje e qartë dhe e rëndësishme e viteve të fundit është se gratë e grupmoshës 25-39 vjeç kanë përmbysur pozitën e grave në shoqërinë shqiptare, ku 27 për qind e tyre kanë përfunduar arsimin e lartë, krahasuar me 19 për qind të burrave; në krahasim me gratë e grupmoshës mbi 65 vjeç, ku vetëm 4 për qind janë me arsim të lartë, krahasuar me 12 për qind të burrave *(INSTAT, 2017b: 50)*.

Kjo tregon për shkallën më të lartë të arsimimit të vajzave e grave që duhet të ishte reflektuar edhe në shkallën e punësimit të tyre, por që treguesit e punësimit nuk e vërtetojnë këtë korrelacion. Kjo lidhet si me mënyrën e deformuar të funksionimit të tregut, ashtu edhe me aksesin në shërbime për të balancuar jetën familjare me aktivitetin e punës.

***Tabela 2**: Numri i studentëve me kohë të plotë në Institucionet e Arsimit të Lartë, 2004-2014*

Viti akademik	Numri i studentëve gjithsej	Sipas sektorëve:	
		Publik	***Privat***
2004-05	43.185	42.202	983
2005-06	52.283	50.567	1.716
2006-07	64.577	58.916	5.761
2007-08	71.795	62.289	9.506
2008-09	74.687	61.343	13.344
2009-10	102.509	79.615	22.894
2010-11	115.223	88.439	26.784
2011-12	133.460	99.241	34.219
2012-13	144.593	**110.374**	34.219
2013-14	147.902	116.911	30.991



***Burimi**: Të dhëna bazuar në statistikat e Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, 2015.*

Duke iu referuar shkallës së lartë të pjesëmarrjes së grave në arsimin e lartë, kalimi i tyre nga universiteti në punësim lihet në mëshirë të tregut, treg i cili nuk funksionon me rregullat e konkurrencës së ndershme që të përfshijë në punësim më të mirët. Gjetjet e studimit të fundit të London School of Economics për Ballkanin Perëndimor mbi "Universitetet dhe Tregu i Punës", nxjerrin në pah se ka rënë besimi se diploma universitare të siguron një vend të mirë pune në ekonominë e tregut.[2]

Sipas të dhënave të këtij studimi, programet universitare më të preferuara ku janë diplomuar vajzat janë ato të Administrim Biznesit dhe Juridikut (27 për qind), të Mjekësisë dhe Punës sociale (17 për qind), të Shkencave të Edukimit për mësuesi (14 për qind) dhe artet e shkencat humane (14 për qind).

Ndërsa fushat e studimeve në të cilat janë diplomuar më shumë djem janë ato të Administrim Biznesit dhe Juridikut (30 për qind), Inxhinierisë dhe Ndërtimit (15 për qind), Mjekësisë (13 për qind) dhe vetëm 4 për qind në Shkencat e Edukimit, sikurse vetëm 5 për qind e vajzave janë diplomuar në Inxhinieri.

Pra, sa u takon diplomave sipas fushave të studimit, më të zakonshmet janë diplomat në fushën e Administrim Biznesit dhe Juridikut me rreth 28 për qind të të diplomuarve, ndërsa ka më pak programe studimi dhe, për rrjedhojë, më pak profesionistë të diplomuar nga arsimi i lartë në fushën e Shërbimeve, me vetëm 2 për qind të të diplomuarve.

Po ashtu, ka një nivel më të ulët të të diplomuarve në Shkencat Sociale, Gazetari dhe Shkencat e Informimit, si dhe në Shkencat e Natyrës, Matematikës dhe Statistikës, në raport me kërkesat e tregut në Shqipëri, sikurse edhe në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ky hendek pritet të rritet me kalimin e kohës, duke treguar se mund të jetë e rëndësishme të zgjerohen programet e studimit dhe të shtohet numri i profesionistëve në këto fusha.[3]

---

2) European Commission, Xhumari, M., & Dibra, S., & Bartlett, W., (2016) From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in Albania, https://ec.europa.eu/education/sites/education/files/2016-higher-education-labour-market-balkans_en.pdf

3) European Commission, Xhumari, M., & Dibra, S., & Bartlett, W., (2016) From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in Albania, faqe 34.

***Tabela 3**: Struktura e programeve të studimeve të arsimit të lartë, 2014 – 2015, në përqindje*

Fushat e studimit	**Sektori publik**			**Sektori privat**		
	Bachelor	*Master*	*Doktorata*	*Bachelor*	*Master*	*Doktorata*
Edukimi	5,6	14,8	2,0	0,9	6,2	3,0
Arte e Shkenca Humane	26,4	17,6	17,2	4,3	1,4	0,0
Shkenca Sociale, Gazetari dhe Shkencat e Informimit	7,4	9,8	8,1	21,4	21,9	30,0
Administrim Biznesi dhe Juridik	13,0	18,2	13,1	42,7	41,1	40,0
Shkencat e Natyrës, Matematikë e Statistika	10,8	10,1	17,2	0,9	1,4	3,0
Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	7,1	5,0	4,0	11,1	6,2	7,0
Shkencat Inxhinierike, të Manifakturës dhe Ndërtimit	9,7	9,8	10,1	8,5	13,7	10,0
Shkencat Bujqësore, Pyjore dhe Veterinari	5,9	2,5	8,1	0,0	0,0	0,0
Mjekësi e Punë Sociale	10,0	8,9	20,2	9,4	6,8	7,0
Shërbime	4,1	3,4	0,0	0,9	1,4	0,0
Gjithsej	100	100	100	100	100	100

***Burimi**: Përllogaritje nga autori, bazuar në statistikat e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, 2015.*

Nga analiza e sektorëve të ekonomisë, me tregues në rritje të punësimit në vitet e fundit ishin shërbimet dhe industritë që kërkonin inxhinierë. Pra, ka një mospërputhje të dukshme midis sektorëve ekonomikë me

më shumë mundësi punësimi dhe programeve studimore të ofruara nga sistemi i edukimit, si ai publik edhe privat.

Në të njëjtin përfundim vjen edhe studimi tjetër i European Training Foundation, se "Procesi i ristrukturimit ekonomik dhe zgjerimi i kërkesës për aftësi të reja ka ndodhur shpesh më shpejt sesa kanë qenë në gjendje të përshtaten sistemi i arsimit dhe trajnimit, duke çuar në mungesë të të diplomuarve të kualifikuar *(ETF, 2014)*.

Politikat për ngritjen e programeve të studimit në fushat ku kërkesat e tregut janë më të larta janë të domosdoshme në Shqipëri, si për sa i takon arsimit të mesëm profesional, ashtu edhe arsimit të lartë. Nga një studim tjetër i mbështetur nga Këshilli i Evropës, pjesëmarrja e vajzave në arsimin e mesëm profesional është shumë e ulët krahasuar me djemtë, madje ka shkolla të arsimit të mesëm profesional si ajo "Beqir Çela" në Shkozet të Durrësit me mbi një mijë nxënës, ku nuk ka ndonjë vajzë.

INSTAT, në studimet e tregut të punës, tregon se arsimi i mesëm profesional krijon shanse më të mira punësimi në Shqipëri krahasuar edhe me arsimin e lartë universitar. Nëse arsimi i mesëm profesional do të orientohej nga profesione më të përshtatshme për vajzat që janë të kërkuara në treg, gratë me nivel më të lartë kualifikimi profesional do të kenë më shumë shanse për sukses në tregun e punës, për një shëndet më të mirë dhe kujdes për familjen e tyre dhe për të qenë pjesë aktive e iniciativave për t'u përfshirë në veprimtari ekonomike dhe politike.

Për të lehtësuar kalimin nga arsimi në punësim dhe kthimin e investimeve të shoqërisë në arsim, në standarde më të larta të jetesës sidomos për gratë, reforma e kohëve të fundit në arsim është fokusuar në lidhjen e arsimit me tregun e punës, duke nxitur përfshirjen e biznesit në menaxhimin e institucioneve të arsimit, si në nivelet e arsimit të mesëm profesional, ashtu dhe në institucionet e arsimit të lartë. Kjo kërkon që biznesi dhe aktorët e tjerë të interesuar të marrin pjesë përgjatë të gjithë procesit, që nga hartimi i kurrikulave, mësimdhënia e deri në praktikat profesionale të nxënësve e studentëve.

4. Dalja nga tregu i punës

Nisur nga perspektiva e ciklit të jetës, kalimi nga punësimi në pension është një tjetër komponent i rëndësishëm që ndikon në qëndrimin sa më gjatë aktiv në punë. Ky proces rregullohet kryesisht nga dy ligje themelore: mbi sigurimet shoqërore dhe Kodi i Punës.

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore përbëhet nga sigurimet e detyrueshme, sigurimi vullnetar, sigurimi suplementar dhe pensionet e veçanta shtetërore.

Skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore mbulon formalisht të gjithë popullsinë ekonomikisht aktive, më konkretisht: a) të punësuarit në rastet e: paaftësisë së përkohshme për shkak të sëmundjes, barrëlindjes, pleqërisë, invaliditetit, humbjes së mbajtësit të familjes, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale dhe papunësisë; b) personat e tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënës dhe persona të vetëpunësuar) në lidhje me: barrëlindjen, pleqërinë, invaliditetin dhe humbjen e mbajtësit të familjes.

Ky është një sistem PAYG që garanton të kompensojë humbjen e të ardhurave të paktën për një standard minimal jetese, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave *(Ligji nr.7703, datë 11.05.1993, Neni 2)*.

Deri në fund të vitit 2016 kishte rreth 611 mijë pensionistë, ose rreth 20 për qind të popullsisë së Shqipërisë. Shkalla e lartë e papunësisë, migrimit dhe ekonomisë informale ka ndikuar për ndryshime të shpeshta në ligjin bazë mbi sigurimet shoqërore në treguesit kryesorë, si në:

a) shkallën e lartë të varësisë, ku 1 pensionist është mbështetur nga 1 kontribues; *dhe*

b) shkallën e ulët të zëvendësimit që nuk i plotëson standardet minimale të Konventës 102/1952 të Organizatës Botërore të Punës, ku masa e përfitimeve nga sigurimet shoqërore duhet të jetë 40 për qind e pagës mesatare të punëtorit.

Këto përbëjnë dy argumente të tjera që të punësuarit të jenë të interesuar të qëndrojnë sa më gjatë në pozita aktive në punë, për të ruajtur standardin e tyre të jetesës. Përndryshe, gati 20 për qind e popullsisë që janë përfitues nga skemat e sigurimeve shoqërore, me nivelet e ulëta të pensioneve që marrin, do të kalojnë në grupin e të varfërve në shoqërinë shqiptare.

Duke iu referuar punësimit më të lartë të grave në dy sektorë, bujqësi dhe shërbime jo të tregut (administrata publike), në sistemin e pensioneve shumica e grave, rreth 79 mijë, marrin një pension rural 8.556 lekë/muaj nga 45 mijë burra që përfitojnë pensione rurale. Ndërsa shumica e burrave marrin një pension urban që është pothuajse dyfishi i pensionit rural 14.873 lekë *(INSTAT, 2017b: 83)*.

Periudha mesatare e kontributit për gratë është 29 vjet krahasuar me 31,1 vjet për burrat. Kjo reflektohet në numrin më të lartë të grave (2.874 persona) si kontribuese në skemën e sigurimeve shoqërore vullnetare në krahasim me burrat (1.802 persona).

Një ndryshim tjetër është se gratë gëzojnë pensionin e tyre për një periudhë mesatare më të gjatë prej 25 vjetësh në krahasim me burrat prej 20 vjetësh, duke qëndruar më gjatë në kushtet e varfërisë (ISSH). Prandaj dhe studimet e fundit evidentojnë se "Qëndrueshmëria e sistemit të pensioneve është nën presion të rëndë për shkak të punësimit të ulët, mbledhjes së dobët të kontributeve dhe rritjes së papritur të numrit të pensionistëve, si një lloj pensionimi drejt varfërisë" *(Xhumari, 2011:10)*.

Studimet e INSTAT-it mbi nivelet e jetesës kanë treguar një prirje rritjeje të popullsisë së varfër në 14,3 për qind në 2014, krahasuar me 12,4 për qind në 2008 *(INSTAT, 2012)*. Reforma e pensioneve e vitit 2015 për herë të parë vendosi pensionin social për të moshuarit shqiptarë mbi 70 vjeç që nuk kanë ndonjë burim tjetër të të ardhurave. Kjo masë është e drejtuar për të përfituar veçanërisht gratë, të cilat kanë shkallë më të lartë të papunësisë dhe jetëgjatësi më të lartë në krahasim me burrat.

Reforma e pensioneve e vitit 2015 kishte për qëllim përmirësimin e treguesve të sistemit, duke i nxitur individët të kontribuojnë dhe duke i motivuar ata të qëndrojnë më gjatë në punë *(Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2014:34)*. "Skema e pensioneve vuan nga një defiçit shumë i lartë që e bën atë financiarisht të papërballueshme ... nuk është më në gjendje të garantojë balancën midis përshtatshmërisë së përfitimeve dhe burimeve të të ardhurave. Duke pasur parasysh rëndësinë e pensioneve për mbrojtje sociale, është e nevojshme të ndërhyhet menjëherë për të reformuar sistemin" *(Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2014:4)*.

Prandaj ndryshimet parametrike konsistuan në rritjen graduale të moshës së daljes në pension për gratë nga 60 në 65 vjeç, me dy muaj çdo vit, duke filluar nga viti 2015, derisa të barazohen me atë të burrave. Rritja e masës së pensioneve me 0.5 për qind për çdo muaj të zgjatjes së qëndrimit në punë tej moshës ligjore të daljes në pension, si dhe heqja e kufizimit të shumës maksimale të përfitimeve sipas kontributeve pritet të zgjatin jetën e punës.

Kjo zgjatje e qëndrimit në punë duhet të shoqërohet me rritje të mundësive për punësim, veçanërisht për gratë, të cilat me reformat e pensioneve duhet të rrisin periudhën e qëndrimit aktiv në punë. Pra, rritja me ligj e moshës së daljes në pension në një plan afatgjatë duhet të sjellë prioritete të qeverisë dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë për ta mundësuar realisht këtë politikë.

Përdorimi i telefonit celular është zgjeruar gjatë viteve të fundit, duke rritur edhe numrin e përdoruesve të të moshuarve, ndërsa kompjuterët dhe interneti nuk janë në dispozicion për një numër të madh të moshuarish,

gjë që kufizon qasjen adekuate në informacion. Në mënyrë të ngjashme, edhe pse pronësia e automjeteve private është në rritje, vetëm një në pesë të moshuar ka një të tillë, i cili mund të jetë një kufizim në drejtim të lëvizshmërisë fizike në zonat ku transporti publik është i limituar. Rreth 30 për qind e të moshuarve shqiptarë jetojnë në blloqe apartamentesh, ku një kufizim i lëvizshmërisë për 80 për qind të tyre është mungesa e ashensorit *(Institute of Public Health & UNICEF, 2014:3)*.

Reformat parametrike të sigurimeve shoqërore të vitit 2015 rrisin gradualisht dhe në një plan afatgjatë, deri në vitin 2056, unifikojnë moshën e daljes në pension për burrat dhe gratë në moshën 67 vjeç, duke zgjatur edhe periudhën e sigurimit në 40 vjet deri në vitin 2032. Si rezultat i reformave parametrike, gjatë viteve 1993 – 2016 rritet mosha mesatare e daljes në pension me 10 vjet, nga 53,2 në 63,2 vjeç, pra ka një zgjatje të qëndrimit aktiv në punë, i cili ndjek përcaktimet ligjore të moshave të pensionit.

Njerëzit kanë të drejtë të marrin pensionin dhe të vazhdojnë të punojnë dhe paguajnë kontributet, por nëse shtyjnë marrjen e pensioneve pas moshës së pensionit, shuma e pensionit rritet me 0,5 për qind për çdo muaj, ose në rast të daljes në pension të parakohshëm, shuma e pensionit zvogëlohet me 0,6 për qind për çdo muaj.

Bazuar në Nenin 33 të Ligjit 7703, 11.05.1993, për Sigurimet Shoqërore në RSH, ekziston një masë tjetër për të bërë kalimin në pension më fleksibël dhe zgjatjen e jetës së punës për profesorët, mbështetur në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë. Në vend që të dalin në pension me vendim të njëanshëm të punëdhënësit, profesorëve të universiteteve u lejohet të negociojnë për qëndrim më të gjatë në atë pozitë. Ka mjaft raste të tjera kur mësuesit e pensionuar me përvojë, mjekët dhe profesionistët e tjerë ftohen të punojnë në sektorin privat, i cili është më fleksibël në detyrimin e punonjësve për të dalë në pension me mbushjen e moshës së përcaktuar me ligj për të drejtën e përfitimit të pensionit të pleqërisë.

Sfidat mbeten në arritjen e suksesit afatgjatë, duke inkurajuar njerëzit që të formalizojnë punën e tyre, pasi në të vërtetë nuk ka dëshmi për ata që zgjasin jetën e tyre të punës mbi moshën e daljes në pension. Më e rëndësishmja është që punëdhënësit, si në sektorin publik, edhe në atë privat, të respektojnë zgjedhjen e të punësuarve për të vendosur daljen nga tregu i punës, përkohësisht apo përgjithmonë.

Një nga rekomandimet e mbështetura nga raporte të ndryshme është zhvillimi i kapaciteteve për hulumtime, grumbullim sistematik të dhënash dhe analizat mbi plakjen në Shqipëri *(UNDESA/DSPD, 2011)*. Në për-

gjithësi, shpenzimet dhe investimet për kërkim shkencor në Shqipëri kanë qenë të ulëta. Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2009 –2015, parashikoi trefishimin e buxhetit nga 0,2% në 0,6% të PBB-së gjatë periudhës 2009 –2015, ndërkohë që shpenzimet për hulumtime shkencore zbritën në 0,4 % të PBB-së në 2015 dhe madje edhe më tej, në 0,35% e PBB-së në 2016.[4]

Një faktor me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e qëndrimit aktiv ndaj punës është jeta e shëndetshme. Duke iu referuar programit të ri qeveritar 2017– 2021 me devizën "Më shumë vite jetë dhe vite të shëndetshme", synohet parandalimi dhe diagnostikimi i hershëm i disa prej sëmundjeve kancerogjene, veçanërisht të përhapura te gratë.

Financimi i kujdesit shëndetësor publik synon të arrijë në 60-65 për qind të shpenzimeve të përgjithshme shëndetësore shqiptare, krahasuar me 43 për qind në 2013, duke siguruar që asnjë familje shqiptare e varfër të mos mbetet pa kujdes shëndetësor për shkak të pamundësisë së pagesës për shërbimet shëndetësore. Do të zgjerohet në mënyrë të konsiderueshme kujdesi shëndetësor falas për rehabilitim, për të shkurtuar kohën e qëndrimit në institucionet e kujdesit shëndetësor, periudhën e aftësisë së kufizuar dhe për të zvogëluar barrën në buxhetet e familjes *(Këshilli i Ministrave, 2017 – 2021)*.

Krahas politikave parandaluese në kujdesin shëndetësor, nxitja e mjediseve të shëndetshme të punës, pa sëmundje profesionale, mbështetet nga Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit i Qeverisë Shqiptare me objektivin për të krijuar kushte të mira pune që nxisin edhe punësimin. *(VKM nr.371, datë 18.05.2016)*. Ky plan do të zbatohet nën udhëheqjen e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e cila është bashkuar me Ministrinë e Shëndetësisë (shtator 2017) nën Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies. Ndryshimet e kërkuara në metodat e qasjes, në zakonet dhe në kulturën e punës janë të një rëndësie të madhe në këtë proces.

Kodi i Punës 136/2015 ka miratuar amendamente të rëndësishme në disa nene për të detyruar punëdhënësit që të kujdesen për punën maksimale të orarit, kushtet e punës, orët jashtë orarit, kohën e pushimit, punën e natës, mosdiskriminimin. Kodi i Punës 136/2015, Neni 90 bën ndryshime që përcaktojnë orarin maksimal të punës në një javë të punonjësit që është

---

4) Këshilli i Ministrave, Programi i Reformës Ekonomike 2017-2019, f. 76: http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/buxheti/2016/perditesime/Raporti_i_Monitorimit_12-mujori_janar-dhjetor_2015_30.1._2016_F_N_(4).pdf

reduktuar në 48 orë në vend të 50 orëve. Punëdhënësi dhe punëmarrësi duhet të parashikojnë kohëzgjatjen e kohës së pushimit në marrëveshjen e punësimit individual ose kolektiv të nënshkruar midis tyre. Punëdhënësi nuk mund të kërkojë punë jashtë orarit, në rast se punonjësi ka kryer maksimumin 48 orë punë në javë.

Ndryshimet e fundit në Kodin e Punës dhe legjislacionin e sigurimeve shoqërore synojnë të mbështesin gratë për një nga përgjegjësitë kryesore familjare, lindjen dhe mirërritjen e fëmijës *(Kodi i Punës 136/2015, neni 54)*. Kodi i Punës 136/2015 ka përmirësuar nenin 96 duke riafirmuar të drejtën e të punësuarve për leje të papagueshme në rastet e sëmundjes së ndonjë anëtari të familjes deri në 30 ditë, në vend të 10 ditëve.

Përfundime

Ideja e planifikimit të integruar pasqyrohet në Strategjitë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim I (2007 – 2013) dhe II (2014 – 2020). Shërbimi Kombëtar i Punësimit iu bashkua Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave me idenë e integrimit të politikave ekonomike me punësimin, që të sigurohet një korrelacion i drejtë midis rritjes së PPB-së dhe rritjes së punësimit, i cili ka qenë i deformuar dekadën e fundit. Ndërkohë, zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve publike për të përmbushur nevojat në rritje të fuqisë punëtore relativisht të re në Shqipëri, për të hapur mundësi punësimi për të gjithë, do të mundësojë rritjen e qëndrimit aktiv të njerëzve në tregun e punës, jo thjesht përmes rritjes së moshës së daljes në pension.

Në dhjetë vitet e fundit, me pjesëmarrjen e disa aktorëve, duke përfshirë shoqërinë civile, partnerët socialë dhe me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, bazuar në Strategjinë Evropiane 2020, janë hartuar instrumente të tilla si Strategjia për Zhvillim dhe Integrim 2015 –2020, Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020 etj., duke theksuar burimet njerëzore si faktorin kyç për përparimin e vendit. Gjatë vitit 2016, vlera e Indeksit të Pabarazisë Gjinore në Shqipëri u llogarit në 0,08. Kjo tregon një humbje në zhvillimin njerëzor, si rezultat i një pabarazie gjinore prej 8 për qind në aspektin e zhvillimit njerëzor dhe shërben si një bazë empirike për politikat gjinore *(INSTAT, 2017b:125)*. Tradicionalisht, gratë kanë qenë në pozita më të dobëta në shoqëri, pasi duke kontribuar më shumë në familje, i nënshtrohen varësisë ekonomike nga burrat, duke lënë mënjanë fuqizimin e tyre ekonomik. Në vitin 2015, shkalla e pjesëmarrjes së burrave në pozi-

cionet drejtuese ishte 72,2 për qind, kundrejt 51,3 për qind për gratë, me një hendek prej 20,9 pikë *(INSTAT, 2016)*.

Zhvillimi i politikave për gratë sipërmarrëse mbetet një sfidë e vërtetë. Përfshirja në aktivitetet e ndërmarrjes nënkupton më shumë liri ekonomike dhe fuqizim të pozitës së grave në shoqëri. Plani i Veprimit për Mbështetjen e Grave Sipërmarrëse 2014 –2020, projektuar në bashkëpunim me UN Women në Shqipëri, përbëhet nga pesë shtylla: i) mbështetje politike, ii) arsim dhe trajnim, iii) qasje në financa dhe konkurrencë, iv) rrjetëzim, v) pjesëmarrja e grave në ekonominë rurale *(Ministri i Ekonomisë, Urdhër nr. 339, datë 19.06.2014)*.

Krahas me nxitjen e punësimit, sfida të tjera si mbrojtja sociale me baza universale, balancimi i përfitimeve me kontributet sociale dhe pensionet, të mësuarit përgjatë gjithë jetës, jetesa e gjatë dhe e shëndetshme për të gjithë dhe kohezioni social qëndrojnë në rrugën drejt integrimit evropian. Futja e skemave të pensioneve profesionale shtesë do të inkurajojë profesionistë të ndryshëm, si profesorët, që të zgjasin qëndrimin e tyre aktiv në punë. Këto sfida kanë nevojë për angazhim të tërë shoqërisë, bashkëpunim mes strukturave shtetërore dhe atyre të shoqërisë civile e biznesit privat.

Aktualisht, objektivi kryesor i shoqërisë shqiptare është të bëjë më të mirën për zbatimin e suksesshëm të strategjive dhe legjislacionit, duke reflektuar në bazë të problemeve që do të dalin nga zbatimi i tyre. Ky proces kërkon koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin sistematik të politikave, duke identifikuar qasjet dhe instrumentet më të përshtatshme të ndërhyrjeve. Përvojat ndërkombëtare mund të merren parasysh për Shqipërinë si një vend në tranzicion, që synon të ndërtojë në të njëjtën kohë demokracinë, shtetin ligjor, ekonominë e tregut dhe shtetin e mirëqenies.

Kur dështimet e tregut rezultojnë në pabarazi strukturore të tregut të punës, janë përdorur ndërhyrje të përshtatshme për të parandaluar ose zbutur kostot e mëdha ekonomike dhe sociale, në fusha të ndryshme të politikave si: edukimi përgjatë gjithë jetës, politikat aktive të tregut të punës dhe sigurimeve shoqërore, ristrukturimi i ekonomisë dhe bashkëpunimi rajonal në Ballkan. Aktorët politikë në Ballkanin Perëndimor kanë nevojë të hartojnë një kornizë të re rajonale për të zhvilluar disa objektiva, tregues dhe rrjete të përbashkëta për të ndarë qasjet më të mira inovative në politikat e punësimit. Një bashkëpunim rajonal për të lehtësuar lëvizjen e fuqisë punëtore të kualifikuar në tregun rajonal të punës, do të ishte një mënyrë për t'u shpëtuar kufizimeve të tregut të punës në vendet e veçanta të Ballkanit Perëndimor.

Literatura

1. European Commission, Xhumari, M., & Dibra, S., & Bartlett, W., (2016) From University to Employment: Higher Education Provision and Labour Market Needs in Albania, European Commission, Luxembourg: Publications Office of the European Union, ISBN 978-92-79-54670-9, https://ec.europa.eu/education/sites/education/files/2016-higher-education-labour-market-balkans_en.pdf

2. European Training Foundation, 2014, Skills 2020 Albania. https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/m/27795DDCBD2353DAC1257D6400322D57_FRAME%20Skills%202020%20Albania.pdf

3. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Raporti Vjetor, 2015, https://www.fsdksh.com.al/botimet

4. ILO, Convention no.102/1952 on Minimum Standards of Social Security

5. INSTAT, (2016), Anketa e Forcave të Punës, http://www.instat.gov.al

6. INSTAT, (2012), Studimi mbi Nivelin e Jetesës, http://www.instat.gov.al/al/themes/niveli-i-jetes%C3%ABs.aspx

7. INSTAT, (2011), Census, 2011, Tirana: http://www.instat.gov.al/media/178070/rezultatet_kryesore_t__censusit_t__popullsis__dhe_banesave_2011_n__shqip_ri.pdf

8. INSTAT (2017a). Buletini Statistikor 2017. http://www.instat.gov.al/media/3655/vjetari-statistikor-2017.pdf. Accessed 17 August 2018.

9. INSTAT, (2017b), Gratë dhe Burrat në Shqipëri, 2017, Tirana: http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2017/women-and-man-in-albania,-2017.aspx

10. INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik dhe ICF. 2018. Albania Demographic and Health Survey 2017-18. Tiranë, INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik dhe ICF.

11. INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik dhe ICF (2010), Albania Demographic and Health Survey 2008-09. Tirana, INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik dhe ICF.

12. INSTAT, SDC, UNFPA, (2015a), Population Ageing: Situation of Elderly People in Albania, available at http://www.instat.gov.al/media/316728/population_ageing_situation_of_elderly_people_in_albania.pdf

13. INSTAT, SDC, UNFPA, (2015b), Youth in Albania, Challenges in changing times.

14. Instituti i Sigurimeve Shoqërore: http://www.issh.gov.al/al/wp-content/uploads/2014/02/issh-per-tu-pare-shqip-ang.pdf

15. Instituti i Shëndetit Publik & UNICEF, (2014) National Health Report, Health Status of the Albanian Population: http://ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/04/Health-report-English-version.pdf

16. Këshilli i Ministrave, Programi i Reformës Ekonomike 2017-2019: http://www.ekonomia.gov.al/files/userfiles/ERP_2017-2019_en.pdf

17. Këshilli i Ministrave, Strategjia për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020.

18. Këshilli i Ministrave, Vendim nr. 371, datë 18.05.2016.

19. Këshilli i Ministrave, Programi për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale 2017–2021, http://www.shendetesia.gov.al

20. Ministri i Ekonomisë, Urdhër nr. 339, datë 19.06.2014 "Plani Kombëtar i Veprimit për Gruan Sipërmarrëse, 2014–2020".

21. National Centre for Social Studies (2015) 'Social profile of older people in Albania', the survey supported by UNFPA and Swiss Cooperation.

22. Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Raporti Vjetor 2016. http://kerkojpune.gov.al/ëp-content/uploads/2015/01/BULETINI-2016.pdf

23. World Bank Group Education, Albania PISA 2015, available at: http://documents.worldbank.org/curated/en/514991486033920486/pdf/112466-BRI-Albania-Program-for-International-Student-Assessment-2015.pdf

24. United Nations, Policies and Programmes for Older Persons in Albania, Report of a Fact-Finding Mission, 10 – 13 October 2011.

25. UNDESA/ DSPD Fact Gathering Mission in Albania in 2011.

26. UNDP, (2015), Strengthening the Decision-Making Power of Council women in Albania, Tirana

27. UN Women & UNDP (2016) Gender Brief Albania Report, realized under the project "Gender Equality Facility in Albania Phase I".

28. Xhumari, M., (2011) "Pension Trajectories in Western Balkans 1990 – 2010", UNFPA, "Pegi" Tirana, ISBN 978-9928-124-24-1.

Legjislacioni

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Fletore Zyrtare e R.SH. nr. 28, 1998, amenduar më 13.01.2007.

2. Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

3. Ligji nr.7870, datë 13.10.1994 "Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011.

4. Ligj nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin 136/2015.

5. Ligji nr.7995, datë 20.09.1995 "Për Nxitjen e Punësimit", i ndryshuar.

6. Ligji nr.9970, datë 24.07.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri"

7. Ligji nr.161/2014 për ndryshime në Ligjin nr.10237, datë 18.02.2010 "Për Sigurinë Shëndetësore në Punë"

8. Ligji nr.10107, datë 30.03.2009, "Kujdesi Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"

9. Ligj nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

SISTEMI I PENSIONEVE DHE MISIONI I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Prof.Asoc.Dr. ***Hasan HOXHA***[1]

Abstract

Since 1993, in Albania is in the function Pay-as-you go social insurance system, that is developed in the principle of generation's solidarity.This scheme in the center has the support of citizens during the period when they lost the ability to work. In Albania, as well in the other democratic countries, the right for pension is universal. This scheme covers all employments, regardless of branches, sectors or residences. The Social Insurance Institute (SII) is an indipedent institucion that manage the scheme through his statute. The mision of SII is responsible that the scheme to be comprehensive and balanced in the main proportions, especially between expenditures and revenues, benefits and contributs, among to different groups of population etc. The scheme is increasing and widening year after year, but not in all elements.For example, voluntary insurance has not progress for years. In addition, during 2011-2017, the number of pensions was raised by 13.2 per cent, while expenditures about 48 per cent. The mission of SII in the center of his activity has interests and problems of the citizens. But in the practice, from the analisyes results that many citizens faced with difficulties and delays in the resolving of their rights for pensions. In the paper are underlined some causes that are related with violations of law, professional inability of the different SII structures etc. In some cases, a negative impact have had the political interferences in the personnel nominations. The revision of the personnels rule will improve the activity of specialist in SII and in his branches in the country regions.

Key words*: Social Insurance Institute; Albania; Pay as you go system; Generation solidarity; Mission of SII; Voluntary insurance; Expenditures and revenues.*

---

1) Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore në vitet 2013 – 2017.

Hyrje

Në Republikën e Shqipërisë sigurimet shoqërore zhvillohen sipas skemës Pay-as-you go, në përputhje me parimin e solidaritetit midis brezave. Skema e sigurimeve shoqërore në vendin tonë, në konceptimin e saj dhe në legjislacionin mbështetës, nuk përmban kufizime të karakterit degësor, apo territorial. Prej vitit 1993, në legjislacionin shqiptar e drejta për pension është universale, si dhe në të gjitha vendet demokratike. Ajo mbulon të gjithë të punësuarit, pavarësisht degës, sektorit apo vendbanimit.

Skema e pensioneve është e shtrirë edhe drejt kategorive të veçanta, si të punëtorëve të bujqësisë apo të krejt të vetëpunësuarve që në shumicën dërmuese të tyre janë në sektorët e tregtisë e të turizmit, në sektorët e shërbimeve dhe në prodhim.

Menaxhimi i skemës së sigurimeve shoqërore realizohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSh), që është mbizotëruese edhe në skemat publike të pensioneve të mjaft vendeve të tjera. Në të gjitha elementet dhe pjesët përbërëse të tij, një organizim i tillë në vendin tonë u përmbahet principeve të shpallura nga Organizata Ndërkombëtare e Punës. Ndërkaq, një gjë e tillë mbështetet në statutin e Institutit, buron nga ligji bazë i sigurimeve shoqërore, përbën misionin e tij.

ISSh është krijuar me vendim të KM, ndërkohë që statuti në nenin 1 e përcakton atë institucion publik, shtetëror e të pavarur, që operon me zyra rajonale në gjithë vendin.

Fondet e sigurimeve shoqërore administrohen nga ky institut sipas përcaktimit: "Të ardhurat realizohen dhe shpenzimet kryhen sipas ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, në të pesë degët e përcaktuara". ISSh ka përgjegjësi për arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga derdhja e kontributeve për të punësuarit, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore; ka përgjegjësinë për pagesën sipas ligjit të përfitimeve të të siguruarve; përgjigjet për investimin e fondit rezervë. Përmes organeve të tij vartëse, në rajone e qytete, ISSh kryen veprime për sigurimin e detyrueshëm të të punësuarve, cakton masën e pensionit për çdo kategori përfituesish në

bazë të dokumenteve, si dhe bazuar në dispozitat ligjore. Fusha e mbulimit të skemës publike të sigurimeve shoqërore dhe mënyra e menaxhimit dhe administrimit të skemës përmes ISSh janë pjesë e rëndësishme e misionit të këtij institucioni, me anën e të cilit realizohet politika kombëtare e sigurimeve shoqërore.

1. Përmbajtja e misionit të ISSh

Misioni i ISSh, i afishuar dhe në faqen zyrtare, është administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithsi dhe i politikës së pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij institucioni, mbulimi i popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore në çdo vend e kohë kur lind kjo e drejtë, rritje e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetarë, përmirësimi i eficiencës në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.

Pra, skema e sigurimeve shoqërore ka në qendër të misionit të saj mbulimin e popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore dhe akordimin e përfitimeve për pension, paaftësi të përkohshme në punë, barrëlindje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale e përfitime suplementare në momentin e lindjes të së drejtës dhe nevojës për to.[2]

Krahas detyrimeve si më sipër, nga e gjithë përmbajtja e statutit, veçanërisht nga plotësimi i kërkesës së nenit 1 të tij, kuptohet qartë se detyrë me rëndësi për ISSh-në janë dhe studimet në fushën e kontributeve, në fushën e përfitimeve, studimet për harmonizimin shumëplanësh të përfitimeve që jepen me kontributet e paguara, apo studimet për harmonizimin e interesave të punëmarrësve me ato të punëdhënësve. Për punëmarrësit, me mjaft rëndësi është të realizohet interesi i tyre, për të siguruar pagesa dinjitoze e të justifikuara, ndërsa për punëdhënësit, të mos dëmtohen bizneset jashtë mundësive, të mos cenohet prirja për zhvillim e sektorit përkatës, për të realizuar fitime, ose, krahas realizimit të fitimit, edhe për të përmbushur detyrimet fiskale, me synim që investimet të shtohen, ndërsa të përmirësohen edhe koeficientët e efektivitetit të tyre.

2) Sipas përcaktimit në faqen zyrtare të ISSh-së.

Përfundimet e studimeve për zhvillimet afatshkurtra, ashtu dhe ato për periudha kohore afatgjata, për studimet pjesore apo të përgjithshme, për elemente të veçanta apo për krejt kompleksitetin e tyre, vihen në dispozicion të Drejtorit të Përgjithshëm, pastaj të Këshillit Administrativ, i cili, nga ana e tij, i përcjell ministrisë së linjës propozimet dhe mendimet për ndryshime dhe përmirësime në ligjin bazë të sigurimeve shoqërore. Madje, nisur nga nevoja për përsosjen, por dhe nga ajo për ndryshime, nisur nga reformimi që skema pëson gjatë viteve, me rëndësi dhe mjaft e domosdoshme është nevoja për të hartuar rregullore, për të përmirësuar rregulloret ekzistuese, sidomos për fusha unike të administrimit të sigurimeve shoqërore, si dhe për fusha e çështje të veçanta që janë pjesë e së përgjithshmes.

Nga këndvështrimi i pjesëve përbërëse të misionit të afishuar, nga kërkesat për përmbushjen e tyre, ISSh i ka të përcaktuara konturet e vizionit të saj, ka programe shumëplanëshe, ndërton në mënyrë permanente dhe përsos metodat e punës dhe organizimit.

Në zbatim të misionit, ISSh fokusohet në mbledhjen e informacionit, në kryerjen e studimeve si nevojë për përmirësimin e skemës aktuale, përmes reformimit të shtyllës publike të pensioneve, forcimit të një lidhjeje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme, futjes graduale të skemës së përfitimeve suplementare të menaxhuara nga subjektet jopublike, krijimit të llogarive personale të çdo kontribuesi e përfituesi, arritjes së transparencës maksimale, duke krijuar aksesin e nevojshëm për secilin prej tyre. Zhvillimet në këto fusha shprehen me anën e disa treguesve, me përmbajtje sasiore dhe cilësore, të plotë apo të pjesshme, të përhershëm apo periodikë.

2. Disa tregues të zhvillimit të skemës dhe misioni i ISSh-së

Misioni i gjerë e shumëplanësh i skemës së pensioneve është i matshëm për secilën fushë apo pjesë përbërëse dhe shprehet me anën e disa treguesve, si vijon:

Së pari, skema është rritur e zgjeruar pothuajse në të gjithë përbërësit e saj *(Tabela 1)*. Kështu, është shtuar numri i përgjithshëm i pensionistëve, së bashku me të gjitha pjesët përbërëse. Numri i kontribuesve gjithashtu është shtuar, sidomos në komponentë të veçantë. Vërehet rritje e të ardhurave kontributive, si dhe një rritje e shpenzimeve për pensionet. Produkti i këtyre zhvillimeve, me nivele në rritje të treguesve, shpreh prirje pozi-

tive të këtij zhvillimi, zgjerim të skemës publike të pensioneve, pasqyron karakterin gjithëpërfshirës të skemës publike të sigurimeve shoqërore.

Së dyti, edhe pse në tërësi skema është rritur dhe zgjeruar, në disa elemente të saj nuk ka ndodhur e njëjta dukuri. Për shembull, sigurimi vullnetar nuk është zgjeruar, edhe pse ai është shumë i nevojshëm për shumë kategori të popullsisë, që praktikisht nuk kanë mundësi të punësohen dhe të sigurohen përmes punësimit në sektorë të ndryshëm.

***Tabela 1**: Disa tregues të zhvillimit të skemës së sigurimeve shoqërore*

Nr.	Treguesit	Njësia matëse	Viti 2011	Viti 2017	2017/ 2011, %
1	Popullsia	Numër	2.831.741	2.783.457	101,4
2	Kontribues gjithsej	“	562.146	752.383	133,8
3	Kontribues vullnetarë	“	8.493	8.027	94,5
4	Të vetëpunësuar në bujqësi	“	78.998	58.526	74,1
5	Të vetëpunësuar në sektorë të tjerë	“	77.337	110.472	142,8
6	Pensione gjithsej	“	548.675	621.186	113,2
7	Pensione suplementare	“	27.121	33.884	124,9
8	Të ardhurat gjithsej	mln lekë	67.725	73.556	108,6
9	Shpenzimet gjithsej	“	80.428	119.081	148,1

***Burimi**: Raportet vjetore të ISSh-së, ndërsa për popullsinë, të dhënat sipas faqes zyrtare të INSTAT-it.*

Nivelet thuajse të njëjta të numrit të të siguruarve vullnetarë, sipas të dhënave të përpunuara të një pyetësori, shpjegohen me faktin se nga pagesa e kontributeve vullnetarisht ndikimi i tyre i ardhshëm në masën e pensionit nuk është shumë efektiv.

Në të vërtetë, ky konsiderohet koeficient i ulët shpërblimi, po të kihet parasysh dhe mënyra ndryshe e sigurimit të fondeve për këtë fushë sigurimi. Sepse, në kësi rastesh, kuotat e paguara nuk janë produkt drejtpërdrejt i punës, ndërkohë që për të vetëpunësuarit në sektorët e tjerë (veç bujqësisë), siç janë shërbimet, tregtia apo turizmi, edhe pse masa e pagesës është e njëjtë me sigurimin vullnetar, kontributet për sigurimet shoqërore si të vetëpunësuar në këta sektorë përballohen nga të ardhurat që sigurohen përmes ushtrimit të këtyre veprimtarive.

Së treti, skema publike e sigurimeve shoqërore rezulton me përmasa

të shtuara, edhe për sa i përket vëllimit të të ardhurave kontributive. Rritja e tyre në vitin 2017, krahasuar me vitin 2011, në afro 9 për qind, shpjegohet jo vetëm me shtimin e numrit të kontribuesve, por dhe me shtimin e kontrolluar të pagës minimale, për efekt të pagesës së kontributeve. Veçse, shtesa e ulët e të ardhurave kontributive krahasuar me shtesën e numrit të kontribuesve sjell në vëmendje faktin se pothuajse në të gjithë sektorët shumica dërrmuese e të vetëpunësuarve i paguan kontributet në nivelin e pagës minimale të caktuar ligjërisht për këtë qëllim.

Nga ana tjetër, zgjerimin e skemës apo rritjen komplekse të shkallës së mbulimit e vërteton sidomos rritja e shpenzimeve për sigurimet shoqërore në përgjithësi dhe në veçanti rritja e shpenzimeve për pensione. Për periudhën 2011 – 2017, kur krahasohen shtimi i numrit të pensioneve me shtimin e shpenzimeve për pensione, rezulton një rritje më e madhe e këtyre të fundit. Numri i pensioneve është shtuar me 13,2 për qind, ndërsa shpenzimet e përgjithshme për to rritjen e kanë rreth 48 për qind. Edhe pse nga ky krahasim dallohet qartë se është rritur niveli i pensionit mesatar për krejt kategorinë e përfituesve, niveli i normës së zëvendësimit nga skema publike e pensioneve nuk shihet të jetë rritur. Prej këtej vijmë në përfundimin se ndihet nevoja për rivendosjen e disa raporteve në treguesit bazë të fushës së punës e pagave, të kontributeve për sigurimet shoqërore dhe pensionet.

Gjithesesi, rritja e treguesve vëllimorë të skemës, si dhe përmirësimi i disa raporteve, vërtetojnë faktin e rëndësishëm të përmbushjes së misionit të skemës se, tashmë zhvillimi i saj është me karakter universal. Ky zhvillim përfshin krejt territorin e vendit, u përket të gjitha qarqeve, nuk ka më dallime të ndjeshme midis rajoneve, si dhe territoreve më të vogla.

Në anën tjetër, edhe për sa u përket sektorëve dhe degëve të ekonomisë, treguesit kryesorë të zhvillimit flasin për shtrirje të përgjithshme, ndërsa nivelet e tyre nuk përcjellin diferenca të theksuara. E kundërta e kësaj, nëse do të zhvillohej në përmasa të mëdha, do të shoqërohej me zhvillime të njëanshme të skemës së sigurimeve, do të lexohej për natyrë përjashtuese të saj, për diskriminim të ndonjë rajoni, apo të tjera të supozuara, siç mund të ishte territori i fshatit krahasuar me qytetin, bujqësia krahasuar me industrinë apo me ndonjë sekto tjetër.

Nga pikëpamja teorike, si dhe në bazë të legjislacionit ekzistues, edhe pse nuk ka kufizime, në të vërtetë disa prej tyre vijnë nga pamundësia që në praktikë kanë disa kategori e individë të ndryshëm për të përfituar nga ligji, apo për t`iu përgjigjur kërkesave të tij. Mbulimi i popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore në legjislacionin tonë është pa kufizime, ndërkohe

statistikat, të cilat pasqyrojnë zhvillimet në këtë fushë, janë me mangësi.

Disa nga këta tregues, që praktikisht edhe ndiqen, siç janë fuqia punëtore në raport me popullsinë ekonomikisht aktive, apo në raport me krejt popullsinë, këta e të tjerë tregues, siç shihen në tabelën 2, rezultojnë në nivele relativisht të ulëta. Në vitin 2017, vërehet rritje e peshës specifike të kontribuesve në raport me popullsinë, por ky tregues vazhdon të jetë ende në nivele të ulëta, vetëm 26,2 për qind. Kjo do të thotë se, mesatarisht në çdo 4 banorë, vetëm diçka më shumë se një person rezulton të jetë kontributiv në skemën e sigurimeve shoqërore. Kontribuesit rezultojnë të jenë në nivele të ulëta, madje me diferenca të theksuara ndaj numrit të popullsisë aktive. Vetëm rreth 55 për qind, ose vetëm pak më shumë se gjysma e popullsisë aktive rezulton të jetë kontributive në skemën publike të sigurimeve shoqërore.

Niveli i këtij treguesi argumentohet me shumë faktorë. Fillimisht janë kategoritë e popullsisë që brenda moshës së punës ndjekin shkolla e kurse, apo ata që janë të paaftë fizikisht, të cilët potencialisht ulin kontigjentin e të punësuarve me kontribute. Peshë të veçantë në hendekun e krijuar midis numrit të kontribuesve në skemë dhe numrit të popullsisë aktive rezulton të ketë niveli i papunësisë, si dhe punësimi informal në sektorë të ndryshëm. Ndërsa niveli i papunësisë në vitet 2011 – 2017, sipas të dhënave zyrtare, luhatet midis shifrave 15 dhe 18 për qind, niveli informal i punës ose ndryshe, *puna në të zezë*, rezulton të jetë rreth dy herë më e lartë.

Kështu, midis numrit të të punësuarve dhe atyre që paguajnë kontribute, shfaqet diferencë në shumë sektorë, por ky tregues vazhdon të jetë tepër i lartë në sektorin e bujqësisë. Në vitin 2011, të punësuar në sektorin privat bujqësor llogariteshin 507 mijë persona, ndërkohë që numri i kon-

***Tabela 2**: Niveli i mbulimit të popullsisë me disa elemente të sigurimeve shoqërore, %*

Nr.	Treguesit	Viti 2011	Viti 2017	Ndryshimi (+ / -)
1	Numri i kontribuesve ndaj popullsisë gjithsej	19,3	26.2	6,9
2	Numri i kontribuesve ndaj forcave aktive	53,1	56,2	3,1
3	Numri i pensioneve ndaj popullsisë	18,9	21,6	2,7
4	Niveli i pensionit mesatar në qytet ndaj pagës mesatare neto	47,9	45,2	-2,7

***Burimi**: Të dhënat absolute janë sipas vjetarëve statistikorë të ISSh-së. Popullsia aktive është sipas INSTAT-it. Niveli i kontribuesve ndaj forcave aktive i përket vitit 2016 dhe është sipas Buletinit Statistikor 2016, Anketa e forcës së punës, INSTAT, faqe 10.*

tribuesve fizikë në skemën e sigurimeve shoqërore është më pak se 80 mijë veta, ose më pak se 20 për qind e kontigjentit përkatës.[3]

Kjo ka ndikuar në parametrat e ulët të mbulimit të skemës dhe shoqërohet me pasoja në rishpërndarjen e kontributeve, si dhe me mungesën e mjeteve financiare për një pjesë të popullsisë, atëherë kur ajo nuk do të ketë mundësi fizike për të siguruar të ardhura për jetesë.

3. Interesi i qytetarit, pjesë e misionit të ISSh-së

Skema publike e sigurimeve shoqërore në qendër të saj ka njerëzit në marrëdhënie pune dhe, përtej saj, se si trajtohen ekonomikisht ata për periudhën kur nuk mund të punojnë, për shkak të humbjes së aftësisë për punë. Krijimi i ISSh dhe miratimi i statutit të tij e solli skemën dhe misionin e këtij institucioni në standarde të tjera. Misioni i ISSh është vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij institucioni.[4] Pra, në qendër të punës dhe të veprimtarisë së ISSh-së është qytetari kontribues në skemë, në të gjitha pjesët e saj si dhe qytetari përfitues për të gjitha llojet e përfitimeve.

Kësisoj, interesat e qytetarit, të cilët burojnë nga vetë qëllimi i skemës, mbajnë vendin e veçantë në të gjitha rastet, edhe atëherë kur janë projektuar ndryshimet ligjore në fushën e përfitimeve, kur është projektuar lidhja më e fortë e përfitimeve me nivelin e kontributeve, kur u hoq tavani për nivelin maksimal të pensionit, ndërsa për pensionin minimal u rivendos një dysheme më e lartë, e barabartë kjo me pensionin social.[5]

Po kështu, përsëri në fushën e përfitimeve, gjithnjë ka mbizotëruar interesi ekonomik i qytetarit edhe për sa u përket ndryshimeve të tjera ligjore. Nga ana tjetër, për shkak të misionit që ka skema publike e pensioneve, puna dhe veprimtaria e ISSh-së është mirorientuar edhe në fushën e kontributeve. Nga vetë përmbajtja që bart, edhe kjo fushë, në qendër të çdo lloj zhvillimi, përsëri ka qytetarin, së bashku me interesat kompleksë të tij. Kështu ka ndodhur edhe kur janë caktuar kuotat për pagesën e kontributeve, edhe kur është projektuar struktura e tyre, kur janë caktuar

---

3) Statistika të Sigurimeve Shoqërore, botim i ISSH-së, janar-dhjetor 2011, fq. 1.

4) Sipas përcaktimit në faqen zyrtare të ISSh-së.

5) Me interesin e qytetarit në skemën e sigurimeve shoqërore do të kuptohet, në çdo rast, interesi i tij si kontributpagues dhe si përfitues prej saj.

kuotat kontributive sipas degëve të sigurimeve shoqërore, edhe kur janë modifikuar raportet midis punëdhënësve dhe punëmarrësve për nivelin e kontributeve që paguhen nga secili prej tyre.

Në themel të veprimtarisë së ISSh-së është dhe mbetet qytetari kontribues dhe ai përfitues, kur përcaktohen rregullat, kur ndërtohen programe dhe hartohen rregulla përgjithësuese dhe unifikuese. Madje edhe kur ndërtohen evidenca, kur plotësohen ato dhe bëhen analiza afatshkurtra, kur nxirren përfundime prej tyre, siç janë afatet e caktimit të pensioneve, si dhe shumë aspekte të tjera.

Në qendër të çdo procedure, diskutimi, analize dhe përfundimi për të ardhurat e sigurimeve shoqërore të akumuluara në buxhetin e shtetit, sidomos për të ardhurat e siguruara drejtpërdrejt nga ISSh-ja, mbahet parasysh interesi i qytetarit, i cili, në njëfarë mënyre, projekton sigurinë e tij ekonomike dhe financiare në një periudhë të rëndësishme të jetës së tij, atëherë kur humbet aftësinë për punë.

Pra, në qendër të çdo lloj diskutimi e analize, periodike dhe vjetore, si për të ardhurat e shpenzimet, për kontributet apo për përfitimet, janë qytetarët, sidomos pensionistët e të gjitha kategorive. Me këtë qasje zhvillohen analizat e punëve në sektorët juridikë, kur analizohet numri i qytetarëve që brenda vitit ndjekin proceset gjyqësore për të marrë pensionin, kur vlerësohet puna e sektorëve të përfitimeve, të arkivës dhe sektorëve të tjerë, lidhur me numrin e kërkesave e të ankesave, për përgjigjet që jepen si dhe për nivelin e tyre profesional.

Në pamje të parë duket se nuk ka lidhje, por në themel të veprimtarisë së ISSH-së përsëri vëmendja ndaj qytetarit, si pjesë e misionit të tij, gjendet edhe në pjesën monitoruese dhe atë të çertifikimit në proces të të gjitha llojeve të përfitimeve që gjenerohen. Nga auditimi i ligjshmërisë së caktimit të pensioneve, pasaktësitë në dëm të përfituesve u rikthehen me të ardhurat përkatëse këtyre të fundit, ndërsa në rastet e përfitimeve të padrejta, ato u ndalohen "përfituesve", me ndikime pozitive kjo në të ardhurat e përgjithshme të sigurimeve shoqërore.

Shërbimi ndaj qytetarit, si pjesë e misionit të ISSh-së, sigurisht që matet me disa tregues e raporte që janë ndërtuar dhe, brenda logjikës së zhvillimit, përsosen nga koha në kohë. Nja nga fushat kryesore që prej disa vitesh monitorohet dhe përbën edhe objektin e analizave periodike e vjetore, është afati i caktimit të përfitimeve. Përqindja e caktimit brenda afatit të të gjitha llojeve të pensioneve, si dhe numri i ditëve mesatare të caktimit të tyre, këto janë dy nga treguesit kryesorë që shprehin gjendjen dhe zhvillimin e kësaj

fushe. Për dy vitet ekstreme të pesëvjeçarit të fundit, të dhënat shfaqen qartë në *Tabelën 3*. Nga të dhënat e përpunuara të kësaj tabele nënvizojmë disa përfundime kryesore:

Së pari, mbi 90% e pensioneve të reja të caktuara në vitet 2011 dhe 2017 gjenden brenda afatit të parashikuar në rregulloren përkatëse. Për caktimin e një pensioni mesatarisht, në të tre llojet e tij janë konsumuar 21-25 ditë, gati sa gjysma e afatit të parashikuar në rregulloren e caktimit të pensioneve. Në nivelin pozitiv të këtij treguesi sigurisht që peshë të veçantë zënë pensionet e pleqërisë.

Së dyti, viti 2017, krahasuar me vitin 2011, shënon një përmirësim të dukshëm në treguesit e mësipërm. Kështu, koha mesatare e caktimit të një pensioni ka ardhur në rënie për shkak të përmirësimit të këtij treguesi për pensionet e pleqërisë që, në tërësinë e përgjithshme, zënë peshën më të madhe. Për pensionet e pleqërisë dhe ato familjare është ulur gjithashtu numri mesatar i ditëve për caktimin e tyre, ai vazhdon të jetë brenda afatit që gjendet në rregullore.

***Tabela 3**: Afatet mesatare të përpunimit të kërkesave për pension*

Nr.	Treguesit	Pensione pleqërie		Pensione invaliditeti		Pensione familjare	
		Viti 2011	Viti 2017	Viti 2011	Viti 2017	Viti 2011	Viti 2017
1	Koha mesatare e përpunimit të kërkesave për pension, në ditë.	25,3	21,6	21,6	34,8	22,8	20,6
2	Pensionet e caktuara brenda afatit, %.	90,6	96,1	93,2	78,7	90,2	95,8

***Burimi**: Vjetarët statistikorë të viteve përkatëse, botim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.*

Së treti, vërehet një përkeqësim në fushën e pensioneve të invaliditetit për sa u përket afateve kohore të caktimit të tyre. Kjo shihet edhe përmes dy treguesve, sidomos nga numri i ditëve mesatare për një pension. Nga studimi i mëtejshëm i këtij problemi rezulton se keqësimi i treguesve të kësaj fushe ka si shkak edhe vonesat në komisionimin e invalidëve, apo kalimin e një pjese prej tyre për rivlerësim në Kempin Epror. Në nivelin e këtij treguesi, ndikim të veçantë ka edhe metodologjia që përdoret për llogaritjen e tij. Prandaj ndihet nevoja e monitorimit të këtij procesi në të

gjitha fazat e tij proceduriale, nevoja për saktësimin e metodologjisë së llogaritjes dhe unifikimin e praktikës së zbatimit, efektet e zgjatjes përtej një viti të afateve të komisionimit për kategori të caktuara të invalidëve.

Së katërti, me gjithë përmirësimet, shqetësim përbën ende fakti se brenda nivelit prej më pak se 10 për qind të pensioneve të reja që caktohen jashtë afatit, koha mesatare për këtë kategori shkon në disa muaj, mesatarisht në rreth pesë të tillë. Prandaj, ashtu si edhe për pensionet me probleme, lypet të ketë një vëmendje të shtuar nga strukturat përkatëse për analiza më të detajuara, mbase dhe për ndryshime metodologjike apo proceduriale.

4. Zgjidhja e problemeve të akumuluara - pjesë e misionit të ISSh-së

Fusha e caktimit të pensioneve, në një analizë komplekse të saj, krahas me zhvillimet pozitive, është shoqëruar dhe bart edhe disa dukuri aspak pozitive.

Së pari, brenda strukturës së pensioneve janë krijuar raporte jonormale midis grupimeve të ndryshme të pensioneve. Pensionet e refuzuara mbajnë ende peshë të lartë ndaj atyre pensioneve që caktohen brenda një viti; është i shumtë numri i pensioneve të pjesshme kundrejt tërësisë së pensioneve që caktohen po brenda së njëjtës periudhë kohore; vitet e punës të vlerësuara për pension vazhdojnë të jenë me diferencë jo të paktë kur krahasohen me vitet reale të punës, apo me vitet kontributive.

Së dyti, fusha e pensioneve brenda drejtorive rajonale vazhdon ende të shoqërohet nga një numër i konsiderueshëm ankesash dhe kërkesash të qytetarëve, përfshirë gjithë format legale të afishimit të tyre; vazhdon të jetë i shumtë dhe jo në rënie numri i ankesave në Komisionet e Ankimimit, në dy nivelet e tij; është i konsiderueshëm numri i qytetarëve, të cilët, për të përfituar pensionin, kalojnë çdo vit në procese gjyqësore të niveleve të ndryshme. Kësisoj, panorama e mësipërme tregon se një pjesë e qytetarëve, me gjithë përmirësimet në kohë, edhe në stadin aktual përballen me mjaft vështirësi për të përfituar pensionin në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Vështirësi ekzistojnë për të siguruar dokumentet e nevojshme për vitet e tyre të punës, për të identifikuar periudhat e tyre kontributive para vitit 1994, por edhe për gjysmën e dytë të viteve 1990. Veç vështirësive të këtij lloji, qytetarët përballen edhe me dokumente që mbartin ndërhyrje, korrigjime dhe paqartësi të ndryshme, dokumente të shkruara keq dhe jashtë

formateve të caktuara. Shumë nga këto mangësi kanë ardhur edhe nga moszbatimi i legjislacionit për arkivat, sidomos pas viteve 1990. Ruajtja dhe dorëzimi i një pjese të dokumenteve të vjetërsisë në punë nuk është bërë në kohë dhe sipas vendimeve të KM.

Një pjesë jo e vogël e problemeve të akumuluara në fushën e caktimit të përfitimeve për qytetarët vjen edhe nga mungesa e zbatimit të plotë të rregulloreve në hallkat e ndryshme brenda strukturave të sigurimeve shoqërore. Probleme vërehen në sportelet e pritjes së qytetarëve, ndërkohë që të tilla krijohen edhe nga papërgjegjshmëria e personave që përcjellin verifikimin e vjetërsive në punë.

Problemet në këto struktura të ISSh-së janë të shumta dhe, sipas natyrës, paraqiten komplekse, aq sa për t'i konstatuar ato, për t'i klasifikuar sipas profileve, për t'i adresuar sipas çdo hallke të strukturës, për të përcaktuar arsyet apo dhe personat përgjegjës, kërkon të mbështetet në statistika të plota, të ndiqet me anën e një evidence të posaçme, unike e të përpunuar mirë, nga dorëzimi i dokumenteve e deri në marrjen e përfitimit.

Përmbajtja e një evidence të tillë është e nevojshme të shoqërohet me një bilanc të plotë të pensioneve me probleme, për çdo profil të tyre. Nga kjo evidencë lypet të studiohen mirë kategoritë e dosjeve në vijim: dosjet e pensioneve që kthehen pa veprim, për të cilat vendimi është se nuk janë në kushte përfitimi; dosjet në të cilat pensioni caktohet i pjesshëm, sepse disa vite të punës apo vite kontributive nuk janë njohur nga strukturat përkatëse në Drejtoritë Rajonale; dosjet në të cilat pensioni nuk është llogaritur saktë, sipas kritereve apo dhe formulës që përcakton ligji.

Me anën e kësaj evidence, ndërkaq, mund të shihet zgjidhja që ka marrë një pjesë e problemeve, mund të lexohen gjithashtu dosjet që mbeten pa zgjidhje nga strukturat e ngarkuara, siç janë inspektori përpunues, dega e pensioneve në mbledhjet e saj, komisionet rajonale apo përgjigjet negative në Komisionin Qendror të Ankimit.

Bilanci i kësaj evidence do të tregonte se sa prej qytetarëve aplikues nuk marrin zgjidhjen e duhur në rrugë administrative apo sa prej tyre janë të 'detyruar' të ndjekin proceset gjyqësore. Kështu, kjo lloj evidence, e plotësuar saktë dhe me përgjegjësi intitucionale, veç pensioneve me probleme dhe zgjidhjes së tyre sipas hallkave, do të nxirrte në pah realisht edhe nivelin e punës, funksionimin efektiv ose jo të disa prej strukturave të sigurimeve shoqërore, së bashku me personat që ngarkon ligji dhe rregullorja përkatëse. Nga ana tjetër, përgjegjësitë ligjore dhe ato institucionale të punonjësve në secilën prej hallkave të strukurës kërkojnë dhe një auditim

ndryshe. Paraprakisht, për efekte reale të kontrollit, kërkohet të përcaktohen saktë kriteret e vlerësimit të çdo punonjësi, nga pritësi në agjenci te përpunuesi i dosjes së pensionit, më tej edhe në dy nivelet e komisioneve të ankimit. Vetëm kështu secili prej punonjësve të strukturës së sigurimeve shoqërore mund të marrë vlerësimet e duhura dhe të paanshme, mund të marrë përgjegjësitë që i takojnë përballë një dosjeje pensioni, gjithnjë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.

Ndonëse e aplikuar vetëm për pak muaj, evidenca e pensioneve me probleme, përpos ndonjë qëndrimi refraktar apo mangësie në plotësim, solli në vëmendje disa probleme dhe përfundime, sidomos për disa drejtori rajonale:

Së pari, niveli jo i kënaqshëm i disa treguesve dhe problemet e krijuara vijnë për faktin se është zbehur, për të mos thënë që në disa raste ka ecur në të kundërtën e tij, kohezioni ligjor, procedurial dhe profesional midis qytetarëve dhe disa punonjësve të sigurimeve shoqërore. Nuk janë të pakta rastet kur njerëzit nuk dëgjohen, nuk u jepet zgjidhje profesionale, disa prej tyre nuk marrin përgjigje të plotë dhe shteruese.

Së dyti, konstatohet një lidhje e dobët në aspektin ligjor e profesional midis strukturave të drejtorive rajonale nga njëra anë, dhe ISSh-së në anën tjetër. Mungesa e kohezionit në disa raste shoqërohet me pasoja në konceptimin e problemeve, sjell qëndrime të diferencuara në zgjidhjet që u jepen qytetarëve, por dhe për administrimin e fondeve të pensioneve. Rastet e kësaj natyre shtohen sidomos kur thellohen diferencat midis Drejtorive Rajonale dhe ISSh-së për sa i përket rekrutimit të burimeve njerëzore dhe trajtimit të tyre. Për shkak të kësaj dhe diferencave të ndryshme mbështetëse, vërehet se disa prej drejtorive në strukturën qendrore i largohen debatit profesional, nuk i shkojnë në fund kërkesës për zbatimin e plotë të rregulloreve, pasi rekrutimin e punonjësve atje, në drejtoritë rajonale, e bën drejtori përkatës, për të cilët herë-herë vlerësohet dhe merr më shumë pikë mbështetja politike krahasuar me kualifikimin dhe anën profesionale.

Së treti, disa prej problemeve që krijohen e kanë burimin edhe në prapambetjen relative të nivelit të rregullores e cila menaxhon burimet njerëzore. Kjo rregullore, e miratuar rreth dy dekada më parë, ka nevojë për përshtatje me zhvillimet kohore, ka nevojë të plotësohet me strukturën e ndryshuar si dhe me funksionet e shtuara. Plotësimi dhe përshkrimi i saktë i çdo vendi pune, në linjë vertikale dhe horizontale, do të përcaktonte detyrat dhe përgjegjësitë e çdo sektori dhe për secilën drejtori. Kësisoj, e gjithë baza e punëve dhe e funksioneve do të ristrukturohej, do të krijohej mundë-

sia për specializime të ngushta për secilin sektor dhe drejtori, për të shkuar natyrshëm në detyrat dhe përgjegjësitë e funksioneve më të larta drejtuese dhe administruese të skemës.

Përfundime

Ashtu si në vendet e zhvilluara, edhe në vendin tonë skema publike e pensioneve nga viti 1993 administrohet nga një institucion i pavarur siç është ISSh, përmes statutit të tij. Misioni i ISSh-së është i gjerë dhe kompleks, por atë mund ta shprehim në dy drejtime kryesore:

Së pari, në kujdesin që skema të jetë gjithëpërfshirëse dhe e ekuilibruar në disa prej raporteve, sidomos midis shpenzimeve dhe të ardhurave, midis përfitimeve dhe kontributeve në tërësi, por edhe sipas grupeve të ndryshme të popullsisë. ISSh, në vazhdimësi, lypet të studiojë, të nxjerrë përfundime dhe të propozojë përmirësimet e nevojshme ligjore.

Së dyti, në sjelljen e strukturave të ISSh-së ndaj kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve, si pjesë me rëndësi e misionit: "qytetari në qendër të veprimtarisë së të tij". Përveç shtimit të vëmendjes, me vlerë në këtë proces do të ishte edhe përcaktimi i procedurave të nevojshme që e gjithë kjo fushë të monitorohet me tregues të matshëm.

Analiza e zbatimit të misionit të ISSh-së nxjerr në pah edhe mangësi që duhen evidentuar dhe shmangur në të gjitha hallkat e sigurimeve shoqërore.

Skema e sigurimeve shoqërore është thuajse e plotë, por në disa aspekte dhe për disa kategori të popullsisë aktive që kontribuon atje kërkohet një baraspeshim më i studiuar midis kontributeve dhe përfitimeve. Grupe të veçanta, edhe pse paguajnë kontribute për degë të caktuara, ligjërisht janë të përjashtuara nga përfitimet dhe, në ndonjë rast, edhe e kundërta. Një ekuilibër më i mirë lypet edhe për raportet e përfitimeve me kontributet që paguhen.

Si pjesë e misionit të ISSh-së, në qendër të të cilit është qytetari me interesat dhe shqetësimet e tij, me gjithë përmirësimet, përsëri fusha e përfitimev, ka ende shumë probleme dhe kërkon më shumë vëmendje në drejtim të përmirësimit të legjislacionit, sidomos të rregulloreve apo udhëzimeve që janë atribute të dy hallkave drejtuese të institucionit. Nga studimi kompleks i gjendjes rezulton se ka qytetarë që sorollaten me muaj apo cenohen në të drejtat e tyre, ndërkohë që autorët nuk përgjigjen administrativisht

për gabimet e tyre. Analiza e disa të dhënave të përpunuara tregon që një pjesë e shqetësimeve të qytetarëve e kanë bazën e tyre në cenimin e kohezionit ligjor, profesional dhe atij insitucional midis drejtuesve dhe strukturave të ndryshme të sigurimeve shoqërore. Përveç ndikimit të politikës dhe ndërhyrjeve nga lart në emërime, jo rrallë situata është rënduar edhe për shkak të rregullores së vjetër të personelit, e cila jo vetëm nuk është e plotë, por dhe nuk respektohet me korrektesën e duhur. Për këtë arsye, është e nevojshme që rregullorja të rishikohet me synim për të parandaluar e zgjidhur ngërçet si dhe për të bashkërenduar kompetencat e strukturave të ndryshme të sigurimeve shoqërore.

Literatura:

1. Administrimi i Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri, Tiranë, 2009, botim i Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

2. Aktet ligjore dhe nënligjore për fushën e sigurimeve shoqërore.

3. Censusi i popullsisë dhe banesave, viti 2011, botim i INSTAT-it.

4. Dokumenti i Politikave të Pensioneve, 11 prill 2014.

5. Materiale trajnimi për sistemin e pensioneve dhe financimin e sigurimeve shoqërore, botim i ILO-s, Budapest, prill 2011.

6. Raportet vjetore 2011, 2014, 2015, 2017, botim i ISSh-së.

7. Revista "Demografia", botim i Shoqatës Shqiptare të Demografëve, Tiranë, nr.2 2015; nr.1 dhe nr.2, 2016; nr.1, 2017.

8. Statistika të Sigurimeve Shoqërore, janar-dhjetor 2011, botim i ISSh-së.

9. Vjetari statistikor 2010 – 2014, botim i INSTAT-it.

10. Vjetari Statistikor Rajonal 2015, botim i INSTAT-it.

KRONIKË

EKONOMIA E SHQIPËRISË NË RRJEDHAT E HISTORISË TË SHEKULLIT XX

Ky është titulli i monografisë së përgatitur nga prof. Hasan Banja e të botuar në vitin 2017 nga shtëpia Botuese EMAL, Tiranë.

Pas përfundimit të studimeve në Fakultetin e Ekonomisë të Industrisë në Institutin e Planit më 1952 në qytetin e Leningradit – sot Shën Pjetërsburg – të Federatës Ruse, Hasan Banja emërohet në institucione qendrore, në sektorë ekonomikë. Në vitet 1971–1991, prof. H. Banja kryen detyrën e drejtorit të Institutit të Studimeve Ekonomike, fillimisht në varësi të Këshillit të Ministrave, më pas të Akademisë së Shkencave etj.

Prof. Hasan Banja është autor i një numri të madh tekstesh studimore, monografish shkencore, artikujsh të botuar në revista dhe buletine, referatesh dhe kumtesash në konferenca brenda dhe jashtë vendit etj.

Prof. Hasan Banja e vijoi punën e tij studimore edhe pasi doli në pension. Në vitet 1991–1998, me përgatitjen e lartë teorike dhe përvojën e gjatë në punë studimore, me vullnet e këmbëngulje të rrallë ai analizoi veçoritë e zhvillimit ekonomik të vendit tonë gjatë shekullit XX, që i paraqitet lexuesit përmes kësaj monografie.

Monografia përmban 615 faqe dhe është e ndarë në 12 krerë që trajtojnë ecurinë e zhvillimit ekonomik të vendit tonë në periudha të caktuara historike dhe politike.

Katër krerët e parë (I – IV) përfshijnë periudhën nga krijimi i shtetit të ri shqiptar (28 nëntor 1912) dhe deri në Çlirimin e vendit (29 nëntor 1944).

Shtatë krerët e tjerë (V – XI) përfshijnë vitet nga Çlirimi i vendit deri në fund të 1990-s, që njihet si periudha e sistemit politik socialist, me ekonomi të planifikuar dhe të centralizuar.

Kreu XII trajton dekadën e fundit të shekullit XX, problemet e vështira të tranzicionit drejt një sistemi politik demokratik dhe ekonomie tregu.

Me cilësinë e redaktorit shkencor të monografisë, kam bërë sqarime plotësuese për çështje apo terma të karakterit ekonomik, gjeografik apo për ngjarje dhe personalitete historike apo politike që përmenden në këtë libër.

Nga kjo monografi kemi nxjerrë dhe përgatitur për botim një pjesë që trajton zhvillimet demografike në vendin tonë në shekullin XX, me fokus gjysmën e dytë të tij.

Luan Shahollari

DISA VEÇORI TË ZHVILLIMEVE DEMOGRAFIKE NË SHQIPËRI NË SHEK. XX

Prof. ***Hasan BANJA***[1]

Demografia, politikat demografike, regjistrimet e përgjithshme të popullsisë, si dhe çështjet e tjera që lidhen me to, kanë një histori të shkurtër në vendin tonë. Në mars 1918 autoritetet austriake kryen një regjistrim të popullsisë në pjesën e pushtuar prej tyre gjatë Luftës I Botërore, por ky nuk përfshinte të gjithë vendin, prandaj dhe nuk shërben për të bërë krahasime me të dhënat e regjistrimeve të mëvonshme. Përgjithësisht regjistrimet e popullsisë dhe treguesit e tjerë demografikë kanë filluar të trajtohen me fillimin e funksionimit të shtetit të ri shqiptar në vitet 1920. Regjistrimi i parë i popullsisë është kryer në shtator 1923. Të dhëna të këtij regjistrimi janë bërë publike në organet e kohës, sidoqë në mënyrë të pjesëshme. Numri i popullsisë banuese nga ky regjistrim doli 803.900 banorë, nga të cilët 15,9 për qind banonin në qytet dhe 84,1 për qind banonin në fshat *(Tabela 1)*.

Regjistrimi i dytë i popullsisë u krye në vitin 1930. Në këtë proces një kontribut të veçantë ka dhënë Teki Selenica, funksionar i lartë i administratës së qeverisë së A. Zogut, i cili ka qenë përgjegjës për realizimin e këtij regjistrimi. Ky ishte një regjistrim mbi kritere më bashkëkohore për kohën dhe përfshin edhe të dhëna për përbërjen e popullsisë sipas besimit fetar. T. Selenica ka meritë pasi të dhënat statistikore të regjistrimeve të viteve 1923 dhe 1930 i ka përmbledhur në monografi të botuara me ilustrime.[2]

Nga regjistrimi i vitit 1930 numri i popullsisë banuese doli 833.600 banorë, pra vetëm 19.200 banorë ose 2,4 për qind më shumë se më 1923, ndonëse kishin kaluar shtatë vjet. Kjo tregon se gjendja social-ekonomike,

---

1) Prof. Hasan Banja: Ekonomia e Shqipërisë në rrjedhat e historisë të shekullit XX. Shtëpia Botuese EMAL, 2017.

F. 492-505. Nxjerrë nga libri dhe përgatitur për botim nga L.Shahollari.

higjieno-sanitare dhe shëndetësore e vendit pak kishte ndryshuar nga shtatë vjet më parë. Sëmundjet, kushtet e vështira të jetesës sillnin epidemi dhe vdekje masive e të parakohshme. Regjistrimi i vitit 1930 mbetet i pari dhe i fundit i kryer gjatë qeverisjes së A. Zogut. Mbeten të paqarta shkaqet përse nuk është bërë ndonjë regjistrim tjetër i popullsisë gjatë periudhës së mëvonshme dhjetëvjeçare, kur shteti tashmë kishte fituar një përvojë në ushtrimin e funksioneve të tij në fushat kryesore administrative.

Regjistrimi i parë i pasçlirimit në vendin tonë është kryer më 30 shtator 1945 në kuadrin e zgjedhjeve të 2 dhjetorit për Asamblenë Kushtetuese. Numri i popullsisë doli 1.122 mijë banorë, 288.400 banorë ose 34,6 për qind më shumë kundrejt vitit 1930. Duke mbajtur parasysh se kishte kaluar një periudhë 15-vjeçare, shtesa mesatare e popullsisë ka dalë 2,3 për qind mesatarisht në vit.

Pas regjistrimit të vitit 1945, deri në vitin 1960 janë kryer edhe tre regjistrime të tjera të popullsisë, me një ritmikë, në çdo pesë vjet.

Regjistrimet janë bërë për disa qëllime njëherësh: për njohjen e numrit të popullsisë sipas gjinisë, vendbanimit, për nevojat e planifikimit ekonomik e financiar, për njohjen e kontigjenteve të forcave aktive të punës, për shpërndarjen territoriale të investimeve kapitale, sidomos të industrisë, për furnizimin e popullsisë nga rrjeti i tregtisë me pakicë, për shtrirjen e sistemit shkollor, të shëndetësisë, si dhe për qëllime të tjera, siç ishte p.sh., mbrojtja e vendit.

Kështu, regjistrimi i radhës është bërë më 3 shtator 1950, nga i cili numri i popullsisë doli 1.218.900 banorë, me një rritje prej 96.900 banorë ose 8,6 për qind kundrejt vitit 1945; ose 1,7 për qind mesatarisht në vit.

Regjistrimi pasues është bërë më 2 tetor 1955, sipas të cilit popullsia e vendit kishte arritur në 1.391.500 banorë, 172.600 banorë më shumë ose 14,2 për qind; 2,8 për qind mesatarisht në vit. Në vitin 1960 popullsia e Shqipërisë arriti në 1.626.300, me një rritje prej 234.800 banorë ose 16,9 për qind kundrejt vitit 1955; 3,4 për qind mesatarisht në vit, që është ritmi më i lartë i arritur në vend gjatë gjithë periudhës së sistemit socialist.

---

2) Teki Selenica (1882-1962) më 1924 boton librin "Shqipëria 1923", ku për herë të parë publikohen statistika demografike. Në vitin 1928 T. Selenica emërohet sekretar i përgjithshëm në Këshillin e Ministrave dhe në po këtë vit boton librin "Shqipëria më 1927", me të dhëna statistikore për zhvillimin e degëve të ekonomisë shqiptare. Më 22 prill 1930, nën drejtimin e tij, përfundoi regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë. *(Shënim i redaktorit).*

***Tabela 1**: Popullsia gjithsej sipas regjistrimeve 1923-1989, meshkuj-femra dhe qytet-fshat, në mijë dhe %*

Vitet	Popullsia		Meshkuj		Femra		Qytet		Fshat	
	Gjithsej	***%***	***Gjithsej***	***%***	***Gjithsej***	***%***	***Gjithsej***	***%***	***Gjithsej***	***%***
9/1923	803.9	100	-	-	-	-	127.5	15,9	676.4	84,1
30.9.1945	1.122.0	100	570.3	50,8	551.7	49,2	238.8	21,3	883.2	78,7
3.9.1950	1.218.9	100	625.9	51,3	593.0	48,7	249.8	20,5	969.1	79,5
2.10.1955	1.391.5	100	713.3	51,3	678.2	48,7	383.2	27,5	1.008.3	72,5
2.10.1960	1.626.3	100	835.3	51,4	791.0	48,6	502.4	30,9	1.123.9	69,1
1.4.1969	**2.068.1**	**100**	**1.062.5**	**51,4**	**1.005.6**	**48,6**	**650.7**	**31,5**	**1.417.4**	**68,5**
7.1.1979	**2.590.6**	**100**	**1.337.4**	**51,6**	**1.253.2**	**48,4**	**866.6**	**33,5**	**1.724.0**	**66,5**
2.4.1989	**3.182.4**	**100**	**1.638.9**	**51,5**	**1.543.5**	**48,5**	**1.129.8**	**35,5**	**2.052.6**	**64,5**

***Burimi**: Vjetari statistikor i Shqipërisë, 1991. F. 361.*

Në vitin 1960, kundrejt vitit 1950, shtesa mesatare e popullsisë ka qenë 3.3 për qind në vit, kurse kundrejt vitit 1945, pra për 15 vjet, popullsia shqiptare ishte shtuar me gjysmë milioni (504.300) banorë, rreth 45 për qind, ose 3 për qind mesatarisht në vit.

Pas këtij viti, regjistrimet e popullsisë janë bërë çdo dhjetë vjet. Regjistrimi i radhës u bë më 1 prill 1969, nga i cili doli se popullsia shqiptare e kishte kaluar shifrën prej 2 milionë (2.068.200) banorë. Gjatë dhjetë vjetëve të fundit ajo ishte shtuar me 441.900 banorë, ose 27,1 për qind kundrejt vitit 1960, me një ritëm mesatar prej 2,7 për qind në vit.

Regjistrimi pasues i 7 janarit 1979 nxori se popullsia shqiptare kishte arritur në 2.590.600 banorë, me një rritje prej 552.400 banorë, ose 25,3 për qind.

Regjistrimi i fundit i popullsisë gjatë sistemit socialist është kryer më 2 prill 1989. Nga ky regjistrim doli se popullsia kishte arritur në 3.182.400 banorë; 591.800 banorë ose 22,8 për qind më shumë se më 1979, me një mesatare vjetore rritjeje prej rreth 2,3 për qind e që shënon edhe ritmin më të ulët të periudhës së pasçlirimit. Krahasuar me vitin 1945, në vitin 1989 popullsia e Shqipërisë ishte shtuar me 2.060.400 banorë, ose 2,8 herë.

Nga ky regjistrim dolën një varg të dhënash e treguesish të popullsisë dhe banesave, një pjesë e të cilave kanë gjetur pasqyrim edhe në vjetarin statistikor 1991. Numri i popullsisë banuese i regjistruar në vitin 1989 mbetet më i larti i periudhës së sistemit socialist.[3]

Nga të dhënat e tabelës 1, del se raporti i popullsisë meshkuj-femra ka qëndruar thuajse i pandryshuar në rreth 51,5 me 48,5 për vitet 1945 – 1989.

Nga këto të dhëna del edhe përfundimi tjetër i rritjes së popullsisë qytetare nga 15,9 për qind më 1923 në 21,3 për qind më 1945; në 33.5 për qind më 1979. Por në dhjetëvjeçarin e fundit 1979 – 1989 ndryshimi ka qenë i vogël, vetëm 2 për qind.

Analiza e zhvillimeve demografike në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shekullit XX nxjerr në pah disa tipare karakteristike, si: rritjen me ritme të larta të popullsisë, 3-4 herë më të larta se në vendet e tjera europiane,

---

3) Pas vitit 1989, një regjistrim i përgjithshëm i popullsisë dhe banesave është bërë në vitin 2001 dhe pas 10 vjetësh, në vitin 2011, është bërë një regjistrim tjetër, që u quajt 'census'. Referuar të dhënave të këtyre regjistrimeve, del se popullsia e Shqipërisë, nga 3.182.417 banorë më 1989, ka rënë në 3.069.275 banorë më 2001 dhe 2.800.138 banorë në tetor 2011. Gjatë 22 vjetëve (1989-2011) popullsia banuese është pakësuar me 382.279 banorë ose 12 për qind, nga të cilët, në vitet 1989-2001 me 113.142 banorë ose rreth 9.428 banorë mesatarisht në vit, dhe në vitet 2001-2011 ka rënë me 269.137 banorë, 26.914 banorë mesatarisht në vit apo rreth 2,9 herë më shumë. Faktori kryesor është migracioni i jashtëm – largimi i gati 1,4 milionë banorëve dhe rënia e numrit të lindjeve. *(Shënim i redaktorit)*.

moshën mesatare të re, përqendrimin në shkallë të lartë të popullsisë në fshat, urbanizimin, dhe mbi të gjitha zënien e plotë me punë të popullsisë së aftë në moshë pune si dhe migrimin me ritme të larta në fillim dhe vijim të viteve 1990.

Politika demografike e ndjekur gjatë sistemit politik socialist ka qenë pronataliste (pro lindjeve), që nxiste shtimin me ritme të larta të popullsisë. Mbajtja e ritmeve të larta mbështetej në disa masa me karakter ekonomik e social, si: ndihmë financiare për çdo fëmijë të lindur gjallë, shpërblime të veçanta për nënat me shumë fëmijë, zgjatje e lejes së pagueshme të lindjes për gratë shtatzëna, dalje në pension para kohe për nënat me shumë fëmijë, përballim nga shteti i barnave për fëmijët e moshës deri 1 vjeç etj.

Kjo politikë mbështetej me masa administrative, si: ndalimi i abortit dhe i masave kontraceptive, mungesa e njohurive për planifikimin familjar, shpërblimet për nënat me shumë fëmijë etj. Por kjo politikë nuk u mbështet sa dhe si duhet me hapjen e vendeve të reja të punës përmes investimeve dhe ndërtimeve kapitale, me sigurime shoqërore dhe të ardhura të tjera reale në mënyrë që të sigurohej një jetë më e denjë për qytetarët.

Në interpretimet zyrtare, proceset demografike kanë qenë lidhur e kushtëzuar gjithnjë me çështjet politike e shoqërore. Me këtë shpjegohet teza e njohur se nuk mund të ketë një politikë demografike të përhershme; se ajo është një bashkësi faktorësh e politikash me ndikim të ndërsjellë ideologjik, ekonomik, social, arsimor, kulturor, familjar dhe juridik...

Banimi në fshat i shumicës së popullsisë shqiptare ka qenë një tipar dallues i zhvillimeve demografike në vendin tonë, i cili ka ardhur duke u zbehur me kalimin e viteve. Në vitin 1960 popullsia gjithsej në vendin tonë përbëhej nga 1.607 mijë banorë, kurse në vitin 1980 vetëm në fshat banonin 1.750 mijë njerëz. Në asnjë rreth dhe krahinë nuk u vërejt dukuria e pakësimit absolut të popullsisë.

Referuar pesëvjeçarit të fundit të sistemit socialist 1985 – 1990, del se ritmi mesatar vjetor i rritjes së popullsisë në vendin tonë prej 2 për qind, ndonëse me ulje kundrejt periudhave të mëparshme, rezultonte shumë i lartë krahasuar me nivelin europian prej vetëm 0,4 për qind. Në veçanti Europa është duke u vjetruar në mënyrë progresive: ajo është orientuar drejt së ashtuquajturës "rritje zero".

Nga kjo del se *boom*-i demografik është rrjedhojë dhe, në të njëjtën kohë, efekt i një vendi në zhvillim me një ekonomi të bazuar në sektorin bujqësor. Përvoja e vendit tonë tregoi se ritmet e larta të shtimit të popullsisë në etapën e parë të shoqëruara me ritme më të larta rritjeje ekonomike

ishin efektive, kurse mbajtja e një ritmi të lartë edhe në etapën e dytë, kur nuk u shoqërua me ritme të larta ekonomike, për më tepër me rënie të tyre, dhe me mungesë emigrimi, jo vetëm nuk rezultoi efektive, por ndikoi edhe në rënien e standardit të jetesës për shtresa të caktuara shoqërore sidomos në fshat.

Shtimi i shpejtë i popullsisë në vendin tonë është shoqëruar me rritjen e densitetit të saj, të shprehur në numrin e banorëve për km². Nga 28 banorë për km² që kishte në vitin 1923, në vitin 1960 ky tregues arriti në 58/ km², dhe në vitin 1989 në 110 banorë/ km².

Një tjetër karakteristikë e kësaj dendësie është rritja me ritme më të shpejta e saj në qytete, si rrjedhojë e shtesës natyrore dhe lëvizjes mekanike nga fshati në qytet si dhe ndërmjet qyteteve, siç u theksua më shumë në të ardhmen.

Dukuria e lëvizjes mekanike të popullsisë nga fshati në qytet arriti vlera të larta në dekadën 1950 – 1960. Në vitet 1951– 1955, me fillimin e industrializimit në shkallë të gjerë, nga llogaritjet dilte se volumi i ndërtim-montimeve dhe vënia në shfrytëzim e veprave industriale kërkonte një shtesë mesatare vjetore prej 26 mijë vetësh fuqi punëtore, pa përfshirë pjesëtarët e tjerë të familjeve të tyre, që duhej të zhvendoseshin në qendra urbane.

Këtu nuk përfshihej numri i madh i punëtorëve me banim në fshat, por që ishin në marrëdhënie pune në sektorët shtetërorë të ekonomisë, si në sektorët e gjeologjisë, të minierave, në shfrytëzimin pyjor, në hapjen e rrugëve etj. Më vonë lëvizja mekanike e popullsisë u disiplinua, por kryesisht me masa administrative.

Në harkun kohor ndërmjet dy luftërave botërore pesha specifike e popullsisë urbane dhe asaj rurale në Shqipëri kishte ndryshuar pak. Por pas Luftës II Botërore, deri në vitet 1960, popullsia urbane u rrit me ritme më të shpejta. Në vitin 1968 ajo ishte 4 herë më e lartë se në vitin 1938, kundrejt 1,5 herë të rritjes së popullsisë fshatare.

Por në vitet e para të pasçlirimit raporti i popullsisë fshatare kundrejt popullsisë gjithsej mbeti i pandryshuar. Kështu, ndërsa në vitin 1945 ajo përbënte 78,7 për qind të popullsisë gjithsej, në vitin 1950 ajo përbënte 79,5 për qind. Në vitet në vijim prirjet tregojnë rënie të raportit të popullsisë fshatare kundrejt asaj gjithsej, megjithatë ky nivel mbeti thuajse në të njëjtat vlera relative, ose afër 2/3. Kështu, në vitin 1980 ky raport kishte rënë në 66,4 për qind; në vitin 1985 ishte 65,2 për qind dhe në vitin 1989 64,5 për qind.

Në vitin 1990, popullsia qytetare në Shqipëri përbënte rreth 36,1 për qind të popullsisë gjithsej, ndërsa ajo fshatare 63,9 për qind. Në të njëjtën kohë popullsia qytetare në Bullgari ishte 76,6 për qind; në Hungari 63 për qind; në Poloni 66,1 për qind; në Rumani 53.2 për qind dhe në Çekosllovaki 75,6 për qind.

Nga tabela 2, del se numri i familjeve qytetare është në përqindje më të lartë krahasuar me numrin e popullsisë, për rrjedhojë numri i familjeve fshatare është më i ulët, për shkak të përbërjes me numër më të madh anëtarësh për familje.

Familja fshatare paraqitej me disa veçori: në vitin 1989 familjet me 2-3 pjesëtarë në qytete përbëjnë 23,2 për qind të numrit të përgjithshëm të tyre; ndërsa 55,2 për qind kishin 4-5 pjesëtarë. Pra, rreth 4/5 e familjeve në vitin 1989 në qytete kishin mesatarisht 2-5 persona.

Kurse familjet në fshat përbëheshin nga më shumë pjesëtarë: 53,8 për qind e përbënin familjet me 4-6 pjesëtarë dhe 24,1 për qind ato me 7-10 pjesëtarë, që do të thotë se 4/5 e familjeve fshatare kishin mesatarisht 4-10 pjesëtarë.

***Tabela 2**: Numri i familjeve gjithsej, ndarë në qytet dhe në fshat*

Vitet	Familje gjithsej		Në qytet		Në fshat	
	Numër	*%*	*Numër*	*%*	*Numër*	*%*
1960	279.805	100	95.491	34,1	184.314	65,9
1969	346.588	100	126.618	36,5	219.970	63,5
1979	463.333	100	186.929	40,3	276.404	59,7
1989	675.456	100	289.229	42,8	386.227	57,2

Popullsia e Shqipërisë sipas grupmoshave përbënte në atë kohë një piramidë me bazë të gjerë, ku moshat e reja zënë peshën specifike më të lartë. Gjatë katër dekadave të pasçlirimit është llogaritur që grupmoshat nën 15 vjeç kanë zënë mesatarisht rreth 37 për qind të popullsisë gjithsej.

Referuar të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 1989, si dhe statistikave të atij viti, del se nga 3.182.417 banorë gjithsej, 1.050.000 ose 33 për qind ishin të moshës deri 14 vjeç; 1.883 mijë ose 59 për qind të grupmoshave 15-59 vjeç dhe vetëm 8 për qind ishin të grupmoshave 60 vjeç e lart, ose 2 herë më pak se në shumë vende europiane.

Në vitin 1989 32,8 për qind e popullsisë ishte nën moshën e punës; 57,8 për qind ishte në moshën e punës dhe 9,4 për qind mbi moshën e punës. Në këto kushte, kontigjentet aktive të punës (ato ekzistuese plus hyrjet e reja) kanë qenë të larta, pa llogaritur numrin e familjeve, përbërjen

numerike dhe prirjen e shpërbërjes së tyre, raportet e grupmoshave sipas gjinisë (meshkuj: femra), martesat, fertilitetin dhe shkallën e natalitetit e të mortalitetit në të ardhmen.

Punësimi i këtyre kontigjenteve aktive të punës ka qenë një problem i mprehtë në sistemin socialist, duke llogaritur këtu që grupmoshat e reja kërkojnë një periudhë kohe të arrijnë moshën aktive të punës, për shkak të arsimimit dhe të faktorëve të tjerë. Kjo dukuri u shfaq kur moshat e lindura në vitet 1960 parashtruan në fund të viteve 1970 kërkesa gjithnjë në rritje ekonomike dhe sociale, me ndikim të madh edhe në vitet 1980.

Në dekadën 1980 – 1990, numri mesatar i të punësuarve është rritur me ritme të ulëta: në vitin 1990 numri i të punësuarve gjithsej është rritur 28 për qind ose 2,8 për qind mesatarisht në vit, pra vetëm pak më shumë se rritja mesatare e popullsisë. Nga tabela 3, del se në tre vitet e fundit 1988 – 1990, shkalla e punësimit ka mbetur e pandryshuar.

***Tabela 3**: Të zënë me punë gjithsej për vitet 1980-1990, numër mesatar, në mijë*

Vitet	Gjithsej	-Nga këta	Në %	Rritja në %	
		Punëtorë		*Gjithsej*	*Punëtorë*
1980	1.122	949	85	100	100
1985	1.298	1.101	85	116	116
1986	1.341	1.140	85	120	120
1987	1.381	1.174	85	123	124
1988	1.405	1.195	85	125	126
1989	1.431	1.215	85	128	128
1990	1.433	1.216	85	128	128

***Burimi**: Vjetari statistikor i Shqipërisë, viti 1991. F. 76*

Nga tabela 4, del se numri i të punësuarve është rritur me ritëm më të lartë në sektorin shtetëror: 39 për qind në vitin 1990 kundrejt vitit 1980, me një ritëm mesatar vjetor rritjeje prej 3,9 për qind. Kurse në sektorin kooperativist këto raporte kanë qenë përkatësisht 13 për qind dhe 1,3 për qind.

Gjatë dekadës së fundit të sistemit socialist 1980 – 1990, në dy degët kyçe të ekonomisë, në industri dhe në bujqësi, ishin të zënë me punë nga 55 për qind (1980) e deri në 57 për qind (vitet 1987 – 1989) e numrit të përgjithshëm të të punësuarve. Pjesën tjetër e zinte punësimi në ndërtim me 9 për qind, në transport me 7 për qind, në tregti dhe ushqim social po me 7 për qind etj. Në përgjithësi, pesha specifike e punësimit sipas degëve të ekonomisë ka ruajtur nivele të njëjta apo të përafërta *(Tabela 5)*.

***Tabela 4**: Numri mesatar i të zënëve me punë sipas sektorëve për vitet 1980-1990, mijë*

Vitet	Gjithsej	Sektori		Rritja në % sipas sektorëve:	
		Shtetëror	*Koop.*	*Shtetëror*	*Koop.*
1980	1.122	655	467	100	100
1985	1.298	769	529	117	113
1986	1.341	830	541	122	116
1987	1.381	830	551	127	118
1988	1.405	852	553	130	118
1989	1.431	881	550	134	118
1990	1.433	908	525	139	113

***Burimi**: Vjetari statistikor i Shqipërisë, 1991. F. 76*

Në vitet 1990, edhe pse ritmet e lindjeve janë në rënie dhe po përjetojmë një emigracion masiv jashtë vendit, shtimi i moshave të reja përbën një problem të vështirë shoqëror dhe ekonomik, që duhet përballuar me riaktivizimin e ekonomisë, me daljen e saj nga gjendja në të cilën ndodhet si rezultat i prishjes së strukturave prodhuese në vite.

***Tabela 5**: Të zënë me punë në sektorin shtetëror sipas degëve të ekonomisë, numër mesatar, mijë*

Degët	**1980**	**1985**	**1986**	**1987**	**1988**	**1989**	**1990**
Gjithsej	***655***	***769***	***800***	***830***	***852***	***881***	***908***
Industri	225	262	272	287	293	303	314
Ndërtim	74	75	78	78	80	84	82
Bujqësi	137	168	182	190	197	202	197
Transport, ndërlidhje	27	37	38	40	40	40	42
Tregti, ushqim social	48	56	55	56	59	61	62
Arsim-Kulturë	49	55	56	58	60	61	63
Shëndetësi	33	36	37	38	39	40	41
Të tjera	***62***	***80***	***82***	***83***	***84***	***90***	***107***
Pesha specifike ndaj gjithsej, %							
Gjithsej	***100***	***100***	***100***	***100***	***100***	***100***	***100***
Industri	34	34	34	34	34	34	34
Ndërtim	11	10	10	9	9	10	9
Bujqësi	21	22	22	23	23	23	22
Transport, ndërlidhje	4	5	5	5	5	5	5
Tregti, ushqim social	7	7	7	7	7	7	7
Arsim-Kulturë	8	7	7	7	7	7	7
Shëndetësi	5	5	5	5	5	4	5
Të tjera	***10***	***10***	***10***	***10***	***10***	***10***	***11***

***Burimi**: Vjetari statistikor i Shqipërisë, 1991. F. 80.*

Ndryshimet e shpejta të kushteve social-ekonomike dhe higjieno-sanitare sollën si rezultat përmirësimin e mënyrës së jetesës si dhe ndikuan në zgjatjen mesatare të jetës së njeriut nga 38 vjeç që ishte para luftës, në mbi 70 vjeç pas vitit 1980. Por nga tabela 6, del se në 5 vitet e fundit, 1985–1990, ky tregues ka mbetur në shifrën prej pak më shumë se 72 vjet.

***Tabela 6**: Zgjatja mesatare e jetës, vite*

Vitet	Gjithsej	Meshkuj	Femra
1950-1951	53,5	52,6	54,4
1951-1956	57,8	57,2	58,6
1960-1961	64,9	63,7	66,0
1979-1980	69,5	67,0	72,3
1980-1981	70,2	67,7	72,2
1984-1985	71,5	68,7	74,4
1985-1986	71,9	68,7	75,5
1986-1987	72,0	68,8	75,5
1987-1988	72,2	69,4	75,5
1988-1989	72,4	69,6	75,5
1989-1990	72,2	69,3	75,4

***Burimi**: Vjetari statistikor i Shqipërisë, 1991. F. 36.*

Pas vitit 1990, në vitet e para të tranzicionit, lëvizja migratore e popullsisë u rrit në përmasa të gjera dhe ritme të shpejta si brenda dhe jashtë vendit. Migrimi më masiv ka prekur sidomos zonën verilindore të vendit, vendosur në periferi të qytetit të Tiranës, por edhe në qytete të tjera të ultësirës bregdetare, në kërkim të punës dhe të kushteve më të mira të jetesës.

Migrimet e popullsisë, kryesisht në Itali dhe Greqi, por edhe në vende të tjera, sipas vlerësimeve, arrijnë 1/2 milion persona, që përfaqësojnë 1/5 e popullsisë dhe rreth 1/6 e forcave aktive të punës. Kjo prirje ka zbutur ndjeshëm efektin e papunësisë në vend, ka ndikuar në rritjen e remitancave, të ardhurave të kthyera në Shqipëri nga puna në emigracion, si dhe ka lehtësuar luftën kundër varfërisë, ka rritur nivelin e jetesës së shumë familjeve dhe ekonomisë shqiptare në tërësi.

Përbërja e popullsisë sipas grupmoshave ruajti pak a shumë raportet e saj edhe në periudhën postkomuniste, me gjithë ndryshimet e mëdha që pësoi si rezultat i emigracionit ekonomik të dekadës 1990 –1999 e që po vazhdon. Nga përpunimi i të dhënave të vjetarit statistikor të vitit 1999, del se në vitin 1998 grupi i popullsisë në moshë pune për meshkujt përbënte 22,4 për qind, kurse ai i femrave 19,3 për qind.[4]

4) INSTAT. Shqipëria në shifra, 1999. F. 16.

Mesazhe politikës shqiptare
të prezantuara nga Merita Xhumari,
si anëtare e komitetit menaxhues të COST Action IS1409
"gender and health impacts of policies extending working life in western countries"[1]
në Parlamentin Evropian, në 6 mars 2019

Konteksti:

Në qershor të vitit 2014 Shqipëria fitoi statusin e vendit kandidat nga Bashkimi Europian, që nxiti reformat institucionale në vend. Në vitin 2016 Shqipëria kishte ende një popullsi relativisht të re, ku popullsia mbi 65 vjeç zinte 12,8%, krahasuar me 19,2% në vendet e BE-së. Raporti i varësisë së

1) The European Cooperation in Science and Technology (COST) is a funding organization under Horizon 2020 for creation of research networks –called COST Actions, one of which was COST Action IS1409 "Gender and health impacts of policies extending working life in western countries" that I was member from August 2017, and in Management Committee 12.11.2018 – 26.04. 2019 that was closed this Action. The last activity was on March 6, 2019 with a 3 minutes message from each country members to the European Parliament. The main objective of the Action is to enhance scientific knowledge of the gender and health impacts extended working life policies, by integrating disciplines, developing collaborations, creating scientific, policy and public interest and developing a new generation of researchers.

moshës së vjetër është vlerësuar të rritet deri në vitin 2031 në 31 për qind për burrat dhe 37 për qind për gratë, referuar një jetëgjatësie më të lartë në lindje në 77 vjeç për burrat (78,2 EU28) dhe 80 vjeç për gratë (83,6 EU28). Në 2016, rreth 42% e grave ishin jashtë fuqisë punëtore (26% e burrave), nga të cilat 40% e grave ishin në pension të parakohshëm dhe 21,5% për shkak të angazhimit familjar (1% e burrave).

Reformat kryesore politike për të zgjatur jetën e punës

Reformat parametrike të rritjes së moshës së daljes në pension nga 55 në 60 vjeç për gratë dhe nga 60 në 65 vjeç për burrat, të cilat gradualisht do të shkojnë në 67 vjeç në vitin 2056, kanë qenë drejtimi kryesor i politikës për të zgjatur jetën e punës. Kjo u shoqërua me zgjatjen e periudhës së sigurimit nga 25 në 35 vjet e që deri në vitin 2032 do të rritet në 40 vjet, për të siguruar pensionin e plotë kontributiv nga skema publike e detyrueshme. Elemente nxitëse për qëndrimin aktiv në punë përbëjnë edhe rritja e masës së pensionit me 0,5% në muaj, nëse personat vazhdojnë të punojnë përtej moshës së daljes në pension dhe zvogëlimi i masës së pensionit me 0,6% në muaj nëse personat kërkojnë pension të parakohshëm. Krahas ndryshimeve në sistemin e sigurimeve shoqërore, edhe ndryshimet e fundit në Kodin e Punës, duke ofruar fleksibilitet ndaj grave për balancimin e jetës së punës me përgjegjësitë familjare, pritet të ndikojnë në rritjen e punësimit të tyre dhe rritjen e përfitimeve nga sistemi i sigurimeve shoqërore.

Sfidat kryesore në Shqipëri:

Megjithëse mosha mesatare e daljes në pension është rritur me 10 vjet nga 1993– 2016, përqindja e pensionistëve në popullsinë shqiptare po ashtu është rritur nga 13,4% në 19% dhe raporti i varësisë së sistemit të pensioneve është kritik 1:1. Papunësia e të rinjve në 30% është një presion që punëdhënësit të nxjerrin në pension punonjësit e moshuar, pa iu dhënë mundësinë të negociojnë për zgjatjen e jetës së punës përtej moshës së daljes në pension. Sfida e dytë lidhet me uljen e shkallës së zëvendësimit të pensionit, sidomos të grave, të cilat kanë papunësi më të lartë, periudha më të ulëta të kontributit dhe jetëgjatësi më të madhe në krahasim me burrat. Rrjedhimisht gratë janë në rrezik të lartë varfërie në moshë të vjetër, që sjell edhe dallimet gjinore në treguesit e një jete të shëndetshme.

Rekomandimet politike:

• Shqipëria ka harmonizuar kuadrin ligjor me standardet e BE-së, por ka nevojë të zhvillojë më tej kapacitetet institucionale për zbatimin e tij.

• Politikat efektive për zgjatjen e jetës së punës kanë nevojë për një qasje të integruar të politikave të nxitjes së punësimit, arsimit dhe mundësive për trajnim dhe kushteve fleksibël të punës.

• Zhvillimi i shërbimeve dhe përfitimeve sociale për fëmijët do të mundësonte balancimin e jetës së punës dhe të jetës familjare e sociale për gratë.

• Promovimi i skemave të pensioneve profesionale me mosha fleksibël të daljes në pension.

• Kujdesi shëndetësor parandalues është një prioritet, pasi aftësia e kufizuar, sëmundjet kronike dhe depresioni janë më të larta midis grave të moshuara.

• Nevojiten kërkime të mëtejshme mbi implikimet gjinore dhe shëndetësore të zgjatjes së jetës së punës.

Albanian Policy Brief[1]

Context:

In June 2014 Albania was granted the candidate status by the European Union that along with internal socio-economic situation promoted institutional reforms. In 2016 Albania have low share of population above 65 years old, at 12.8% (compared to 19.2% in EU28). By 2031, a gender old-age dependency ratio estimated at 31 per cent for men and at 37 per cent for women refers to a higher life expectancy at birth to 77 years for men (78.2 EU28) and 80.1 for women (83.6 EU28). About 42% of women were outside of the labour force, (26% of men), out of which 40% is due to early retirement and 21.5% due to women's family engagement (1% of men).

Main Extended Working Life Policy Reforms

Retirement ages continue increasing from now 60 women/65 men to 67 by 2056, and insurance period from now 35 years to 40 years in 2032 for both, to get the full contributory pension. Pension amount is increased

1) The European Cooperation in Science and Technology (COST) is a funding organization under Horizon 2020 for creation of research networks –called COST Actions, one of which was COST Action IS1409 "Gender and health impacts of policies extending working life in western countries" that I was member from August 2017, and in Management Committee 12.11.2018 – 26.04. 2019 that was closed this Action. The last activity was on March 6, 2019 with a 3 minutes message from each country members to the European Parliament. The main objective of the Action is to enhance scientific knowledge of the gender and health impacts extended working life policies, by integrating disciplines, developing collaborations, creating scientific, policy and public interest and developing a new generation of researchers.

with 0.5 %/month if people continue working beyond the retirement ages and is reduced with 0.6% each month they ask early retirement.

Reconciliation of paid work with family responsibilities is also taken in consideration in recent changes in the Labour Code and in Social Insurance law offering flexibility to women.

Main issues in Albania:

Although the real average retirement age increased by 10 years from 1993, the share of pensioners in the Albanian population still increased from 13.4% to 19%, and the dependency ratio of pension system is critical 1:1. Youth unemployment at 30% is a pressure for employers to shed older employees when they reach the retirement age. The decreased replacement rate of pensions is directed to especially women, who have higher unemployment, lower contribution periods and greater life expectancy compared to men. Consequently women are at high risk of poverty in old age, along with age and gender patterns differences in health indicators.

Policy recommendations:

- Albania has harmonised the legal framework in line with EU standards, but the institutional capacities need to be further developed.
- Effective policies for extending working life need an integrated approach through employment promotion, training opportunities and flexible working conditions.
- Development of family /child benefits and services to enable work-life balance for women.
- Promotion of occupational pension schemes with flexible retirement ages.
- The means-tested social pension to be replaced by universal social pension to 70+.
- Preventive health care is a priority as disability; chronic diseases and depression are higher among older women.
- Further research on the gender and health implications of extended working life is needed.

STATISTIKË

STATISTIKA TË MBROJTJES SOCIALE NGA INSTAT, 2019

***Tabela 1**: Pensione urbane në skemën e sigurimeve shoqërore, 2014 – 2018*

Gjendje në fund

Emërtimi	2014	2015	2016	2017	2018
Pensione urbane					
- Gjithsej	436.337	454.163	472.390	488.408	508.651
- Femra	202.423	213.302	218.863	227.396	239.311
nga të cilët:					
Pensione pleqërie					
- Gjithsej	327.604	345.315	363.664	379.349	398.744
- Femra	156.680	167.734	172.972	179.431	190.663
Pensione invaliditeti					
- Gjithsej	61.200	62.101	61.938	62.412	63.046
- Femra	24.850	25.001	25.192	25.569	26.033
Pensione familjare					
- Gjithsej	47.533	46.749	46.788	46.647	46.861
- Femra	20.893	20.567	20.699	22.396	22.615

***Burimi i informacionit**: Instituti i Sigurimeve Shoqërore*

***Tabela 2**: Pensione rurale në skemën e sigurimeve shoqërore, 2014 – 2018*

Gjendje në fund

Emërtimi	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**
Pensione rurale					
- Gjithsej	149.146	144.769	139.154	132.778	127.084
- Femra	91.944	89.035	85.962	83.485	82.202
nga të cilët:					
Pensione pleqërie					
- Gjithsej	133.132	129.160	124.378	118.794	113.763
- Femra	84.213	81.548	78.902	76.880	75.949
Pensione invaliditeti					
- Gjithsej	7.579	7.764	7.456	7.304	7.129
- Femra	3.237	3.400	3.227	3.173	3.171
Pensione familjare					
- Gjithsej	8.435	7.845	7.320	6.680	6.192
- Femra	4.494	4.087	3.833	3.432	3.082

***Burimi i informacionit**: Instituti i Sigurimeve Shoqërore*

***Tabela 3**: Numri mesatar i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe fondi i ndihmës sipas strukturës së familjes, 2014 – 2018*

Familjet sipas strukturës	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**
Familje gjithsej, numër	**78.071**	**80.057**	**80.147**	**80.945**	**53.982**
- me 1 pjesëtar	3.854	4.406	4.301	4.582	1.643
- me 2 pjesëtarë	6.534	6.724	7.097	7.326	2.386
- me 3 pjesëtarë	12.517	13.188	13.821	14.352	9.156
- me 4 pjesëtarë	22.954	23.938	24.271	24.451	18.838
- me 5 pjesëtarë	17.699	18.124	17.963	17.867	13.692
- me 6 pjesëtarë	8.502	8.284	7.994	7.781	5.465
- me mbi 6 pjesëtarë	6.012	5.394	4.702	4.586	2.801
Fondi i paguar gjithsej, në mijë lekë	**3.569.361**	**4.095.878**	**4.115.224**	**4.088.491**	**3.330.631**
- me 1 pjesëtar	119.038	160.531	133.409	140.417	40.428
- me 2 pjesëtarë	225.173	256.044	271.740	285.847	79.629
- me 3 pjesëtarë	482.710	563.179	596.865	621.005	429.467
- me 4 pjesëtarë	991.276	1.190.713	1.225.664	1.249.097	1.114.691
- me 5 pjesëtarë	876.252	1.013.792	1.028.710	980.412	964.152
- me 6 pjesëtarë	489.705	528.726	516.361	496.530	439.047
- me mbi 6 pjesëtarë	385.208	382.893	342.476	315.183	263.217

***Burimi i informacionit**: Shërbimi Social Shtetëror*

***Tabela 4**: Pagesa e papunësisë dhe ndihma ekonomike sipas tremujorëve 2016 – 2018*

Përshkrimi	**IV- 16**	**IV - 17**	**I - 18**	**II - 18**	**III - 18**	**IV - 18**
Pagesa e papunësisë	11.000	11.000	12.000	12.000	12.000	12.000
Përfitues të pagesës së papunësisë së regjistruar	4.051	1.892	1.941	1.933	2.096	2.219
Numri mesatar i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike	82.076	79.516	52.443	53.114	52.940	58.700
Ndihma ekonomike mesatare mujore për një familje	4.280	4.174	5.184	5.247	5.081	5.084

***Burimi i informacionit**: Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Shërbimi Social Shtetëror*

***Tabela 5**: Masa e pensionit mesatar mujor, urban dhe rural sipas llojit, 2014 – 2018, në lekë*

Emërtimi	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**
Urban					
pension pleqërie	14.518	14.585	14.873	15.527	15.875
pension invaliditeti	12.593	12.648	12.803	13.389	13.817
pension familjar	6.765	6.696	6.613	6.706	6.897
Rural					
pension pleqërie	7.825	8.330	8.556	8.808	8.792
pension invaliditeti	6.113	6.501	6.595	6.452	6.630
pension familjar	3.252	3.240	2.830	2.477	2.312

***Burimi i informacionit**: Instituti i Sigurimeve Shoqërore*

RISHIKIMI I PERSPEKTIVËS SË POPULLSISË SË BOTËS 2019 PËR VITET 2020 – 2100

Më 17 qershor 2019, u publikua Raporti i Kombeve të Bashkuara për rishikimin e Perspektivës së Popullsisë së Botës në vitet 2020 – 2100.[1]

Raporti 2019 përbën rishikimin e 26 të popullsisë globale, përgatitur nga Sektori i Popullsisë i Departamentit të Çështjeve Ekonomike dhe Sociale të Sekretariatit të OKB-së, bazuar në të dhënat e reja dhe vlerësimet dhe projeksionet zyrtare të Kombeve të Bashkuara.

Krahas përfshirjes së të dhënave të reja që janë përdorur për rishikimin e vlerësimeve dhe projeksioneve, janë bërë edhe përshtatjet e nevojshme në metodologjinë e përdorur në rishikimin 2019 për pjellorinë, vdekshmërinë dhe migracionin ndërkombëtar. [2]

Sipas Raportit 2019, në vitin 2020 popullsia e botës parashikohet të arrijë në rreth 7,8 miliardë banorë; në vitin 2030 në mbi 8,5 miliardë banorë; në vitin 2040 në rreth 9,2 miliardë banorë; në vitin 2050 në 9,7 miliardë banorë dhe në vitin 2100, në fund të këtij shekulli në rreth 10,9 miliardë banorë *(Tabela 2)*.

1. Perspektiva e popullsisë së Shqipërisë 2020-2100

Nga parashikimet e Raportit 2019, Shqipëria në vitin 2020 pritet të ketë 2.878 mijë banorë; në vitin 2030 2.787 mijë banorë; në vitin 2040 2.634 mijë banorë; në vitin 2050 2.424 mijë banorë; në vitin 2080 1.660 mijë banorë dhe, në vitin 2100 parashikohet të ketë 1.088 mijë banorë. Të dhëna për vitet e tjera paraqiten në tabelën 1, të cilat janë nxjerrë nga tabela 2 në vijim, që përmban të gjitha vendet e botës.

2. Përkufizimi i rajoneve

Të dhënat e tabelës 1 janë paraqitur sipas rajoneve, nënrajoneve, vendeve apo zonave duke përdorur 4 klasifikime të grupvendeve dhe zonave për qëllime statistikore brenda grupeve kryesore.

---

1) https://population.un.org/wpp/Publications/Files/WPP2019_PressRelease_EN.pdf

2) https://population.un.org/wpp/Publications/Files/WPP2019_Methodological-updates.pdf

***Tabela 1**: Parashikimi i popullsisë së Shqipërisë për vitet 2020 – 2100*

Viti	Popullsia, mijë banorë	Viti	Popullsia, mijë banorë
2020	2.878	2065	2.069
2025	2.840	2070	1.942
2030	2.787	2075	1.806
2035	2.721	2080	1.660
2040	2.634	2085	1.508
2045	2.534	2090	1.359
2050	2.424	2095	1.218
2055	2.309	2100	1.088
2060	2.191		

- Rajonet e Synimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm: vendet dhe zonat janë grupuar në 8 rajone të Synimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të përkufizuara nga Sektori i Statistikave Kombëtare të OKB-së dhe të përdorura për Raportin e Synimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Këto rajone janë ndarë më tej në 21 nënrajone.

- Rajonet gjeografike: vendet dhe zonat janë grupuar gjithashtu në 6 zona kryesore të përcaktuara si: Afrika; Azia; Europa; Amerika Latine dhe Karaibet; Amerika e Veriut; dhe Oqeania.

- Grupet e zhvillimit të OKB-së: përcaktimet rajone "më shumë të zhvilluara" dhe "më pak të zhvilluara" janë për qëllime statistikore dhe nuk shprehin një gjykim rreth fazës së arritur nga një vend apo zonë e veçantë në procesin zhvillimor.

Rajonet më të zhvilluara përfshijnë Europën, Amerikën e Veriut, Australinë/Zelandën e Re dhe Japoninë.

Rajonet më pak të zhvilluara përfshijnë të gjitha rajonet e Afrikës, Azisë (përveç Japonisë), Amerikës Latine dhe Karaibet plus Melanezinë, Mikronezinë dhe Polinezinë.

Grupi i vendeve më pak të zhvilluara përfshin 47 vende: 32 në Afrikën Sub-Sahariane, 2 në Afrikën e Veriut dhe Azinë Perëndimore, 4 në Azinë Qendrore dhe Juglindore, 4 në Azinë Lindore dhe Juglindore, 1 në Amerikën Latine dhe Karaibet, 4 në Oqeani.

- Vendet e tjera më pak të zhvilluara përfshijnë rajonet më pak të zhvilluara, përjashtuar vendet më pak të zhvilluara.

- Grupi i Vendeve të Mbyllura në Zhvillim (LLDCs) është përbërë nga 32 vende ose territore: 16 në Afrikën Sub-Sahariane, 2 në Afrikën e Veriut dhe Azinë Perëndimore, 8 në Azinë Qendrore dhe Jugore, 2 në Azi-

në Lindore dhe Juglindore, 2 në Amerikën Latine dhe Karaibet, dhe 2 në Europë dhe Amerikën e Veriut.

- Grupi i Shteteve Ishuj të Vogla në Zhvillim (SIDS) është përbërë nga 58 vende ose territore: 29 në Karaibe, 20 në Pacifik dhe 9 në Oqeanin Atlantik dhe Oqeanin Indian, Detin Mesdhe dhe Detin e Kinës Jugore (AIMS).

- Grupet sipas të ardhurave të Bankës Botërore krijohen nga klasifikimi i vendeve sipas nivelit të të ardhurave GNI (General National Income) për frymë në qershor 2018 nga Banka Botërore.[3]

3. Dhjetë gjetjet kryesore që dalin nga Raporti 2019 i OKB-së për parashikimet e popullsisë së botës 2020 – 2100

Nga Raporti 2019 i OKB-së për parashikimet e popullsisë të botës për vitet 2020 – 2019 dalin 10 gjetje kryesore:

■ **Popullsia e botës vijon të rritet, por ritmet e rritjes ndryshojnë ndjeshëm sipas rajoneve**

Popullsia e botës parashikohet të rritet nga 7,7 miliardë më 2019 në 8,5 miliardë më 2030 (10% rritje), dhe më tej në 9,7 miliardë më 2050 (26%), dhe në 10,9 miliardë më 2100 (42%). Popullsia e Afrikës Sub-Sahariane parashikohet të dyfishohet deri më 2050 (99%). Rajonet e tjera do të kenë ritme të ndryshme rritjeje midis 2019 dhe 2050: Oqeania, përjashtuar Australi/Zelanda e Re (56%), Afrika e Veriut dhe Azia Perëndimore (46%), Australi/Zelande e Re (28%), Azia Qendrore dhe Juglindore (25%), Amerika Latine dhe Karaibet (18%), Azia Lindore dhe Juglindore (3%), Europa dhe Amerika e Veriut (2%).

■ **Më shumë se gjysmën e rritjes së popullsisë të projektuar nga tani deri më 2050 do ta kenë 9 vende**

Rritje më të mëdha të popullsisë midis 2019 dhe 2050 do të kenë: India, Nigeria, Pakistani, RD e Kongos, Etiopia, Tanzania, Indonezia, Egjipti dhe ShBA-ja. Rreth vitit 2027 India parashikohet të kalojë Kinën si vendi me popullsi më të madhe në botë.

3) https://population.un.org/wpp/DefinitionOfRegions/

■ **Rritja e shpejtë e popullsisë paraqet sfida për zhvillim të qëndrueshëm**

Shumë nga vendet me rritje të shpejtë të popullsisë janë ndër vendet më të varfra, ku rritja e popullsisë sjell sfida shtesë në përpjekjet për të zhdukur varfërinë (SDG 1), për të arritur më shumë barazi (SDGs 5 dhe 10), për të luftuar urinë dhe kequshqyerjen (SDG 2), si dhe për të forcuar mbulimin dhe cilësinë e sistemeve të shëndetit dhe arsimit (SDGs 3 and 4).

■ **Në disa vende rritja e popullsisë në moshë pune krijon mundësi për rritje ekonomike**

Në shumicën e vendeve të Afrikës Sub-Sahariane, dhe pjesërisht të Azisë, Amerikës Latine dhe Karaibeve, reduktimet më të fundit në pjellori kanë bërë që popullsia në moshë pune (25-64 vite) të rritet më shpejt se moshat e tjera, duke krijuar një mundësi për rritje ekonomike të përshpejtuar. Për të përfituar nga ky "dividend demografik", qeveritë duhet të investojnë në arsim dhe shëndetësi, veçanërisht për të rinjtë, dhe të krijojnë kushtet e favorshme për rritje ekonomike të qëndrueshme.

■ **Në shkallë botërore, gratë do të kenë më pak fëmijë, por ritmet e pjellorisë mbeten të larta në disa pjesë të botës**

Sot, rreth gjysma e njerëzve në botë jetojnë në një vend ose zonë ku pjelloria është poshtë 2.1 lindje për grua gjatë gjithë jetës. Më 2019, pjelloria mbetet mbi këtë nivel, në mesatare, në Afrikën Sub-Sahariane (4,6); Oqeania, përjashtuar Australi/Zelandë e Re (3,4); Afrika e Veriut dhe Azia Perëndimore (2,9), dhe Azia Qendrore dhe Lindore (2,4). Ritmi i pjellorisë globale – i cili ra nga 3,2 lindje për grua më 1990 dhe 2,5 më 2019 – është parashikuar të bjerë më tej në 2,2 më 2050.

■ **Njerëzit janë duke jetuar më gjatë, por ata në vendet më të varfra jetojnë 7,4 vite më pak se mesatarja globale**

Zgjatja e jetës në shkallë botërore, e cila u rrit nga 64,2 vjet më 1990 në 72,6 vjet më 2019, parashikohet të rritet më tej në 77,1 vjet më 2050. Ndërsa progres i konsiderueshëm është bërë në ngushtimin e jetëgjatësisë midis vendeve të ndryshme, mbeten ende hendekë të mëdhenj. Më 2019, zgjatja e jetës në vendet më pak të zhvilluara mbetet 7,4 vjet pas mesatares globale, për shkak të vdekshmërisë së lartë të fëmijëve dhe nënave, si dhe dhunës, ndikimit të dhunës, konflikteve dhe efektit të vazhdueshëm të epidemisë së HIV.

■ **Popullsia e botës do të vijë duke u moshuar, me persona mbi 65 vjeç, duke u bërë grupi më i shpejtë i moshuar**

Deri më 2050, 1 në 6 njerëz në botë do të jetë mbi 65 vjeç (16%), nga 1 në 11 më 2019 (9%). Rajonet ku pjesa e popullsisë 65 vjeç e lart është projektuar të dyfishohet midis 2019 dhe 2050 përfshin Afrikën e Veriut dhe Azinë Perëndimore, Azinë, Azinë Qendrore dhe Lindore, Azinë Lindore dhe Juglindore dhe Amerikën Latine dhe Karaibet. Nga viti 2050, 1 në 4 persona që banojnë në Europë dhe Amerikën e Veriut mund të jenë 65 vjeç e lart. Më 2018, për herë të parë në histori, personat 65 e lart do të kalojnë numrin e fëmijëve nën pesë. Numri i personave 80 vjeç e sipër është parashikuar të trefishohet, nga 143 milionë më 2019 në 426 milionë më 2050.

■ **Rënia e numrit të njerëzve në moshë pune do të ushtrojë trysni mbi sistemet e mbrojtjes sociale**

Raporti potencial mbështetës, i cili krahason numrin e njerëzve në moshë pune 25-64 vjeç ndaj atyre me moshë 65 vjeç e lart, po vjen duke rënë kudo në botë. Në Japoni ky raport është 1.8, më i ulëti në botë. Po kështu, 29 vende, shumica në Europë dhe Karaibe, tashmë kanë raporte potenciale mbështetjeje nën 3. Deri më 2050, 48 vende, shumica në Europë, Amerikën e Veriut dhe Azinë Lindore dhe Juglindore janë parashikuar të kenë raporte potenciale mbështetjeje nën 2. Këto vlera të ulëta nënvizojnë efektin potencial të moshimit të popullsisë në tregun e punës dhe ecurinë ekonomike si dhe presionin fiskal me të cilin shumë vende do të përballen në dekadat e ardhshme ndërkohë që duhet të ndërtojnë dhe mbajnë sistemet publike të kujdesit shëndetësor, pensioneve dhe mbrojtjes sociale për personat më të moshuar.

■ **Rritet numri i vendeve që pësojnë reduktim të përmasave të popullsisë**

Prej vitit 2010, 27 vende ose zona kanë pësuar një reduktim në përmasat e tyre të popullsisë. Kjo është shkaktuar nga nivelet e ulëta të pjellorisë dhe, në disa vende, nga ritmet e larta të emigracionit. Midis 2019 dhe 2050, popullsitë janë projektuar të ulen nga 1 për qind ose më shumë në më se 55 vende apo zona, nga të cilat 26 mund të kenë një reduktim prej së paku 10 për qind. Në Kinë, p.sh., popullsia është projektuar të ulet për 31,4 milionë, ose 2,2 për qind, midis 2019 dhe 2050.

■ **Migracioni përbën një komponent kryesor të ndryshimit të popullsisë në disa vende**

Midis 2010 dhe 2020, Europa dhe Amerika e Veriut, Afrika Veriore dhe Azia Perëndimore dhe Australi/Zelanda e Re do të jenë marrës neto të migrantëve ndërkombëtarë, ndërsa rajonet e tjera do të jenë dërgues neto të tyre. Katërmbëdhjetë vende ose zona do të kenë hyrje neto të më shumë se 1 milion migrantëve, ndërsa dhjetë vende do të kenë një dalje neto prej më se 1 milion migrantë. Disa nga lëvizjet migratore më të mëdha janë drejtuar nga kërkesa për migrantë punëtorë (Bangladesh, Nepal dhe Filipine) ose nga dhuna, pasiguria dhe konfliktet e armatosura (Siria,Venezuela dhe Mianmari). Bjellorusia, Estonia, Gjermania, Hungaria, Italia, Japonia, Federata Ruse, Serbia dhe Ukraina do të kenë nevojë për hyrje neto të migrantëve brenda një dekade si rrjedhojë e humbjes së popullsive respektive të shkaktuar nga rritja e vdekjeve kundrejt lindjeve.[4]

PROJEKSIONET PROBABILISTIKE TË POPULLSISË GJITHSEJ (MESHKUJ DHE FEMRA) BAZUAR NË PARASHIKIMIN E POPULLSISË SË BOTËS 2019 SIPAS RAJONIT, NËNRAJONIT, VENDIT OSE ZONËS PËR VITET 2020-2100[5]

***Tabela 2**: Popullsia gjithsej, për të dyja gjinitë, nga 1 korriku, në mijë*

Rajoni, nënrajoni, vendi ose zona	2020	2030	2040	2050	2100
BOTA	7.794.799	8.548.487	9.198.847	9.735.034	10.874.952
Grupet e zhvillimit të OKB	...	...	...	...	...
Rajone më të zhvilluara	1.273.304	1.286.010	1.287.350	1.279.913	1.244.296
Rajone më pak të zhvilluara	6.521.494	7.262.477	7.911.498	8.455.121	9.630.656

4) https://population.un.org/wpp/Publications/Files/WPP2019_10KeyFindings.pdf

5) United Nations, Department of Economic and Social Affairs, Population Division (2019). Probabilistic Population Projections based on the World Population Prospects 2019: http://population.un.org/wpp/. Për lehtësi paraqitje, nuk janë përfshirë të gjitha vitet por një pjesë e tyre. Studjuesit që dëshirojnë të thellohen mund t'i referohen publikimeve të plota të Kombeve të Bashkuara të World Population Prospects 2019.

Rajoni, nënrajoni, vendi ose zona	**2020**	**2030**	**2040**	**2050**	**2100**
Vende më pak të zhvilluara	1.057.438	1.313.759	1.590.724	1.876.798	3.046.779
Rajonet më pak të zhvilluara, përjashtuar vendet më pak të zhvilluara	5.464.056	5.948.719	6.320.774	6.578.323	6.583.877
Rajonet më pak të zhvilluara, përjashtuar Kinën	5.050.208	5.765.376	6.429.942	7.021.424	8.540.745
Vendet e Mbyllura në Zhvillim	533.143	659.183	792.073	926.457	1.405.998
Shtetet ishuj të vegjël në zhvillim	72.076	78.488	83.523	87.159	87.599
Grupet e Bankës Botërore sipas të ardhurave	**...**	**...**	**...**	**...**	**...**
Vendet me të ardhura të larta	1.263.093	1.298.770	1.319.333	1.324.198	1.299.704
Vendet me të ardhura të mesme	5.753.052	6.252.578	6.647.510	6.932.572	7.085.794
Vendet me të ardhura të mesme –të larta	2.654.816	2.763.138	2.807.456	2.799.690	2.380.613
Lower-middle-income countries	3.098.235	3.489.440	3.840.054	4.132.882	4.705.181
Low-income countries	775.711	993.853	1.228.401	1.474.406	2.484.829
No income group available	2.944	3.287	3.604	3.858	4.624
Rajonet gjeografike	**...**	**...**	**...**	**...**	**...**
Afrika	1.340.598	1.688.321	2.076.750	2.489.275	4.280.127
Azia	4.641.055	4.974.092	5.188.949	5.290.263	4.719.465
Europa	747.636	741.303	727.811	710.486	629.563
Amerika Latine dhe Karaibet	653.962	706.254	742.348	762.432	679.993
Amerika e Veriut	368.870	390.599	410.177	425.200	490.889
Oqeania	42.678	47.919	52.814	57.376	74.916
Rajonet e Synimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) regions	...	...	...	...	...

Rajoni, nënrajoni, vendi ose zona	2020	2030	2040	2050	2100
AFRIKA SUB-SAHARIANE	1.094.366	1.399.888	1.746.496	2.117.731	3.775.270
Afrika Lindore	445.406	569.705	707.393	851.218	1.451.842
Burundi	11.891	15.773	20.253	25.325	50.904
Komorosi	870	1.063	1.266	1.472	2.187
Xhibuti	988	1.117	1.217	1.295	1.332
Eritrea	3.546	4.240	5.114	6.005	9.062
Etiopia	114.964	144.944	175.466	205.411	294.393
Kenia	53.771	66.450	79.470	91.575	125.424
Madagaskari	27.691	35.622	44.471	54.048	99.957
Malavi	19.130	24.849	31.317	38.143	66.559
Mauritius	1.272	1.274	1.245	1.186	827
Majote	273	343	419	495	746
Mozambiku	31.255	41.185	52.729	65.313	123.647
Réunion	895	955	996	1.010	901
Ruanda	12.952	16.234	19.634	23.048	33.413
Sejshelles	98	103	105	105	88
Somalia	15.893	21.191	27.591	34.922	75.716
Sudani i Jugut	11.194	13.839	16.856	19.963	31.738
Uganda	45.741	59.438	74.455	89.447	136.785
Tanzania	59.734	79.163	102.587	129.387	285.652
Zambia	18.384	24.326	31.338	39.121	81.546
Zimbabve	14.863	17.596	20.864	23.948	30.965
Afrika e Mesme	179.595	238.186	306.945	382.640	746.061
Angola	32.866	44.835	59.782	77.420	188.283
Kameruni	26.546	33.766	41.873	50.573	90.225
Republika Afrikane Qendrore	4.830	5.942	7.205	8.401	11.631
Çadi	16.426	21.690	27.643	34.031	61.850
Kongo	5.518	7.020	8.777	10.702	20.962
RD e Kongos	89.561	120.047	155.725	194.489	362.031
Guinea Ekuatoriale	1.403	1.874	2.346	2.821	4.511
Gaboni	2.226	2.744	3.265	3.809	5.859
Sao Tome dhe Principe	219	268	328	394	708
Afrika Lindore	67.504	75.364	82.055	87.379	93.571
Botsvana	2.352	2.774	3.168	3.510	4.166
Esvatini	1.160	1.298	1.507	1.704	2.145
Lesoto	2.142	2.325	2.507	2.665	2.695
Namibia	2.541	3.011	3.497	3.981	5.374
Afrika e Jugut	59.309	65.956	71.375	75.518	79.191
Afrika Perëndimore	401.861	516.633	650.103	796.494	1.483.796
Benini	12.123	15.672	19.775	24.280	47.209

Rajoni, nënrajoni, vendi ose zona	**2020**	**2030**	**2040**	**2050**	**2100**
Burkina Faso	20.903	27.404	35.051	43.432	83.194
Cabo Verde	556	610	652	679	604
Bregu i Fildishtë	26.378	33.713	42.083	51.264	96.633
Gambia	2.417	3.171	4.008	4.882	8.176
Gana	31.073	37.833	44.883	52.016	79.011
Guinea	13.133	17.021	21.365	25.972	45.257
Guinea-Bisau	1.968	2.461	2.996	3.557	5.706
Liberia	5.058	6.372	7.825	9.340	15.525
Mali	20.251	26.957	34.939	43.586	80.383
Mauritania	4.650	5.967	7.432	9.025	17.065
Niger	24.207	34.846	48.746	65.593	164.947
Nigeria	206.140	262.977	329.067	401.315	732.942
Saint Helena	6	6	6	6	4
Senegali	16.744	21.551	27.088	33.187	63.515
Sierra Leone	7.977	9.649	11.339	12.945	16.675
Togo	8.279	10.422	12.850	15.416	26.949
AFRIKA VERIORE DHE AZIA PERËNDIMORE	525.869	608.881	684.500	754.047	923.989
Afrika Veriore	246.233	288.433	330.253	371.545	504.858
Algjeria	43.851	50.361	55.640	60.923	70.705
Egjipti	102.334	120.832	140.350	159.957	224.735
Libia	6.871	7.606	8.151	8.525	8.012
Maroku	36.911	40.887	43.973	46.165	44.708
Sudani	43.849	55.254	67.919	81.193	142.342
Tunizia	11.819	12.756	13.353	13.797	12.972
Saharaja Perëndimore	597	737	867	984	1.384
Azia Perëndimore	279.637	320.448	354.247	382.502	419.132
Armenia	2.963	2.967	2.905	2.816	2.039
Azerbajxhani	10.139	10.740	11.055	11.065	9.192
Bahreini	1.702	2.013	2.200	2.316	2.252
Qiproja	1.207	1.275	1.324	1.355	1.309
Gjeorgjia	3.989	3.853	3.689	3.517	2.514
Iraku	40.223	50.194	60.584	70.940	107.711
Izraelu	8.656	9.980	11.333	12.720	18.128
Jordania	10.203	10.655	11.887	12.932	13.644
Kuvajti	4.271	4.747	5.153	5.393	6.189
Libani	6.825	6.195	6.376	6.528	5.707
Omani	5.107	5.936	6.437	6.915	7.268
Katari	2.881	3.327	3.629	3.851	4.162
Arabia Saudite	34.814	39.322	42.473	44.562	42.231
Shteti i Palestinës	5.101	6.342	7.599	8.816	12.268

Rajoni, nënrajoni, vendi ose zona	2020	2030	2040	2050	2100
Siria	17.501	26.677	30.153	33.129	36.103
Turqia	84.339	89.158	94.132	97.140	86.170
Emiratet e Bashkuara Arabe	9.890	10.661	10.648	10.425	9.073
Jemeni	29.826	36.407	42.670	48.080	53.171
AZIA QENDRORE DHE JUGORE	2.014.709	2.226.970	2.389.800	2.496.417	2.333.525
Azia Qendrore	74.339	83.843	92.540	100.250	114.923
Kazakistani	18.777	20.639	22.370	24.024	27.918
Kirgistani	6.524	7.446	8.307	9.126	10.985
Taxhikistani	9.538	11.557	13.846	16.208	25.328
Turkmenistani	6.031	6.782	7.409	7.949	8.421
Uzbekistani	33.469	37.418	40.608	42.942	42.271
Azia Jugore	1.940.370	2.143.127	2.297.260	2.396.167	2.218.602
Afganistani	38.928	48.094	56.912	64.683	74.938
Bangladeshi	164.689	178.994	188.417	192.568	151.393
Butani	772	843	885	905	686
India	1.380.004	1.503.642	1.592.692	1.639.176	1.450.421
Irani	83.993	92.664	98.594	103.098	98.588
Maldives	541	519	556	586	490
Nepali	29.137	33.390	34.889	35.324	23.708
Pakistani	220.892	262.959	302.129	338.013	403.103
Sri Lanka	21.413	22.023	22.186	21.814	15.275
AZIA LINDORE DHE JUGLINDORE	2.346.709	2.426.673	2.444.901	2.411.344	1.966.808
Azia Lindore	1.678.090	1.699.380	1.675.643	1.617.342	1.222.593
Kina	1.439.324	1.464.340	1.449.031	1.402.405	1.064.993
Kina, Hong Kongi SAR	7.497	8.019	8.140	8.041	7.647
Kina, Makao SAR	649	732	791	838	1.012
Kina, Provinca e Tajvanit e Kinës	23.817	24.011	23.593	22.413	16.259
RD e Koresë	25.779	26.651	26.858	26.562	22.793
Japonia	126.476	120.758	113.356	105.804	74.959
Mongolia	3.278	3.716	4.089	4.449	5.387
Republika e Koresë	51.269	51.152	49.784	46.830	29.542
Azia Juglindore	668.620	727.294	769.258	794.002	744.215
Brunei Darusalam	437	471	489	492	390
Kamboxhia	16.719	18.781	20.527	21.861	21.355
Indonezia	273.524	299.198	318.638	330.905	320.782
Laosi	7.276	8.226	8.972	9.480	8.424
Malajzia	32.366	36.095	38.755	40.550	40.078
Mianmari	54.410	58.478	61.202	62.253	55.299
Filipinet	109.581	123.698	135.619	144.488	146.327

Rajoni, nënrajoni, vendi ose zona	**2020**	**2030**	**2040**	**2050**	**2100**
Singapori	5.850	6.262	6.445	6.408	5.733
Tajlanda	69.800	70.346	69.008	65.940	46.016
Timori Lindor	1.318	1.574	1.809	2.019	2.373
Vietnami	97.339	104.164	107.795	109.605	97.437
AMERIKA LATINE DHE KARAIBET	653.962	706.254	742.348	762.432	679.993
Karaibet	43.532	45.829	47.069	47.394	38.838
Anguila	15	16	16	17	14
Antigua dhe Barbuda	98	105	109	111	102
Aruba	107	110	111	109	102
Bahamasi	393	427	450	463	460
Barbadosi	287	289	287	277	215
British Virgin Islands	30	32	32	32	25
Bonaire, Sint Eustatius and Saba	26	28	29	30	33
Ishujt Kajman	66	73	80	85	103
Kuba	11.327	11.142	10.765	10.162	6.671
Kuraçao	164	171	175	176	175
Dominika	72	73	73	71	51
Republika Dominikane	10.848	11.770	12.416	12.796	11.013
Grenada	113	116	116	116	86
Guadelupe	400	400	398	387	339
Haiti	11.403	12.733	13.916	14.878	14.760
Xhamajka	2.961	3.048	3.045	2.960	1.793
Martinika	375	368	356	332	234
Montserrati	5	5	4	4	3
Porto Riko	2.861	2.905	2.689	2.445	1.217
Saint-Barthélemy	10	10	11	11	10
Saint Kitts and Nevis	53	56	57	56	43
Saint Lucia	184	189	188	182	122
Saint Vincent dhe Grenadines	111	113	112	109	75
Sint Maarten (Dutch part)	43	48	52	55	69
Saint-Martin (French part)	39	43	47	51	60
Trinidad dhe Tobago	1.399	1.413	1.392	1.344	969
Turks and Caicos Islands	39	44	48	50	54

Rajoni, nënrajoni, vendi ose zona	**2020**	**2030**	**2040**	**2050**	**2100**
United States Virgin Islands	104	101	94	86	40
Amerika Qendrore	179.670	198.571	213.441	223.567	211.854
Belize	398	468	526	571	620
Kosta Rika	5.094	5.468	5.692	5.773	4.798
El Salvador	6.486	6.779	6.931	6.937	4.766
Guatemala	17.916	21.213	24.261	26.921	31.270
Hondurasi	9.905	11.449	12.780	13.831	14.325
Meksika	128.933	140.876	149.759	155.151	141.510
Nikaragua	6.625	7.392	8.049	8.531	8.124
Panamaja	4.315	4.928	5.442	5.853	6.440
Amerika e Jugut	430.760	461.854	481.837	491.472	429.301
Argjentina	45.196	49.056	52.297	54.867	56.802
Bolivia	11.673	13.240	14.653	15.840	17.391
Brazili	212.559	223.852	229.059	228.980	180.683
Kili	19.116	19.458	20.157	20.319	17.332
Kolumbia	50.883	53.417	55.336	55.958	45.221
Ekuadori	17.643	19.819	21.762	23.316	24.483
Ishujt Falkland (Malvinas)	3	3	3	3	3
Guajana Franceze	299	378	461	545	927
Gujana	787	822	835	825	531
Paraguaji	7.133	7.950	8.614	9.102	8.734
Peruja	32.972	36.031	38.552	40.374	39.158
Suriname	587	632	664	680	613
Uruguaji	3.474	3.569	3.624	3.639	3.182
Venezuela	28.436	33.626	35.819	37.023	34.241
AUSTRALIA/ ZELANDA E RE	30.322	33.350	36.005	38.422	48.885
Australia	25.500	28.177	30.572	32.814	42.877
Zelanda e Re	4.822	5.173	5.433	5.608	6.008
OQEANIA (PA AUSTRALINË DHE ZELANDËN E RE)	12.356	14.569	16.808	18.954	26.030
Melanezia	11.123	13.234	15.387	17.469	24.583
Fixhi	896	966	1.027	1.071	1.067
Kaledonia e Re	285	311	332	346	356
Papua New Guinea	8.947	10.709	12.493	14.204	19.783
Ishujt Solomon	687	865	1.068	1.290	2.410
Vanutu	307	383	468	557	968
Mikronezia	549	603	645	674	659
Guam	169	181	189	193	168
Kiribati	119	139	157	177	239

Rajoni, nënrajoni, vendi ose zona	**2020**	**2030**	**2040**	**2050**	**2100**
Ishujt Marshall	59	65	71	75	63
Mikronezia (Fed. States of)	115	127	135	139	115
Nauru	11	11	11	11	6
Ishujt Perëndimorë Mariana	58	61	63	62	53
Palau	18	18	18	18	14
Polinezia	684	732	776	811	789
Samoa Amerikane	55	55	54	54	36
Ishujt Kuuk	18	18	17	17	14
Polinezia Franceze	281	297	308	311	262
Niue	2	2	2	2	2
Samoa	198	220	244	267	310
Tokelau	1	1	2	2	1
Tonga	106	116	126	134	138
Tuvalu	12	13	15	16	20
Wallis and Futuna Islands	11	10	10	9	6
EUROPA DHE AMERIKA E VERIUT	1.116.506	1.131.901	1.137.988	1.135.687	1.120.451
Europa	747.636	741.641	728.003	710.557	627.701
Europa Lindore	293.013	284.535	272.824	261.977	219.456
Bjellorusia	9.449	9.265	8.938	8.634	7.430
Bullgaria	6.948	6.417	5.873	5.385	3.588
Çekia	10.709	10.745	10.626	10.546	10.274
Hungaria	9.660	9.338	8.907	8.470	6.857
Polonia	37.847	36.945	35.283	33.295	23.033
Republika e Moldovës	4.034	3.886	3.641	3.360	2.012
Rumania	19.238	18.306	17.307	16.260	11.878
Federata Ruse	145.934	143.348	139.031	135.824	126.143
Sllovakia	5.460	5.403	5.217	4.984	3.829
Ukraina	43.734	40.882	38.002	35.219	24.413
Europa Veriore	106.261	109.990	112.749	114.960	121.044
Channel Islands	174	185	194	199	223
Danimarka	5.792	6.002	6.147	6.245	6.873
Estonia	1.327	1.280	1.219	1.158	838
Ishujt Faroe	49	51	53	53	55
Finlanda	5.541	5.581	5.552	5.486	5.254
Islanda	341	360	372	377	353
Irlanda	4.938	5.248	5.489	5.678	5.685
Isle of Man	85	88	90	91	96
Letonia	1.886	1.720	1.584	1.479	1.114
Lituania	2.722	2.485	2.284	2.121	1.524

Rajoni, nënrajoni, vendi ose zona	**2020**	**2030**	**2040**	**2050**	**2100**
Norvegjia	5.421	5.876	6.271	6.600	7.953
Suedia	10.099	10.630	11.008	11.389	13.023
Mbretëria e Bashkuar	67.886	70.485	72.487	74.082	78.053
Europa Jugore	152.215	148.460	143.490	136.648	99.758
Shqipëria	2.878	2.787	2.634	2.424	1.088
Andora	77	78	78	76	62
Bosnja dhe Hercegovina	3.281	3.127	2.923	2.685	1.641
Kroacia	4.105	3.877	3.629	3.365	2.183
Gjibraltari	34	34	34	34	27
Greqia	10.423	9.917	9.509	9.029	6.583
Holy See (Vatikan)	1	1	1	1	1
Itali	60.462	59.031	57.160	54.382	39.993
Malta	442	449	440	427	358
Mali i Zi	628	624	610	589	454
Maqedonia e Veriut	2.083	2.051	1.967	1.857	1.249
Portugalia	10.197	9.913	9.558	9.085	6.985
San Marino	34	34	34	34	30
Serbia	8.737	8.250	7.680	7.084	4.217
Sllovenia	2.079	2.056	2.006	1.940	1.676
Spanja	46.755	46.230	45.225	43.637	33.210
Europa Perëndimore	196.146	198.318	198.748	196.902	189.304
Austria	9.006	9.176	9.212	9.131	8.677
Belgjika	11.590	11.904	12.121	12.221	12.493
Franca	65.274	66.696	67.571	67.587	65.498
Gjermania	83.784	83.136	82.004	80.104	74.741
Lihtenshtejni	38	39	40	40	45
Luksemburgi	626	690	744	790	985
Monako	39	42	44	46	64
Holanda	17.135	17.450	17.461	17.165	15.760
Zvicra	8.655	9.185	9.551	9.818	11.041
Amerika e Veriut	368.870	390.488	409.855	424.452	488.823
Bermuda	62	60	58	53	37
Kanadaja	37.742	40.834	43.486	45.669	56.953
Groenlanda	57	57	56	53	41
Saint Pierre and Miquelon	6	6	6	5	4
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	331.003	349.642	366.572	379.419	433.854

NEKROLOGJI

Më 28 shtator 2017, u nda nga jeta Kiço Ziso, anëtar i Shoqatës Shqiptare të Demografëve dhe menaxher i revistës "Demografia".

Kiçoja u lind më 15 gusht 1944 në fshatin Sopik të rrethit Sarandë. Në vitet 1959 – 1963 kreu teknikumin ekonomik "Nako Spiru", kurse në vitet 1963 – 1968 kreu (pa shkëputje nga puna) Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

Në vitet 1963 – 1968 punoi si merceolog në tregti, kurse pas studimeve të larta, për dhjetë vjet (1968 – 1977), punoi si ekonomist dhe shef plani në repartin mekanik të uzinës "Traktori". Në vitet 1977 – 1991 u emërua si bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Studimeve Ekonomike pranë Akademisë së Shkencave dhe më pas në vartësi të ish-Komisionit të Planit të Shtetit.

Në vitet 1991 – 1992 punoi në Ministrinë e Ekonomisë si specialist në drejtorinë e zhvillimit rajonal dhe në vitet 1992 – 1994 si specialist në Agjencinë Qendrore të Rikonstruksionit dhe Privatizimit të NB-ve në Ministrinë e Bujqësisë. Në vitet 1995 – 1997 punoi si shef i Hotelerisë në Institutin e Fiziopneumologjisë (ish-Sanatoriumi), Tiranë.

Në vitet 1997 – 2000 u emërua bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Punës të BSPSH-së, Tiranë. Në vitin 2001 kaloi në Institutin e Studimeve Sindikale (projekti danez) dhe nga viti 2003 e në vijim përsëri në Institutin e Punës të BSPSH-së.

Kiço Ziso ka një veprimtari kërkimore studimore të shtrirë në dy periudha: në të ekonomisë së centralizuar (1977 – 1991), ku ka kryer studime në shërbim të zhvillimit ekonomik e social të vendit, si dhe në periudhën e demokracisë e të ekonomisë së tregut (1991 – 2017), ku ka kryer studime për llogaritjen e treguesit të minimumit jetik, për pagat e punës dhe pagën minimale, për tregun e punës, për strategjinë e zhvillimit të turizmit, për

strategjinë e punësimit, për moshën e tretë etj., të cilat janë botuar në formë librash e broshurash, vetëm ose me bashkautor.

Kiçoja ka marrë pjesë në shumë konferenca e seminare shkencore. Ka qenë bashkëpunëtor i jashtëm i Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike dhe menaxher i revistës së saj "Ekonomia dhe Tranzicioni", anëtar i Shoqatës Europiane të Ekonomistëve të Punës (EAALE), anëtar i komisionit të nomenklaturave të INSTAT-it etj.

Kiçoja është karakterizuar nga korrektësia në kryerjen e detyrave, nga thjeshtësia me kolegët dhe nga sinqeriteti në marrëdhëniet shoqërore.

Me ndarjen e tij nga jeta, familja humbi njeriun e saj të dashur, kurse ne një bashkëpunëtor të përkushtuar.

U prehtë në paqe!

Kryesia e Shoqatës Shqiptare të Demografëve

KRITERET PËR BOTIMIN E ARTIKUJVE NË REVISTËN "DEMOGRAFIA"

Të nderuar bashkëpunëtorë!

Prej qershorit 2013, revista "Demografia" është regjistruar në mënyrë të përhershme në ISSN (**I**nternational **S**tandard **S**erial **N**umber), një kod ndërkombëtar që identifikon publikimet seriale, me qendër në Paris.

Në përputhje me programin e Shoqatës Shqiptare të Demografëve, temat që trajton revista janë kryesisht të karakterit demografik, social dhe ekonomik si: madhësia, rritja, përhapja e popullsisë, statistikat jetësore të saj, mirëqenia dhe varfëria, papunësia, të ardhurat dhe pabarazia, zhvillimi i qëndrueshëm dhe mjedisi, treguesit ekonomikë dhe financiarë, tatimet dhe taksat etj.

Me qëllim që të ngremë cilësinë shkencore të revistës, redaksia u rekomandon autorëve që të përgatisin artikuj për botim, duke iu përmbajtur kritereve që vijojnë:

1- Artikulli duhet të jetë fryt i punës së autorit (autorëve) duke përdorur të dhëna nga publikimet më të fundit, apo nga pyetësorë dhe teknika të tjera, që i kryejnë apo drejtojnë vetë.

2- Artikulli të shkruhet në gjuhën shqipe, duke respektuar rregullat e drejtshkrimit, përfshirë përdorimin e shkronjave **ë** dhe **ç**.

3- Artikulli duhet të ketë një strukturë standarde: hyrje, analiza në kapituj dhe nënkapituj dhe në mbyllje përfundimet dhe rekomandimet.

4- Artikulli të shkruhet në MSWord, nga 8 deri në 14 faqe në formatin A4, fonti Times New Roman, p.p. 12, me largësi 1 midis rreshtave, në vartësi me numrin e tabelave dhe grafikëve.

5- Artikulli duhet të përmbajë një përmbledhje (abstract) në gjuhën angleze nga 200-250 fjalë dhe 5-6 fjalë kyçe (key words).

6- Footnotes duhet të jenë p.p. 10, duke cituar më parë emrin dhe pastaj mbiemrin e autorit.

7- Referencat apo literatura e përdorur për përgatitjen e artikullit përmbajnë më parë mbiemrin dhe pas emrin e autorit.

8- Artikulli i nënshtrohet më parë një shqyrtimi nga dy recensentë të caktuar nga redaksia, që janë specialistë të fushës përkatëse. Rekomandimet e tyre me shkrim do të mbahen parasysh në vendimin që do të marrë redaksia e revistës.

9- Artikujt mund të dërgohen në adresën e e-mail_it si vijon:
lshahollari@yahoo.com.

Redaksia e revistës "Demografia"